




ARKA E NUHUT

THIRRJE DREJT BESIMIT

Hazret Mirza Ghulam Ahmed^{as}

Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi

Arka e Nuhut

Hazret Mirza Ghulam Ahmed

paqja qoftë mbi të

Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi

Themelues i Xhematit Musliman Ahmedia

Islam International Publications Ltd.

Tiranë, 2020

Arka e Nuhut کشتی نوح

Autor: *Hazret Mirza Ghulam Ahmed* paqja qoftë mbi të

Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi

Themelues i Xhematit Musliman Ahmedia

(Albanian rendering of Urdu book “*Kashti-e-Nuh*” (*Noah’s Ark*))

Botimi i parë në gjuhën urdu: 5 tetor 1902

Botimi i parë në shqip: Shtator 2020

E përktheu nga origjinali: Samad Ahmed Ghor

Redaktore gjuhësore: Ina Komino

Botues:



Fondacioni Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë
Tiranë, Shqipëri (Albania)

© Islam International Publications Ltd.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Kopertina: Marrë nga botimi i veprës në anglisht “Noah’s Ark”.

U shtyp në shtypshkronjën: Gent.grafik, Tiranë

ISBN: 978-9928-4491-3-9

www.alislam.al

Përmbajtja

Parathënie.....	5
Parathënie nga vëllimi 19 i “Ruhani Khazain”	9
Arsyeja e veprës	9
Arka e Nuhut.....	13
Vaksina e murtajës	17
Mësimi.....	32
Fusnota e faqes paraardhëse	134
Shtojca A	137
‘Një dëshmitar prej Bijve të Izraelit dëshmoi’	137
Disa këshilla për gratë	140
Mbyllja.....	142
Profeci në vargje rreth murtajës.....	149
Kërkesë për donacione për zgjerimin e shtëpisë.....	150
Rreth Autori	152
Shkurtesat	154
Kontakte	155

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ نَحْمَدُهُ وَنُصَلِّي عَلَى رَسُولِهِ الْكَرِيمِ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit

Atë e lavdërojmë dhe i dërgojmë salavate të Dërguarit të Tij fisnik

Parathënie

Për vërtetësinë e Hazret Mirza Ghulam Ahmedit të Kadijanit si Mesih të Premtuar, Imam Mehdi dhe Themelues të Xhematit Musliman Ahmedia, Allahu i Madhërishëm shfaqti shenja të panumërta. Njëra prej tyre është mbrojtja Hyjnore e anëtarëve të Xhematit të tij që e ndiqnin me sinqeritet dhe besnikëri, në kohën kur murtaja kishte shpërthyer fuqishëm në Indi. Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

“...shumë kohë më parë, Ai Zot që është Zoti i tokës dhe i qiellit, nga dija dhe kontrolli i të cilit asgjë nuk mbetet jashtë, Vetë më zbriti shpallje duke thënë se Ai do të shpëtojë nga vdekja prej murtajës çdokënd që jeton brenda mureve të kësaj shtëpie, me kusht që **të hyjë në zinxhirin e Bej'atit** duke qenë tërësisht i sinqertë, i bindur dhe i përlurur dhe duke hequr dorë nga të gjitha mendimet kundërshtuese. Gjithashtu, nuk duhet të jetë në asnjë mënyrë mendjemadh, rebel, shpërfillës, kokëfortë dhe vetëpëlqyes përpara porosive të Zotit dhe përpara të Caktuarit të Zotit, dhe të jetojë në përputhje me mësimet e tij. Zoti, duke m'u drejtuar gjithashtu tha: Në Kadijan në përgjithësi murtaja nuk do të jetë aq shkatërrimtare, sa njerëzit të vdesin si kafshë

e të vuajnë nga dhimbjet; dhe, në përgjithësi, të gjithë njerëzit e këtij Xhemati, sado qofshin ata, në krahasim me kundërshtarët, do të jenë të mbrojtur nga murtaja. Por murtaja mund të prekë ata që nuk janë plotësisht të qëndrueshëm në besëlidhjen e tyre ose ata, për të cilët ka një arsye të fshehtë që vetëm Zoti është në dijeni. Përfundimisht njerëzit do të shohin me habi duke krahasuar të tjerët, se ndihma e Zotit është me këta njerëz dhe Ai i ka mbrojtur me mëshirën e Tij të veçantë në mënyrë të pashembullt.”

(“Arka e Nuhut”, f. 19)

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} në këtë libër, gjithashtu tregoi mësimin e tij që është si Arka e Nuhut, për të shpëtuar nga fatkeqësia. Ngaqë bota edhe një herë gjendet në prag të shkatërrimeve dhe kjo arka e Nuhut siç qe e nevojshme atëherë, është e nevojshme edhe sot, andaj, Hazret Mirza Masrur Ahmedi, Kalif i Pestë i Mesihut të Premtuar, Allahu e ndihmoftë fuqimisht, porositi anëtarët e Xhematit ta lexojnë vazhdimisht këtë libër dhe të veprojnë sipas udhëzimeve të tij.

Libri “*Kashti-e-Nuh*” (Arka e Nuhut) është në vëllimin e 19-të *Ruhani Khazain* (Përmbledhje e veprave të Hazret Mirza Ghulam Ahmedit, Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi^{as}). Në këtë parathënie, ju sjellim edhe parathënien e botuesit që gjendet në *Ruhani Khazain* në vëllimin përkatës, parathënie e cila ishte shkruar nga Hazret Mevlana Xhelaluddin Shems^{ra}. Allahu i Madhërishëm na ruajttë gjithmonë dhe na mundësoftë të ndjekim rrugët e imëta të druajtjes ndaj Tij! Amin!

Përkthimi i këtij libri në shqip është bërë nga Z. Samad Ahmed Ghorî, kurse redaktimin gjuhësor e bëri Znj. Ina Komino. Allahu i shpërbleftë!

Ves-selam

Munir-ud-Din Shams

Add. Vakilut-Tasnif

(Drejtor i botimeve të Xhematit Musliman Ahmedia)

Shtator 2020

Parathënie

(Nga Hazret Mevlana Xhelaluddin Shems)

“Arka e Nuhut” u botua më 5 tetor të vitit 1902. Titulli i dytë i këtij libri është “Thirrje drejt besimit” dhe i treti, “Përforcimi i besimit”.

Gjithashut, në frontespici është shkruar:

“Traktati “Vaksina qiellore” i përgatitur kundër murtajës për Xhematin tim.”

Vijojnë këto vargje në gjuhën perse:

جہاں راول ازیں طاعون دو نیم است
نہ ایں طاعون کہ طوفان عظیم است
بیابناب سوئے کشتی ما
کہ ایں کشتی ازاں رب علیم است

Murtaja i çau zemrën më dysh kësaj bote

Kjo s'është murtajë, por përmytje e madhe

Eja shpejt drejt arkës sime

Se kjo arkë është prej Zotit, të Gjithëditurit

Arsyeja e veprës

Më 6 shkurt 1898, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} tha:

“Pashë në ëndërr disa engjëj të Zotit të Madhërishëm, të cilët po mbillnin disa bimë të zeza në pjesë të ndryshme të Panxhabit. Ato bimë ishin jashtëzakonisht të shëmtuara, të zeza dhe të frikshme. – “Çfarë bime janë këto?”, pyeta disa nga ata që mbillnin. – “Këto janë

pemë të murtajës, e cila së shpejti do të përhapet në vend”, m’u përgjigjën ata. Nuk më është bërë e qartë nëse më thanë se murtaja do të përhapej këtë dimër apo në dimrin në vitin tjetër, por pamja që kisha parë ishte e llahtarshme.”

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} gjithashtu tha:

“Përpara kësaj, po në lidhje me murtajën, Zoti më dërgoi edhe një shpallje tjetër, e cila është:

إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّىٰ يُغَيِّرُوا مَا بِأَنْفُسِهِمْ- إِنَّهُ أَوَى الْقَرْيَةِ-

“Sigurisht, Allahu nuk ndryshon çfarë ka një popull, derisa ata nuk ndryshojnë çfarë kanë në veten e tyre. Sigurisht, Ai do të marrë në mbrojtje këtë fshat.”

(“Tedhkiroh”, Pakistan, 2004, f. 261)

Në përputhje me këtë profeci, murtaja u përhap në Panxhab dhe në tetor të vitit 1902, kur ajo ishte në kulm, shteti ndërmori fushatën e vaksinimit kundër murtajës dhe nëpërmjet njoftimeve të ndryshme, propagandoi që çdo njeri duhet të merrte injeksionin e vaksinës. Por Hazret Mesihu i Premtuar^{as} refuzoi ta merrte dhe, më 5 tetor të vitit 1902, botoi librin “Arka e Nuhut”, në të cilin ai mbështeti angazhimet e shtetit për të siguruar vaksinën dhe tha:

“... këtë populli i mençur duhet ta mirëpresë dhe ta falënderojë.”

Dhe për sa i përket Xhematit të tij, tha:

“... ne do të ishim të parët për ta marrë vaksinën, nëse nuk do të kishim një ndalim qiellor. Ndalimi qiellor është që Zoti deshi t’u tregojë

njerëzve në këtë kohë **një shenjë të mëshirës** qiellore. Kështu që, duke m'u drejtuar mua, Zoti tha: **Do të shpëtojnë nga murtaja** ti dhe ai që qëndron brenda mureve të shtëpisë sate ...”

(“Arka e Nubut”, f. 18)

Ai gjithashtu tha:

“Për këdo që ka interes të dijë se cili është ky mësim, më poshtë, do ta paraqes shkurtimisht atë, dhe nëse do të ndiqet plotësisht, mund të shpëtojë nga sulmi i murtajes.”

(“Arka e Nubut”, f. 32)

Më pas, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} shkroi mësimin e tij që është kaq i pastër dhe i dobishëm, aq sa po të zbatohet ashtu siç duhet nga të gjithë anëtarët e Xhematit tonë, mund të kryejmë një revolucion të madh shpirtëror në botë.



Arka e Nuhut





Kjo shpallje është e botuar në “Broshurën e gjelbër”:

Kjo është shpallja e Zotit që më është zbritur në formë ajetesh Kuranore:

اصْصَحِ الْقُلُوكَ بِأَعْيُنِنَا وَوَحْيِنَا. إِنَّ الَّذِينَ يُبَايِعُونَكَ إِنَّمَا يُبَايِعُونَ اللَّهَ يَدُ اللَّهِ فَوْقَ أَيْدِيهِمْ.

Përkthimi: Ndërto arkën para syve Tanë dhe sipas shpalljes Sonë. Sigurisht, ata që bëjnë besëlidhje me ty, në të vërtetë bëjnë besëlidhje me Allahun.

Dora e Allahut është mbi duart e tyre.

Traktati “Vaksina qiellore” i përgatitur kundër murtajës për Xhematin tim.

Është titulluar

Arka e Nuhut

Titulli i dytë

Thirrje drejt besimit

Titulli i tretë

Përforcimi i besimit

اَزْكِبُوا فِيْهَا بِسْمِ اللّٰهِ مَجْرَها وَ مَرْسَها. لَا عَاصِمَ الْيَوْمَ مِنْ اَمْرِ اللّٰهِ اِلَّا مَنْ رَّحِمَ.

Hipni në të! Me emrin e Allahut është lundrimi dhe ankorimi i saj. Nuk ka shpëtimtar sot nga urdhri i Allahut, përveç atij që Ai e mëshiron.

5 tetor 1902

U botua në Kadijan nga Hekim Fazl Din nga Bhera në shtypshkronjën “Zijaul-Islam”, për udhëzimin dhe mësimin e Xhematit tim dhe të atyre që kërkojnë të vërtetën.

Tirazhi: 5,000

[Përkthim në shqip i frontespic të botimit të parë]

Se kjo arkë është prej Zotit, të Gjithëditurit.
Eja shpejt drejt arkës sime

Përkthimi: Gfari do të bëjë Allahun duke ju ndëshkuar, nëse do ta falenderoni dhe do ta besoni? Allahu është Mirenjohës, i Gjithëditshëm.

Murtaja i çau zemrën dysh kësaj bote
Kjo s'është murtajë, por përmbysje e madhe

ما يَقْعَلُ اللَّهُ بِعَدَابِكُمْ اِنْ شَكَرْتُمْ وَاٰمَنْتُمْ وَكَانَ اللَّهُ بِكُمُ غَافِلًا
Xhuzi 5, Surja [4] En-Nisa [148]

Libri “Arka e Nuhut”

ose

Përforcimi i besimit

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ نَحْمَدُهُ وَنُصَلِّي عَلَى رَسُولِهِ الْكَرِيمِ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit

Atë e lavdërojmë dhe i dërgojmë salavate të Dërguarit të Tij fisnik

Vaksina e murtajës

قُلْ لَنْ يُصِيبَنَا إِلَّا مَا كَتَبَ اللَّهُ لَنَا ۖ هُوَ مَوْلَانَا ۚ وَعَلَى اللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُؤْمِنُونَ ﴿٥١﴾

Përkthimi: *Kurrsesi nuk do të na vijë ndonjë vështirësi, përveç asaj që Allahu ka shkruar për ne. Ai është Miku ynë. Dhe vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët.*¹

Duhet të falënderojmë që qeveria e lartë Britanike, duke i bërë mirësi popullit të vet, përsëri dha udhëzimin për vaksinën kundër murtajës dhe mori përsipër një barrë prej miliona rupish për mirëqenien e robërve të Zotit. Në të vërtetë, këtë populli i mençur duhet ta mirëpresë dhe ta falënderojë. Është shumë naiv dhe armik i vetvetes ai që e paragjykon vaksinën. Përvoja ka treguar se kjo qeveri e kujdesshme nuk ka dashur asnjëherë që ne të përdornim ndonjë mjekim të rrezikshëm, përkundrazi, në të tilla raste, ka paraqitur ilaçin pas shumë

¹ Et-Teube 9:51.

eksperimenteve dhe vetëm pasi ishte provuar që me të vërtetë ishte i dobishëm. Prandaj, është e pandershme dhe jo qytetare që t'i veshim qeverisë, e cila shpenzon dhe ka shpenzuar miliona rupi për mirëqenien e njerëzve, dyshimin se ajo po e bën gjithë këtë për një motiv të ulët vetjak. Të pandershëm janë ata të cilët kanë shkuar deri në këtë ekstrem me paragjykimin e tyre.

Pa dyshim, ndër të gjitha masat që ka marrë qeveria e shquar në këtë situatë, më e mira prej tyre është kjo vaksinë. Nuk mund të kundërshtohet kurrësi fakti se vaksina është një mjet i dobishëm dhe se është detyrë e të gjithë njerëzve të përdorin mjetet që u janë vënë në gatishmëri, në mënyrë që të lehtësojnë detyrën e ndërmarrë prej qeverisë për të mbrojtur jetën e tyre.

Por me gjithë respektin duam t'i themi kësaj qeverie mirëbërëse, që ne do të ishim të parët **për ta marrë vaksinën**, nëse nuk do të kishim një ndalim qiellor. Ndalimi qiellor është që Zoti deshi t'u tregojë njerëzve në këtë kohë **një shenjë të mëshirës** qiellore. Kështu që, duke m'u drejtuar mua, Zoti tha: **Do të shpëtojnë nga murtaja** ti dhe ai që qëndron brenda mureve të shtëpisë sate, si dhe të gjithë ata që përumben në ty, duke treguar bindje e nënshtrim të përsosur dhe duke pasur *takva*² të vërtetë; kjo do të jetë një shenjë prej Zotit në këto ditë të fundit, në mënyrë që Unë të bëj një dallim mes popujve; por ai që nuk të ndjek ty plotësisht, nuk është prej teje, dhe **ti mos u brengos** për të.

² Druajtje ndaj Zotit. (Përkthyesi)

Kjo është ajo porosi Hyjnore që më bën mua dhe të gjithë ata që jetojnë brenda mureve të shtëpisë sime, të mos kemi aspak nevojë për vaksinën. Sepse, siç e thashë më lart, shumë kohë më parë, Ai Zot që është Zoti i tokës dhe i qiellit, nga dija dhe kontrolli i të cilit asgjë nuk mbetet jashtë, Vetë më zbriti shpallje duke thënë se Ai do të shpëtojë nga vdekja prej murtajës çdokënd që jeton brenda mureve të kësaj shtëpie, me kusht që ai **të hyjë në zinxhirin e *Be'atit*** duke qenë tërësisht i sinqertë, i bindur dhe i përulur dhe duke hequr dorë nga të gjitha mendimet kundërshtuese. Gjithashtu, ai nuk duhet të jetë në asnjë mënyrë mendjemadh, rebel, shpërfillës, kokëfortë dhe vetëpëlqyes përpara porosive të Zotit dhe përpara të Caktuarit të Zotit, dhe të jetojë në përputhje me mësimet e tij. Zoti, duke m'u drejtuar gjithashtu tha: Në Kadijan në përgjithësi murtaja nuk do të jetë aq shkatërrimtare, sa njerëzit të vdesin si kafshë e të vuajnë nga dhimbjet; dhe, në përgjithësi, të gjithë njerëzit e këtij Xhemati, sado qofshin ata, në krahasim me kundërshtarët, do të jenë të mbrojtur nga murtaja. Por murtaja mund të prekë ata që nuk janë plotësisht të qëndrueshëm në besëlidhjen e tyre ose ata, për të cilët ka një arsye të fshehtë që vetëm Zoti është në dijeni. Përfundimisht njerëzit do të shohin me habi duke krahasuar të tjerët, se ndihma e Zotit është me këta njerëz dhe Ai i ka mbrojtur me mëshirën e Tij të veçantë në mënyrë të pashembullt.

Për këtë që ju tregova, disa mendjelehtë do të çuditen, disa do të qeshin, disa do të më quajnë të çmendur dhe disa të tjerë do të befasohen duke menduar se a ekziston një Zot i tillë, i cili mund të zbresë mëshirën e Tij

pa përdorur mjetet e nevojshme. Po! Pa dyshim që ekziston një Zot kaq i Plotfuqishëm, dhe Ai po të mos ishte i tillë, njerëzit që lidhen me Të, do të kishin vdekur për së gjalli. Ai është Fuqiplotë i çuditshëm dhe fuqitë e Tij të pastra gjithashtu janë të çuditshme. Nga njëra anë, Ai i lejon kundërshtarët mendjelehtë t'u vërsulen si qenë miqve të Tij, dhe nga ana tjetër, porosit engjëjt që t'u shërbejnë atyre. Po kështu, kur botën e zë zemërimi i Tij dhe kur llahtaria e Tij gjëmon ndaj keqbërësve, shikimi i Tij i merr në mbrojtje njerëzit e Tij të veçantë. Po të mos ndodhte kështu, qëmoti **do të ishte shkatërruar** i gjithë misioni i njerëzve të vërtetë, saqë askush nuk do të mund t'i njihnte më ata. Fuqitë e Tij janë të pafundme, por ato u shfaqen njerëzve, aq sa ata kanë bindje. Fuqitë e jashtëzakonshme të Tij u shfaqen atyre që kanë marrë dhuratën e bindjes, të dashurisë dhe të tërheqjes totale ndaj Tij, dhe që kanë shpëtuar nga veset e nefsit të tyre. Zoti bën atë që do. Por për të treguar fuqitë e jashtëzakonshme, Ai zgjedh vetëm ata, të cilët për hir të Zotit i thërrmojnë zakonet e tyre. Në këtë kohë, ka shumë pak njerëz të tillë, të cilët e njohin Atë dhe besojnë në fuqitë e Tij të çuditshme. Dhe ka plot nga ata që aspak nuk besojnë në këtë Zot të Plotfuqishëm, të cilit i bindet çdo gjë dhe për të cilin asgjë nuk është e pamundur.

Këtu dua të theksoj se nuk është mëkat të marrësh mjekim për sëmundjet si murtaja etj., madje në një hadith përmendet që nuk ka sëmundje, për të cilën Zoti të mos ketë krijuar ilaçin, por unë e quaj mëkat ta bëj të dyshimtë, duke marrë vaksinën, shenjën që Ai dëshiron të shfaqë hapur për ne në tokë. Unë nuk guxoj ta fyej shenjën e Tij të

vërtetë dhe premtimin e Tij të vërtetë, duke pranuar injektimin e vaksinës. Po e bëra një gjë të tillë, mëkati që nuk besova në premtimin që Zoti më bëri mua, do të jetë i ndëshkueshëm. Nëse do të përfitoja nga vaksinimi, duhet t'i isha mirënjohës atij mjeku që shpiku recetën e vaksinës, e jo Zotit, i cili më premtoi se do të shpëtojë këdo që gjendet brenda mureve të kësaj shtëpie.

Unë pohoj me largpamësi të qartë se premtimet e Atij Zoti të Plotfuqishëm janë të vërteta dhe shoh të ardhmen sikur ajo të ketë ardhur. Unë e di se qëllimi i vetëm i qeverisë sonë të shquar është të shpëtojë njerëzit nga murtaja dhe nëse në të ardhmen, do të gjente një tjetër mjet më të mirë për të shpëtuar, me shumë gëzim do ta zgjidhte. Në këto rrethana, është e qartë që metoda që Zoti më ka bërë ta ndjek, nuk është kundër qëllimeve të qeverisë së shquar. Profecia për këtë fatkeqësi të madhe gjendet e shkruar tash e njëzet vjet më parë në librin tim të titulluar “*Berāhīn-e Ahmedia*”, gjithashtu është i shkruar edhe premtimi për bekime të veçanta për këtë Xhemat. Shikoni librin “*Berāhīn-e Ahmedia*”, f. 518 dhe f. 519.

Përveç kësaj, Zoti i Madhërishëm e trumbeton këtë profeci se Vetë Ai do t'i shpëtojë nga murtaja njerëzit e sinqertë që jetojnë brenda mureve të shtëpisë sime, të cilët nuk janë mendjemëdhenj përpara Zotit dhe përpara të Caktuarit të Tij dhe se Ai do të tregojë bekim të veçantë mbi këtë Xhemat në krahasim me të tjerët. Mundet që për shkak të dobësisë së besimit, ose të humbjes së veprave, ose për shkak se dikujt mund t'i ketë ardhur koha e vdekjes, ose për ndonjë arsye tjetër që Zoti e di,

rrallëkush mund të preket nga sëmundja edhe brenda këtij Xhemati. Megjithatë, raste të rralla nuk mund të quhen të përgjithshme. Gjatë krahasimit gjithmonë shikohet shumica. Qeveria e shquar të ketë parasysh që, siç dihet edhe nga përvoja, shumë pak vdesin nga ata që marrin vaksinën, në krahasim me ata që nuk e marrin. Dihet që vdekje të rralla nuk ia ulin vlerën vaksinës. Në të njëjtën mënyrë, edhe për këtë shenjë, nëse do të ketë shumë pak raste të murtajës në Kadijan në krahasim me vende të tjera, ose nëse rrallëkush nga ky Xhemat do të ndërrojë jetë nga kjo sëmundje, nuk do t'i ulet vlera kësaj shenjeje. Kjo profeci është regjistruar me përpikëri duke iu përmbajtur Fjalëve të Zotit. Nuk i takon një të zgjuari që para kohe të tallet me çështjet qiellore. Kjo është fjala e Zotit, e jo shprehje e ndonjë fallxhori; kjo buron nga drita, e jo nga hamendja e errësirës. Kjo është fjala e Atij që zbriti murtajën dhe që ka mundësi ta largojë atë. Qeveria jonë me siguri do ta vlerësojë këtë profeci, kur do ta shohë se ç'mrekulli do të ndodhë, se në krahasim me të vaksinuarit, këta njerëz do të jenë **më të mbrojtur e më me shëndet**. Sinqerisht ju them të vërtetën, nëse nuk do të realizohet kjo profeci që po publikohet që prej njëzet (20) a njëzet e dy (22) vjetësh, atëherë unë nuk jam prej Zotit. Kjo **do të jetë shenjë** për të vërtetuar **se unë jam prej Allahut**, që njerëzit e sinqertë që jetojnë brenda mureve të shtëpisë sime, do të jenë të mbrojtur nga vdekja që shkakton kjo sëmundje dhe i gjithë Xhemati im, në krahasim me të tjerët, do të jetë i shpëtuar nga sulmi i murtajës dhe siguria që do ta kenë ata, nuk do ta ketë asnjë grup tjetër njerëzish dhe, gjithashtu, Kadijanin nuk do ta zërë murtaja në masë shkatërrimtare, me përjashtim të rasteve të rralla.

Eh, sikur këta njerëz të ishin të drejtë e t'i kishin frikë Zotit, atëherë do të shpëtonin patjetër, sepse ndëshkimi në botë nuk zë askënd vetëm për shkak të dallimit të tij fetar, pasi ajo është një çështje që do të gjykohet në botën tjetër. Në këtë botë ndëshkimi vjen vetëm për shkak të ligësive, mendjemadhësive dhe shtimit të mëkateve.

Duhet të keni parasysh edhe faktin se në Kuranin Famëlartë, madje edhe në disa libra të Tevratit, përmendet profecia se në kohën e Mesihut të Premtuar do të ketë murtajë.³ Për më tepër, edhe Hazret Mesihu^{as} paralajmëroi për këtë në Ungjill, dhe nuk mundet që profecia e Profetëve të dalë e gabuar. Po kështu, nisur nga premtimi i Zotit, kemi për detyrë t'u shmangemi mjeteve që krijon njeriu, që ndonjë armik të mos i atribuojë shenjë e Zotit dikujt tjetër. Megjithatë, nëse Vetë Zoti përmes Fjalës së Tij na mëson ndonjë metodë ose na zbulon ndonjë ilaç, ajo metodë ose ai ilaç nuk do të jenë kundër shenjes, pasi ato janë prej Atij Zoti, prej të cilit është edhe shenja.

Nëse rrallëkush edhe nga Xhemati ynë vdes nga murtaja, të mos mendojë njeri se do t'i ulet vlera kësaj shenjeje. Edhe në kohërat e kaluara, Zoti porositi Musain, Jozueun⁴ dhe më në fund edhe Profetin tonë^{savs}, që të luftonin me shpatë kundër atyre të cilët e kishin ngritur të

³ Në librat e Biblës si vijon përmendet se do të përhapet murtaja në kohën e Mesihut të Premtuar: Zakaria 14:12, Mateu 24:8 dhe Zbulesa 22:8*.

* Në versionin King James, referenca e Zbulesës është 22:18. [Botuesi]

⁴ Në anglisht është *Joshua*. [Botuesi]

parët shpatën dhe që kishin vrarë qindra jetë njerëzish. Për këta Profetë ishte kjo shenjë, në të cilën përfundimisht ata gëzuan fitore madhështore. Në këtë përballje, edhe përkrahësit e së vërtetës u vranë nga dora e armikut, por shumë pak, dhe një humbje kaq e vogël nuk ia uli vlerën shenjës. Në të njëjtën mënyrë, nëse pakkush prej Xhematit im për shkaqe të lartpërmendura, preket nga murtaja, një murtajë e tillë nuk e zbeh aspak shenjën e Zotit. A nuk është një shenjë madhështore që unë e them në mënyrë të përsëritur se Zoti i Madhërishëm do ta shfaqë këtë profeci në një formë kaq të qartë, saqë asnjë kërkimtar i së vërtetës nuk do të mbetet në mëdyshje dhe do ta kuptojë se Zoti ka treguar mrekulli për këtë Xhemat. Madje, si rrjedhojë e kësaj shenjeje Hyjnore, Xhemati do të shtohet shumë dhe do të përparojë në mënyrë të jashtëzakonshme aq sa do të shihet me habi. Nëse Zoti nuk do të tregojë dallim mes këtij Xhemati dhe xhemateve të tjera, ashtu siç është e parashikuar në këtë profeci dhe siç e kam shkruar edhe në librin tim “*Nuzul-ul-Mesib*”, atëherë kundërshtarët që deri më tani përherë kanë dështuar, do të kenë gjithë të drejtën të më quajnë gënjeshtar. Për kundërshtimet që më kanë bërë deri më tani, kanë pësuar vetëm një mallkim për veten e tyre. Për shembull, vazhdimisht bënë zhurmë se At’hem i nuk vdiq brenda pesëmbëdhjetë muajve, por profecia e thoshte shprehimisht: Nëse ai do të kthehej kah e vërteta, nuk do të vdiste brenda pesëmbëdhjetë muajve. Atëherë ai në mes të mbledhjes ku u zhvillua debati, përpara shtatëdhjetë njerëzve të nderuar që ishin të

pranishëm, u distancua nga të thënë të “*dexhall*”⁵ për Profetin Muhammed^{savs}, dhe jo vetëm kaq, me heshtjen dhe frikën e tij pesëmbëdhjetëmujore, e provoi edhe praktikisht distancimin e tij. Gjithashtu, vetë profecia u ngrit mbi bazën se ai i kishte thënë “*dexhall*” Profetit Muhammed^{savs}. Kështu që, gjithçka që ai përfitoi nga distancimi ishte që vdiq pas pesëmbëdhjetë muajve, por ama vdiq. Kjo ndodhi për shkak se vetë në profeci thuhej se nga të dyja palët, do të vdiste i pari ai që ishte gënjeshtar në besimin e tij. Pra, ai vdiq përpara meje.

Po kështu, gjërat e së padukshmes që Zoti më ka treguar mua dhe që u përmbushën në kohën e tyre, nuk janë më pak se dhjetë mijë. Sidoqoftë, në librin tim të titulluar “*Nuzul-ul-Mesih*”, që është duke u botuar, janë rreshtuar si shembuj vetëm njëqind e pesëdhjetë prej tyre, me gjithë provat dhe dëshmitë e dëshmitarëve. Nuk ka profeci që kam bërë, që nuk është përmbushur, ose që nuk është përmbushur të paktën njëra prej dy pjesëve të saj. Edhe nëse dikush vdes duke kërkuar, nuk do të gjejë dot profeci që ka dalë nga goja ime, për të cilën të mund të thotë se nuk ka qëlluar. Po, dikush nga paturpësia e padituria le të thotë çfarë të dojë. Unë deklaroj fuqishëm që ka mijëra profeci që kam bërë e që janë plotësuar me qartësinë maksimale, për të cilat qindra mijëra njerëz kanë qenë dëshmitarë. Nëse do të kërkon shembull të tillë të Profetët e mëparshëm, nuk do ta gjeni te askush, me përjashtim të Hazret Profetit Muhammed^{savs}. Kundërshtarët e mi nëse do të më gjykonin vetëm prej

⁵ *Dexhall* është fjalë arabe që do të thotë mashtrues i madh. (Përkthyesi)

kësaj, do t'u hapeshin sytë me kohë. Madje, unë do të isha i gatshëm t'u jepja një shumë të madhe të hollash, nëse do të sillnin ndonjë shembull tjetër të këtyre profecive në botë.

Por nëse dikush niset vetëm nga keqdashja e nga mungesa e logjikës dhe thotë se kjo ose ajo profeci nuk u përmbush, atëherë nuk kemi rrugë tjetër veçse ta quajmë një akuzë të tillë si të turpshme dhe paragjykim. Nëse kundërshtarët do të mblidheshin mes njerëzve për të zbuluar të vërtetën e këtyre profecive, do të detyroheshin të tërhiqeshin nga pretendimet e tyre, ose të shpalleshin si njerëz të paturpshëm. Nuk është gjë e vogël që mijëra profeci të përmbushen fjalë për fjalë dhe më pas ato të kenë edhe mijëra dëshmitarë të gjallë, përkundrazi, kjo është njësoj sikur t'ua tregosh njerëzve Zotin e Madhërishëm. Përveç kohës së Profetit Muhammed^{savs}, vallë, kur ka ndodhur që njerëzit të kenë parë që dikush të bënte mijëra profeci dhe ato të plotësoheshin një e nga një, me mijëra dëshmitarë okularë me vete?!

Unë jam i bindur se mënyra sesi Zoti i Madhërishëm po shfaqet nga afër dhe po i zbulon robët të Tij qindra çështje të së padukshmes në këtë kohë, shumë pak mund të ketë ndodhur në të kaluarën. Njerëzit së shpejti do të shohin se në këtë kohë po shfaqet **Fytyra** e Zotit të Madhërishëm, sikur Ai të zbresë prej qiellit. Për një kohë të gjatë Ai e mbajti Vetën të fshehtë. Ai u mohua, por heshti. Por tani Ai nuk do të qëndrojë më i fshehtë. Njerëzit do të shohin shembuj të atillë të fuqisë së Tij, që baballarët e tyre nuk i kanë parë kurrë. E gjithë kjo do të ndodhë sepse toka është prishur. Njerëzit nuk kanë më besimin te

Krijuesi i qiejve dhe i tokës. Me buzë ia përmendin emrin, por me zemër i kthejnë shpinën. Prandaj Zoti tha: Tani Unë do të ndërtoj një qiell të ri dhe një tokë të re. Kuptimi i kësaj fjalie është që toka ka vdekur, pra njerëzve tokësorë u janë bërë gurë zemrat, sikur ata të kenë vdekur fare, pasi Fytyra e Zotit nuk u shfaqet më. Gjithashtu, edhe shenjat qiellore të mëparshme që të gjitha kanë mbetur si tregime. Prandaj, Zoti deshi të ndërtojë një tokë të re dhe një qiell të ri. Çfarë është ky qiell i ri? Dhe çfarë është kjo tokë e re? Toka e re janë ato zemra të pastra, të cilat Zoti po i përgatit me Dorën e Vet, njerëz të cilët u shfaqën përmes Zotit dhe Zoti do të shfaqet përmes tyre. Kurse qielli i ri janë ato shenja, të cilat po shfaqen me urdhrin e Tij e nga dora e robit të Tij. Por mjerisht, bota u armiqësua me këtë manifestim të ri të Zotit. Ata asgjë nuk kanë në dorë, përveç tregimeve dhe Zoti i tyre është vetëm imagjinata e tyre. I kanë zemrat të shtrembëta, vullnetin të lodhur dhe sytë me perde.

Çfarë të themi për popujt e tjerë që kaherë e kanë humbur Zotin e vërtetë dhe që bijtë e njerëzve i bëjnë Zot. Shikoni pak gjendjen e muslimanëve, sa shumë ata janë larguar prej Tij. Janë bërë armiq të përbetuar të së vërtetës dhe kundërshtarë mizorë të rrugës së drejtë.

Për shembull, grupi *Nedvetul-Ulema* që pretendon të përfaqësojë Islamin, ose *Enxhuman Himajet-e-Islam* i Lahorit që u merr para muslimanëve në emër të Islamit, **a janë dashamirës të Islamit?** A janë këta **mbështetës** të rrugës së drejtë? A e dinë këta se çfarë gjëmash e shkelën Islamin dhe se çfarë praktike ka Zoti për ta ringjallur atë? Sinqerisht ju them të vërtetën, nëse unë nuk do të kisha ardhur,

pretendimet e tyre për mbrojtjen e Islamit do të ishin të pranueshme deri diku, por tani **këta janë nën akuzë nga Zoti që, pretenduan mbështetjen**, por kur iu shfaq ylli **prej qiellit**, ishin të parët që e mohuan.

E tani ata si do t'i përgjigjen Atij Zoti, i cili më dërgoi mua pikërisht në kohë?! Por ata nuk merakosen aspak për këtë. **Dielli** ka arritur gati zenitin, kurse për ta **është ende natë**. **Burimi i Zotit** ka çelur, por ata vijnë në qajnë në shkretëtirë. Po rrjedh një **lumë i dijeve qiellore** të Tij, por ata nuk kanë asnjë haber. Po shfaqen shenjat e Tij, por ata tregohen shpërfillës, dhe jo vetëm shpërfillës, por **janë armiqësuar me Xhematin e Zotit**. E kjo qenka ajo mbështetje për Islamin, ajo përhapje e Islamit dhe ajo mesimdhënie e Islamit që po u realizuaka nga duart e tyre! Por, me shpërfilljen e tyre a mund ta ndalin dot Vullnetin e vërtetë të Zotit, për të cilin kanë dhënë dëshmi të gjithë Profetët që nga fillimi?! Përkundrazi! Kjo profeci e Zotit së shpejti do të bëhet e vërtetë:

كَتَبَ اللَّهُ لَا غَلِيَّ أَنَا وَرُسُلِي

*(“Allahu e ka vendosur: Do të triumfojmë patjetër Unë dhe të dërguarit e Mi!”)*⁶

Si sot dhjetë vjet më parë, për vërtetësinë e robit të Tij, Zoti eklipsoi diellin dhe hënë në qiell gjatë muajit të Ramazanit, duke ngritur dëshmitarë trupin qiellor të ditës, si dhe trupin qiellor të natës dhe

⁶ El-Muxhadile 58:22.

kështu manifestoi **dy shenja**. Gjithashtu, në përputhje me profecitë e Profetëve, edhe në tokë Ai tregoi dy shenja, që janë:

Së pari, shenja që ju lexoni në Kuranin Famëlartë:

وَإِذَا الْعِشَاءُ عُطِّلَتْ ۖ

(*“Dhe kur devetë, me barrë dhjetëmuajshe, do të braktisen.”*)⁷,

dhe e lexoni edhe në hadith:

وَلْيُتْرَكَنَّ الْقَلَاصُ فَلَا يُسْعَى عَلَيْهَا-

(*“... me siguri devetë do të dalin jashtë përdorimit dhe askush nuk do të hipë mbi to.”*)⁸

dhe për të plotësuar këtë shenjë, po ndërtohet një hekurudhë në tokën e Hixhazit, pra midis Mekës dhe Medinës.

Së dyti, është shenja e murtajës, siç e ka thënë Zoti i Madhërishëm:

وَإِنْ مِنْ قَرْيَةٍ إِلَّا نَحْنُ مُهْلِكُوهَا قَبْلَ يَوْمِ الْقِيَمَةِ أَوْ مُعَذِّبُوهَا عَذَابًا شَدِيدًا

(*“Nuk ka vendbanim që, përpara ditës së kiametit, Ne të mos e shkatërrojmë atë ose të mos e ndëshkojmë me një ndëshkim të rëndë.”*)⁹

⁷ Et-Tekvir 81:5.

⁸ Sahih Muslim, kitab “El-iman”, bab “Nuzul ‘Isa ibni Merjem hakimen bi sheri’ati nebijjina Muhammed s.a.v.s.”, hadithi nr. 391.

⁹ Beni Israil 17:59.

Pra, Zoti organizoi lëvizjen e trenit në vend dhe po Ai dërgoi edhe murtajën, në mënyrë që si toka, ashtu edhe qielli të bëhen dëshmitarë.

Prandaj, **mos luftoni** me Zotin. Është budallallëk të luftoni me Të. Më përpara, kur Zoti deshi të bënte Ademin Kalif, engjëjt e ndaluan, por Zoti a u ndal duke dëgjuar fjalën e tyre?! Tani në kohën e krijimit të Ademit të dytë, Zoti tha:

أَرَدْتُ أَنْ أَسْتَخْلِفَ فَخَلَفْتُ آدَمَ-

“Unë desha të bëj Kalif, prandaj, e krijova këtë Adem.”

Tani më thoni, a mund ta ndalni ju dëshirën e Zotit?! Pse bëni hamendësime të kota dhe pse nuk ndiqni rrugën e bindjes? Mos bini në provë. Mbani mend mirë se askush nuk mund ta ndalë dëshirën e Zotit. Grindjet që ju bëni, nuk janë rruga e *takvasë*.

Po, nëse keni dyshim, ka një rrugë. Siç unë përmes shpalljes prej Zotit mora lajmin e mirë që një pjesë e njerëzimit që ndjekin mësimin tim, do të shpëtojnë nga murtaja, dhe më pas e botova, në të njëjtën mënyrë, nëse jeni dashamirës të vërtetë të popullit tuaj, kërkonit edhe ju dhe merrni prej Zotit për bashkëfetarët tuaj lajmin e mirë të shpëtimit se edhe ata do të ruhen nga murtaja dhe më pas, sikur unë, botojeni këtë njoftim anekënd, në mënyrë që njerëzit të kuptojnë se Zoti është me ju.

Madje, ky është një rast i mirë edhe për të krishterët. Ata gjithmonë thonë se shpëtimin e jep Jezusi. Prandaj, edhe ata kanë për detyrë të shpëtojnë të krishterët nga murtaja në këto ditë të vështira. **Ndër të gjitha grupet, grupi i pranuar** te Zoti do të jetë ai, të cilit do t'i dëgjohet

më fort kërkesa. Tashmë Zoti u ka dhënë mundësi të gjithëve që të mos bëjnë polemika të kota në tokë, por të dalin përpara për të treguar se sa të pranuar janë ata te Zoti, në mënyrë që edhe të shpëtojnë nga murtaja, edhe ta provojnë vërtetësinë e tyre. Kjo mundësi është e mirë sidomos për të krishterët e nderuar, të cilët kanë shpallur Mesihun **birin e Merjemes** si shpëtimtar të vetëm në botë dhe në ahiret. Nëse e besojnë me zemër Birin e Merjemes si Mbret të tokës dhe të ahiretit, të krishterëve u takon të shohin një model të **shpëtimit** duke përdorur **shlyerjen** të besimtarët e tyre.

Kjo metodë që u përmend, do t'i krijonte shumë lehtësi edhe qeverisë së shquar. Sekte të ndryshme që jetojnë në Indinë Britanike, që besojnë në vërtetësinë e fesë së tyre përkatëse, le të ndërmetësojnë për hallexhinjtë e vet pranë Zotit që ata besojnë, ose pranë ndonjë të adhuruari tjetër që mendojnë se është në vend të Zotit, në mënyrë që ta lirojnë grupin e tyre nga vështirësia e t'ia mundësojnë shpëtimin nga murtaja. Pra, të marrin ndonjë premtim të fortë nga Zoti i tyre e më pas ta botojnë përmes publikimeve, njësoj siç e kam bërë unë. Kjo metodë sjell vetëm të mirën e njerëzve dhe vërtetësinë e fesë së tyre përkatëse dhe, njëherësh, ndihmon qeverinë e vendit. Ç'dëshiron më shumë një shtet sesa shpëtimin e popullit të vet nga belaja e murtajës, në çfarëdolloj mënyre qoftë.

Në fund, dua t'u bëj me dije anëtarëve të Xhematit tim që gjenden në pjesë të ndryshme të Panxhabit dhe të Indisë më gjerë, se unë nuk i ndaloj ta marrin vaksinën. Ata, për të cilët ka vendim të prerë, duhet ta

marrin injektimin e vaksinës, duke iu bindur urdhrit të shtetit. Po kështu, është mirë të marrin vaksinën edhe ata të cilët janë lënë të lirë, por që nuk zbatojnë plotësisht mësimin tim, në mënyrë që të mos rrëshqasin dhe, gjithashtu, me gjendjen e tyre të keqe, të mos shkaktojnë dyshime te njerëzit, për sa i përket premtimit të Zotit. Për këdo që ka interes të dijë se cili është ky mësim, më poshtë, do ta paraqes shkurtimisht atë, dhe nëse do të ndiqet plotësisht, mund të shpëtojë nga sulmi i murtajës.

Mësimi

Le ta keni të qartë se nuk ka asnjë dobi të bëni *Bej'atin*¹⁰ vetëm me gojë, derisa nuk e praktikoni plotësisht me vendosmërinë e zemrës. Andaj, ai që praktikon plotësisht mësimin tim, hyn në shtëpinë time, për të cilën Zoti i Madhërishëm ka premtuar në fjalën e Vet:

إِنِّي أَحَافِظُ كُلَّ مَنْ فِي الدَّارِ-

¹⁰ Fjala *bej'at* është arabe بَيْعَتٌ që do të thotë *be*, *besë* e *besëlidhje*. Në kohën e Profetit Muhammed^{savs}, ata që donin të pranonin Islamin, bënin *bej'at* duke dhënë dorën e tyre në dorën e Profetit^{savs}. Me urdhrin e Zotit të Madhërishëm, Hazret Mirza Ghulam Ahmedi, Imam Mehdiu^{as}, e nisi këtë praktikë Profetike edhe në Xhematin Musliman Ahmedia. Madje, është edhe urdhri i Profetit Muhammed^{savs}, në të cilin ai u thotë muslimanëve të takojnë Imam Mehdiun e të bëjnë *bej'at* në dorën e tij, edhe nëse u duhet të kalojnë nëpër male me borë për të shkuar deri tek ai. (Përkthyesi)

Unë do të shpëtoj çdokënd që është brenda mureve të shtëpisë satel!

Këtu nuk do të thotë se në shtëpinë time janë vetëm ata që banojnë në këtë shtëpi prej balte e tullash, por do të thotë se edhe ata që më ndjekin plotësisht, hyjnë në shtëpinë time shpirtërore.

Që të më ndiqni mua, është e nevojshme të besoni me bindje se keni një Zot të Plotfuqishëm, të Qëndrueshëm, Krijues të gjithçkaje, dhe Ai është i Përherëshëm, i Përvetshëm dhe i Pandryshueshëm në atributet e Tij. Ai nuk është biri i dikujt dhe askush nuk është biri i Tij. Ai është i pastër nga vuajtjet, nga kryqëzimi e nga vdekja. Është i tillë që pavarësisht se është larg, gjendet afër dhe pavarësisht se është afër, gjendet larg dhe pavarësisht se është Një, ka manifestime të ndryshme. Kur njeriu sjell në vete një ndryshim të ri, Ai për të bëhet një Zot i ri dhe me të fillon të ketë marrëdhënie me një manifestim të ri. Kështu, njeriu në bazë të ndryshimit që bën në veten e tij, shikon ndryshim edhe në Zot. Por në të vërtetë, Zoti nuk pëson ndonjë ndryshim, përkundrazi, Ai është i Pandryshueshëm përgjithmonë dhe zotëron përsosmërinë absolute, por njeriu gjatë ndryshimeve të gjendjes shpirtërore, kur anon nga mirësia, Zoti i shfaqet me një manifestim të ri. Në çdo kohë sa herë njeriu bën një përparim të qenësishëm, edhe fuqia e Zotit të Madhërishëm i shfaqet me një përparim të tillë. Ai tregon fuqinë e Tij të jashtëzakonshme, vetëm atje ku shfaqet ndryshimi i jashtëzakonshëm. Kjo është pikërisht baza e mrekullive dhe e ndodhive të jashtëzakonshme. Ky Zot është kushti i Xhematit tonë. Atë besojeni dhe Atij jepini përparësi mbi veten tuaj, mbi rehatinë tuaj dhe mbi të gjitha

lidhjet tuaja. Provoni me vepra e me guxim vërtetësinë dhe besnikërinë në rrugën e Tij. Njerëzit e botës nuk i japin Atij përparësi mbi të dashurit e tyre, por ju jepini përparësi, në mënyrë që të shënoheni në qiell në Xhematin e Tij.

Është një praktikë e hershme e Zotit të tregojë shenjat e mëshirës. Por ju mund të përfitoni nga kjo praktikë e Tij, kur nuk do të ketë aspak ndarje mes jush dhe Atij; kur pëlqimi juaj të jetë pëlqimi i Tij dhe dëshirat tuaja të bëhen dëshirat e Tij, dhe kur në çdo situatë arritjeje a mosarritjeje, koka juaj të gjendet vetëm te pragu i Tij, që Ai të bëjë si të dojë. Po e bëtë këtë, në ju do të shfaqet Ai Zot, që është i fshehur prej një kohe të gjatë. A ka ndonjë mes jush që ta zbatojë këtë, të bëhet kërkues i pëlqimit të Tij dhe të mos mbetet i pakënaqur nga caktimet e Tij? Atëherë, kur të përballeni me vështirësinë, duhet ta hidhni hapin akoma më përpara, sepse ky është mjeti i përparimit tuaj. Bëni përpjekje duke përdorur gjithë fuqinë tuaj për të përhapur Njëshmërinë e Tij. Mëshironi robërit e Tij dhe mos u bëni keq as me gojë, as me dorë e as me ndonjë mjet tjetër. Gjithnjë përpiquni për dobinë e krijesave. Mos u mburrni ndaj askujt, qoftë ai nëpunësi juaj. Mos shani, edhe kur dikush ju shan. Bëhuni të duruar, të dhembshur, qëllimmirë dhe dashamirës ndaj gjithë njerëzimit, në mënyrë që të pranoheni. Ka plot që tregojnë dhembshuri, por janë ujë përbrenda. Ka plot që janë të pastër nga jashtë, por janë gjarpër përbrenda. Kështu, ju nuk mund të pranoheni pranë Tij, derisa nuk do të jeni të njëjtë së jashtmi e së brendshmi. Nëse jeni të mëdhenj, mëshironi të vegjlit, dhe jo të talleni me ta. Nëse jeni të ditur,

këshilloni të paditurit, dhe jo t'i poshtëroni duke reklamuar veten. Nëse jeni të pasur, shërbejini të varfrit, dhe jo të mburreni ndaj tyre me vetëpëlqim. Kini frikë nga rrugët e shkatërrimit. Kijeni frikë Zotin dhe përvetësoni *takvanë*.¹¹ Mos adhuron krijesat. Tërhiquni tërësisht drejt Mikut tuaj dhe shkëputeni zemrën nga bota. Bëhuni tërësisht të Atij dhe jetoni vetëm për Të. Urreni çdo papastërti e ligësi për hir të Tij, sepse Ai është i Pastër. Duhet që çdo mëngjes të dëshmojë për ju se keni kaluar natën me *takva* dhe çdo mbrëmje të dëshmojë për ju se keni kaluar ditën duke pasur drojë.

Mos u frikësoni nga mallkimet e kësaj bote, sepse ato zhduken shumë shpejt porsì tymi dhe ato nuk mund ta bëjnë ditën natë. Madje, frikësohuni nga mallkimi i Zotit që bie prej qiellit dhe atij që i bie, ia shkul rrënjën në të dyja botët. Ju nuk mund ta shpëtoni veten duke u shtirur, sepse Ai Zot që është Zoti juaj, depërton deri në thellësinë e zemrës së njeriut. A mund ta mashtroni Atë? Prandaj, bëhuni të drejtë, të çiltër, të pastër e të kulluar. Nëse ju ka mbetur qoftë një grimë errësire në shpirt, ajo do t'ju largojë gjithë dritën tuaj. Dhe nëse keni mburrje a dukje në ndonjë qoshe të vetes suaj, ose keni vetëpëlqim a dembeli, atëherë nuk jeni të denjë të pranoheni. Të mos ndodhë që ju të mashtroni veten vetëm me disa gjëra tuajat, duke menduar se e keni bërë gjithçka që kishit për të bërë. Sepse Zoti dëshiron që ta sillni ndryshimin e plotë në qenien tuaj. Ai ju kërkon një “vdekje”, pas së cilës, Vetë Ai do

¹¹ Druajtje dhe devotshmëri ndaj Zotit. (Përkthyesi)

t'ju “ringjallë”. Prandaj, pajtohuni me njëri-tjetrin sa më shpejt dhe faluani gabimet vëllezërve tuaj, sepse keqbërës është ai që nuk tregohet i gatshëm për t'u pajtuar me vëllain e tij. Ai do të shkëputet, sepse krijon përçarje. Lëreni vetveten në çdo formë dhe lërinë pakënaqësitë me njëri-tjetrin. Edhe kur të keni të drejtë, jini të përlulur në sjelljen tuaj sikur ju keni pasur faj, në mënyrë që të faleni nga Zoti. Mos i vini “dhjamë” shpirtit tuaj, sepse nga dera që ju jeni thirrur, nuk mund të hyjë një njeri “i dhjamosur”.

Sa fatkeq është ai që nuk i pranon këto fjalë, që buruan nga goja e Zotit dhe ia tregova unë. Nëse dëshironi që Zoti të kënaqet me ju në qiell, bashkohuni me njëri-tjetrin porsì dy vëllezër në një bark të vetëm. Më i nderuari mes jush është ai që i fal më shumë gjynahet vëllait të vet dhe më fatligu është ai që insiston dhe nuk ia fal, andaj ky i fundit nuk bën pjesë tek unë. Frikësohuni shumë nga mallkimi i Zotit, sepse Zoti është shumë i Shenjtë dhe shumë Sedërmadh. I ligu nuk mund të gëzojë afrimin me Zotin. Mburraveci nuk mund të gëzojë afrimin me Zotin. Mizori nuk mund të gëzojë afrimin me Zotin. Tradhtari nuk mund të gëzojë afrimin me Zotin. Dhe çdokush që nuk ka sedër për emrin e Tij, nuk mund të gëzojë afrimin me Të. Të gjithë ata që lëshohen pas botës, si qentë, milingonat ose hutat, dhe rrinë rehat vetëm për këtë botë, nuk mund të gëzojnë afrimin me Të.

Çdo sy i papastër është larg prej Tij. Çdo zemër e papastër është larg prej Tij. Ai që është në zjarr për hir të Tij, do të shpëtojë nga zjarri. Ai që qan për hir të Tij, do të qeshë. Ai që shkëputet nga bota për hir të

Tij, do ta gjejë Atë. Ju me zemër të singertë dhe me vërtetësi dhe angazhim të plotë bëhuni mik i Zotit, që edhe Ai të bëhet Miku juaj.

Mëshironi nëpunësit, bashkëshortet dhe vëllezërit tuaj të dobët, që edhe ju të mëshiroheni në qiell. Bëhuni singërisht të Atij, që edhe Ai të bëhet juaji. Bota është vatër e mijëra gjëmash dhe njëra prej tyre është edhe murtaja. Andaj, hidhni hapin e vërtetë pranë Zotit, që Ai t'ju largojë këto gjëma. Asnjë gjëmë nuk bëhet në tokë, derisa nuk vjen urdhri nga qielli. Po ashtu, asnjë gjëmë nuk mund të largohet, derisa nuk zbret mëshira nga qielli. Andaj, në jeni të mençur, kapni rrënjën e jo degën.

Nuk ju ndaloj të përdorni ilaçet dhe mjetet, por ju ndaloj të besoni në to. Përfundimisht do të ndodhë ajo që do Zoti. Nëse dikush ka forcën [e besimit], le ta dijë se pozita e mbështetjes ndaj Zotit është më e madhe se çdo pozitë tjetër.

Një mësim i rëndësishëm për ju është që të mos e lini Kuranin Famëlartë si të braktisur, sepse pikërisht në të gjendet jeta juaj. Ata që nderojnë Kuranin, do të nderohen në qiell. Dhe ata që Kuranit i japin përparësi mbi çdo *hadith* dhe mbi çdo thënie tjetër, atyre do t'u jepet përparësi në qiell. Nuk ka më libër tjetër në faqen e dheut për njerëzimin, përveç Kuranit. Dhe nuk ka më ndërmjetësues tjetër për të gjithë bijtë e Ademit, përveç **Muhammedit të Zgjedhur** *sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem*.¹² Andaj, përpikuni të keni dashuri të singertë me këtë Profet

¹² Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!

madhështor e fisnik dhe askujt tjetër mos i jepni asnjë lloj epërsie mbi të, në mënyrë që të shënoheni të shpëtuar në qiell.

Mbani mend! Shpëtimi nuk është diçka që do ta gjeni pas vdekjes. Por, shpëtimi i vërtetë e tregon dritën e vet që në këtë botë. Kush është i **shpëtuari**? Ai që beson fuqimisht që Zoti është i Vërtetë dhe që Muhammedi *sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem* është **ndërmjetës** mes Atij dhe të gjithë krijesave dhe që nën kupën e qiellit nuk ka asnjë të dërguar të **barabartë** me të, dhe asnjë libër të **barabartë** me Kuranin dhe që për askënd tjetër Zoti nuk dëshiroi përjetësinë, **përveçse për këtë Profet fisnik, i cili është i gjallë përgjithmonë**. Për përjetësinë e tij Zoti ka vënë themelin duke e vazhduar bekimin e sheriatit dhe spiritualitetit të tij deri në kiamet. Aq saqë po përmes fuqisë bekuese shpirtërore të Profetit Muhammed^{savs}, Ai dërgoi këtë **Mesih të Premtuar**, ardhja e të cilit ishte e domosdoshme për ngrehinën e Islamit. Sepse ishte e nevojshme që bota të mos përfundojë, pa ardhur një Mesih shpirtëror për umetin e Muhammedit, mu ashtu siç u dërgua Mesihu për umetin e Musait. Këtë e shënjon edhe ajeti:

إِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ﴿١﴾ صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ

[Na udhëzo në rrugën e drejtë, në rrugën e atyre që i bekove].¹³

Musai gjeti pasurinë që popujt e mëparshëm e kishin humbur dhe Hazret Muhammedi *sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem* gjeti pasurinë që e

¹³ El-Fatiha 1:6-7.

kishte humbur umeti i Musait. Tani, umeti i Muhammedit e ka zëvendësuar umetin e Musait, por umeti i Muhammedit është mijëra shkallë më i lartë në madhësi: i ngjashmi i Musait është më i lartë se Musai dhe i ngjashmi i Birit të Merjemes është më i lartë se Biri i Merjemes. Ky Mesih i Premtuar jo vetëm që erdhi katërmëdhjetë shekuj pas Profetit të Shenjtë *sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem*, siç Mesihu biri i Merjemes erdhi katërmëdhjetë shekuj pas Musait,¹⁴ madje erdhi në një kohë kur edhe muslimanët janë në të njëjtën gjendje, siç ishin hebrenjtë në kohën e ardhjes së Mesihut të birit të Merjemes. Dhe ai Mesih jam unë. Zoti bën atë që do. Naiv është ai që lufton me Të dhe i pamend është ai që akuzon kundër Tij duke thënë – jo kështu po ashtu. Ai më dërgoi me shenja të ndritshme, të cilat janë më shumë se dhjetë mijë.

Njëra prej këtyre shenjave është edhe murtaja. Andaj, vetëm ai që bën *Bej'atin* e sinqertë me mua, bëhet ndjekësi im i sinqertë. Ai i lë të gjitha dëshirat e veta, duke u kredhur në bindjen ndaj meje dhe bëhet i tillë që shpirti im do të ndërmjetësojë në këto ditë të gjëmshme. **Prandaj, o ju të gjithë** që e llogaritni veten në Xhematin tim! Në qiell do të **llogariteni** në Xhematin tim vetëm atëherë kur me të vërtetë do të ndiqni rrugët e *takvasë*. Andaj, kryejini namazet tuaja të pesë vakteve me kaq shumë

¹⁴ Hebrenjtë [ata prej tyre që pranuan Mesihun] unanimisht janë të mendimit për historinë e tyre që Isai u erdhi në krye të shekullit katërmëdhjetë pas Musait. Për më shumë, lexoni historinë e hebrenjve. **(Autori)**

frikë e përulësi, sikur ta shihni Zotin e Madhërishëm dhe plotësojini agjërimet tuaja për hir të Zotit me besnikëri. Çdokush që përmbush kushtet e zekatit, ta paguaj zekatin dhe ai që ka obligim haxhin dhe që nuk ka ndonjë pengesë, le ta bëjë haxhin. Bëni mirësi duke e zbukuruar atë dhe hiqni dorë nga ligësia duke treguar neveri ndaj saj. Mbajeni mend mirë! Asnjë vepër që është e zbrazët nga *takvaja*, nuk mund të arrijë tek Zoti. Rrënja e çdo mirësie është *takvaja*. Andaj, nuk u prish edhe vepër, së cilës nuk iu prish kjo rrënjë.

Është e domosdoshme që ju të sprovoheni përmes një sërë brengash dhe vështirësish, ashtu siç u sprovuan besimtarët e mëparshëm. Prandaj, **kini kujdes!** Të mos rrëshqitni. Toka nuk mund t'ju dëmtojë asnjë fije, nëse keni **lidhje të fortë** me qiellin. Sa herë që do të dëmtoheni, dëmi do t'ju vijë nga duart tuaja, e jo nga duart e armikut. Nëse juve ju ikën i gjithë nderi tokësor, Zoti do t'ju japë një nder të përjetshëm në qiell. Andaj, ju mos e lini Atë.

Është e sigurt që ju do të lëndoheni dhe do t'ju mohohen shumë nga shpresat tuaja. Por ju mos u brengosni në këto raste, sepse Zoti juaj ju sprovon nëse jeni apo jo të qëndrueshëm në rrugën e Tij. Nëse doni që edhe engjëjt në qiell t'ju lëvdojnë, pranoni lëndimet e jini të gëzuar; dëgjoni sharjet dhe falënderoni; shikoni dështimet dhe mos u shkëputni nga Zoti.

Ju jeni Xhemati i fundit i Zotit, andaj, tregoni atë vepër të mirë, që është e skajshme në lartësinë e saj. Çdokush nga ju që do të bëhet i ngathët, do të flaket nga Xhemati si diçka e neveritshme, do të vdesë i dëshpëruar

dhe nuk do ta dëmtojë Zotin aspak. Unë ju njoftoj me shumë gëzim që Zoti juaj me të vërtetë ekziston. Edhe pse të gjithë janë krijesat e Zotit, por Zoti zgjedh njeriun, i cili zgjedh Zotin; Zoti i afrohet atij, i cili i afrohet Zotit dhe Zoti nderon atë, i cili e nderon Zotin.

Ejani tek Zoti, duke drejtuar zemrat dhe duke pastruar gjuhët, sytë dhe veshët tuaj, sepse Ai do t'ju pranojë. Gjithçka që Zoti dëshiron në besimin tuaj është që Zoti është një dhe Muhammedi^{savs} është Profeti i Tij; ai është *Vula e Profetëve*; më i larti i të gjithëve, tanimë pas tij nuk ka asnjë profet, përveç atij që është i veshur me mantelin e tij, duke qenë një hije e tij, sepse shërbëtori nuk është i ndarë nga padroni, porsì dega që nuk është e ndarë nga trungu i vet. Andaj, ai që përhubet përsosmërisht në Padronin e tij (Muhammed^{savs}) dhe merr titullin **Profet** prej Zotit, nuk e prish *Vulën e Profetëve*. Ashtu siç kur shikoni veten në pasqyrë, ju nuk mund të jeni dy, por vetëm një, edhe pse dukeni dy. Dallimi është se njëri është i vërteti dhe tjetri pasqyrimi i tij. Zoti deshi që pikërisht kështu të ishte Mesihu i Premtuar. **Ky është pikërisht sekreti** që Hazret Profeti Muhammed^{savs} thotë: “Mesihu i Premtuar do të varroset në varrin tim” që do të thoshte se **unë dhe ai jemi të njëjtë** dhe jo të ndarë.

Dijeni që Isai biri i Merjemes ka ndërruar jetë dhe varri i tij gjendet në lagjen Khanjar, Srinagar të Kashmirit.¹⁵ Zoti i Lartësuar në Librin e Tij të Madhërishëm ka njoftuar për vdekjen e tij. Nëse ky ajet nuk flet për vdekjen e tij, atëherë Kurani në cilin ajet tjetër na njofton për këtë ngjarje? Pra, ajetet në lidhje me vdekjen e tij nëse nuk e kanë kuptimin e vdekjes, siç mendojnë kundërshtarët tanë, rezultojnë që Kurani në asnjë ajet nuk ka njoftuar për vdekjen e tij. Zoti njoftoi për vdekjen e Profetit tonë^{savs}, por në asnjë vend në Kuran nuk paska njoftuar për vdekjen e Isait! Cili qenka sekreti? Por nëse thoni se pikërisht ajeti i shënuar më poshtë flet për vdekjen e Isait:

فَلَمَّا تَوَفَّيْتَنِي كُنْتُ أَنْتَ الرَّقِيبَ عَلَيْهِمْ

“Dhe kur ma more shpirtin, Ti ishe Mbikëqyrësi i tyre.”^{16,17},

¹⁵ Studiues të krishterë gjithashtu kanë dhënë këtë mendim. Shikoni librin *“Supernatural Religion”* f. 522. Nëse kërkon më shumë shpjegime, shikoni në librin tim *“Tohfa Gularvijah”* f. 139. (Autori)

¹⁶ El-Maide 5:118.

¹⁷ Po ky ajet tregon se Hazret Isai^{as} nuk do të kthehet më në këtë botë, sepse po erdhi sërish, përgjigjja e tij e përmendur në këtë ajet do të rezultojë e gënjeshtërt, që ai nuk ka dijeni aspak për devijimin e të krishterëve. Ai që kthehet përsëri në këtë botë për të jetuar dyzet vjet të tjera, për të parë miliona të krishterë që e besojnë atë si Zot, për t’ua thyer kryqin dhe për t’i kthyer të gjithë të krishterët në muslimanë, si mund të thotë përpara Zotit të Madhërishëm ditën e kiametit: Nuk kam dijeni për devijimin e të krishterëve!?! (Autori)

atëherë, ky ajet qartazi tregon se ai ka vdekur përpara se të krishterët të prisheshin. Me fjalë të tjera, nëse ajeti “*Felemmā teveffejteni*” do të thotë që Zoti e ngriti Isain të gjallë me gjithë trup, atëherë pse Allahu nuk e përmendi në Kuran në asnjë vend vdekjen e një njeriu të tillë, besimi në jetën e të cilit ka shkatërruar qindra mijëra njerëz?! A thua që Zoti e mbajti të gjallë përgjithmonë, në mënyrë që njerëzit ta adhuronin idhullin e tij dhe ta humbnin besimin?! Pse nuk thua se nuk paskan pasur faj njerëzit, por Vetë Zoti e bëri gjithë këtë, vetëm që t’i devijonte ata?! Mbajeni mend mirë! Pa vdekjen e Jezusit, besimi i kryqit nuk mund të vdesë. Andaj, çfarë dobie do të keni të besoni se ai është i gjallë, duke e kundërshtuar mësimin e Kuranit?! Lëreni Isain të vdesë, që kjo fe të ringjallet. Zoti në Fjalën e Tij ka treguar për vdekjen e Mesihut dhe i Dërguari i Allahut^{savs}, gjatë natës së Miraxhit, atë e ka parë bashkë me të vdekurit. E prapë nuk doni ta besoni?! **Çfarë besimi qenka ky?!** Vallë, po u dhënkeni epërsi rrëfimeve të njerëzve mbi Fjalën e Zotit! Çfarë feje qenka kjo?!¹⁸

¹⁸ Kurani Famëlartë, në një ajet të tij, qartazi jep shenja të Kashmirit dhe thotë se Mesihu dhe nëna e tij mërguan drejt atij vendi, siç thotë:

وَأَوْيَتْهُمَا إِلَى رُبُوعٍ ذَاتِ قَرَارٍ وَ مَعِينٍ ﴿٥١﴾

“*Ne strehuam Isain dhe nënën e tij në një kodrinë, që sillte qetësi dhe kishte burime uji.*” (El-Muminun 23:51). Në këtë ajet, Zoti i Madhërishëm jep pamjen e Kashmirit.

Gjithashtu, i Dërguari ynë *sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem* jo vetëm që dëshmoi që e ka parë Isain në mesin e shpirtrave të të vdekurve, por duke vdekur edhe vetë, tregoi që askush nuk mbeti i gjallë përpara tij. Kështu që, me besimin në jetën e Isait^{as}, kundërshtarët tanë e braktisin edhe Kuranin, edhe sunetin e Profetit^{savs}, sepse vdekja është praktika e Profetit tonë. Nëse Isai do të ishte i gjallë, do të ishte fyese nëse i Dërguari ynë të vdiste. Prandaj, duke mos e pranuar vdekjen e Isait, ju nuk jeni më as të sunetit (*Ehklus-sunneh*) e as të Kuranit (*Ehlul-Kuran*).

Unë nuk jam mohues i madhështisë së Hazret Isait^{as}, ndonëse Zoti më njoftoi mua që Mesihu i Muhammedit është më i lartë se Mesihu i Musait. Në të vërtetë, unë e respektoj jashtëzakonisht shumë Mesihun, birin e Merjemes, sepse në aspektin shpirtëror, jam *Khātemul-khulefā* [Vula e kalifëve], ashtu siç Mesihu biri i Merjemes ishte *Khātemul-khulefā* për umetin e Bijve të Izraelit. Në umetin e Musait, biri i Merjemes ishte Mesihu i Premtuar dhe në umetin e Muhammedit unë jam Mesihu i Premtuar. Prandaj, unë e respektoj atë me emrin e të cilit kam ardhur. Ngatërrestar dhe shpifës është ai që më akuzon që unë nuk

Fjala *āwā* në gjuhën arabe do të thotë strehim që i jepet dikujt për ta nxjerrë atë nga problemi a vështirësia. Përpara ngjarjes së kryqëzimit, Isai dhe nëna e tij nuk patën ndonjë kohë të vështirë të atillë, që atyre t'u jepej strehë për shpëtim. Kjo tregon që Zoti i Madhërishëm i strehoi ata në atë kodrinë, pikërisht pas ngjarjes së kryqëzimit. (Autori)

e respektoj Mesihun birin e Merjemes. Përkundrazi, jo vetëm Mesihun, por unë respektoj të katër vëllezërit e tij,¹⁹ sepse të pestë janë bij të së njëjtës nënë. Jo vetëm kaq, unë konsideroj të shenjta të dyja motrat e Mesihut, sepse të gjithë këta i lindi Virgjëresha Merjeme.

Merjemja ka meritën që e ndaloi veten nga martesja. Më pas, nga insistimi i vazhdueshëm i njerëzve të mëdhenj të popullit, pranoi të martohej, për shkak të shtatzënisë. Edhe pse disa njerëz e akuzojnë se përse e kundërshtoi mësimin e Tevratit, duke bërë martesë gjatë shtatzënisë dhe përse e shkeli pa të drejtë betimin për të qenë e virgjër dhe përse vuri bazën e poligamisë, duke u martuar me Jozefin zdrukthëtar, i cili që i martuar, megjithatë, unë them se të gjitha këto situata të jashtëzakonshme iu imponuan. Dhe në këto raste, ata ishin për t'u mëshiruar, e jo për t'u akuzuar.

Pas këtyre, e përsëris që ju të mos mjaftoheni me *Bej'atin* sipërfaqësor, sepse kjo nuk vlen për asgjë. Zoti ju sheh zemrat dhe në bazë të atyre do t'ju trajtojë. Dëgjoni, unë po lirohem nga përgjegjësia e kumtimit, duke ju thënë se mëkati është një helm, mos e konsumoni atë. Mosbindja ndaj Zotit është një vdekje e fëlliqtë, ruhuni prej saj. Lutuni që t'ju vijë forca. Ai që gjatë lutjes nuk beson se Zoti është i Plotfuqishëm për çdo gjë, me

¹⁹ Mesihu Jezus kishte katër vëllezër dhe dy motra të vërtetë sepse ishin fëmijët e Merjemes dhe të Jozefit. Emrat e vëllezërve ishin: Juda, Jakobi, Simoni dhe Josa, kurse emrat e motrave ishin: Assia dhe Lydia. Shikoni librin: *Apostolic Records* nga Father John Allen Giles, London, 1886, f. 159, 166. (Autori)

përjashtim të asaj që është kundër Fjalës së Tij, nuk është prej Xhematit tim. Ai që nuk heq dorë nga gënjeshtria dhe mashtrimi, nuk është prej Xhematit tim. Ai që është i mbërthyer në lakminë e kësaj bote dhe nuk e shikon fare ahiretin, nuk është prej Xhematit tim. Ai që me të vërtetë nuk i jep përparësi besimit mbi botën, nuk është prej Xhematit tim. Nuk është prej Xhematit tim edhe ai që nuk pendohet thellësisht për çdo mëkat dhe për çdo vepër të keqe, si pirja e alkoolit, bixhozi, shikimi i ndaluar, tradhtia, mitëmarrja dhe çdolloj shpërdorimi. Ai që nuk kryen namazet e pesëvaktëve, nuk është prej Xhematit tim. Ai që nuk rri i angazhuar në lutje dhe nuk e përkujton Zotin me përlësi, nuk është prej Xhematit tim. Ai që nuk e lë shoqërinë e keqe që ndikon negativisht tek ai, nuk është prej Xhematit tim. Ai që nuk i respekton prindërit e vet dhe nuk u bindet në të gjitha çështjet, të cilat nuk bien ndesh me Kuranin, dhe që është i pakujdesshëm në përkushtimin ndaj tyre, nuk është prej Xhematit tim. Ai që nuk sillet butësisht dhe mirësisht me bashkëshorten si dhe me njerëzit e saj, nuk është prej Xhematit tim. Ai që privon fqinjin edhe nga të mirat e vogla, nuk është prej Xhematit tim. Ai që nuk dëshiron ta falë atë që i ka bërë keq dhe mban urrejtje për të, nuk është prej Xhematit tim. Çdo burrë që e tradhton gruan e vet dhe çdo grua që tradhton burrin e vet, nuk është prej Xhematit tim. Ai që shkel premtimin e bërë gjatë *Bej'atit* në ndonjë aspekt, nuk është prej Xhematit tim. Ai që me të vërtetë nuk më pranon mua si Mesih të Premtuar dhe Imam Mehdi, nuk është prej Xhematit tim. Ai që nuk është i gatshëm të më bindet mua në çështjet e njohura, nuk është prej Xhematit tim. Ai që qëndron në shoqërinë e kundërshtarëve, duke

pranuar atë që thonë ata, nuk është prej Xhematit tim. Çdokush që bën marrëdhënie të jashtëligjshme, çdo keqberës, pijanec, vrasës, vjedhës, kumarxhi, tradhtar, ryshfetçi, zhvatës, mizor, gënjeshtar, mashtrues dhe ai që rri me ta, ai që shpif ndaj vëllezërve dhe motrave, ai që nuk pendohet për veprat e tij të këqija dhe që nuk heq dorë nga shoqëritë e mbrapshta, nuk është prej Xhematit tim.

Të gjitha këto janë helme, dhe duke i konsumuar këto, ju kurrresi nuk mund të shpëtoni dot. Errësira dhe drita nuk mund të bashkohen në një vend. Çdokush që ka karakter të pështjellë dhe që nuk është i pastër me Zotin, kurrresi nuk mund të gëzojë bekimin që u jepet zemërpastërve. Sa fatlumë janë ata që pastrojnë zemrën e vet dhe arrijnë të heqin çdolloj papastërtie duke lidhur besën e besnikërisë me Zotin e tyre, sepse ata kurrresi nuk do të shkatërrohen. Nuk është e mundur që Zoti t'i turpërojë ata, sepse ata janë të Zotit dhe Zoti është i atyre. Ata do të shpëtojnë nga çdo gjëmë. I pamend është ai që armiqësohet me ta, sepse ata janë në prehrin e Zotit dhe Zoti qëndron në mbështetje të tyre. **Kush besoi në Zot?** Vetëm ai që u përngjau këtyre.

Po kështu, i pamend është edhe ai që ndjek një të ligë, sepse edhe ai do të shkatërrohet. Që kur Zoti ka krijuar qiellin dhe tokën, kurrë nuk ka ndodhur që Ai të ketë shkatërruar, të ketë shpartalluar dhe të ketë asgjësuar të dëlirët. Përkundrazi, Ai gjithmonë ka treguar mrekulli në favor të tyre, dhe do të tregojë edhe tani. Ai Zot është shumë besnik dhe bën çudira për besnikët e Tij. Bota dëshiron t'i gllabërojë ata dhe çdo armik u kërcet dhëmbët. Por Ai që është Miku i tyre, i shpëton në çdo

vend shkatërrues duke u dhënë atyre fitore në çdo fushë. Sa me fat është ai që **nuk e lëshon pragon e Atij Zoti**. Ne Atë e besuam dhe Atë e njohëm. **Ai Zot është** Zoti i të gjithë botës që më dërgoi shpalljen, që tregoi **shenja madhështore** për mua, që më dërgoi në këtë kohë si **Mesih të Premtuar** dhe nuk ka zot tjetër përveç Atij, as në qiell e as në tokë. Ai që nuk e beson Atë, është i privuar nga fati dhe gjendet në prangat turpëruese.

Porsi drita e diellit neve na erdhi shpallja e Zotit tonë. Ne e kemi parë me sy që pikërisht Ai është Zoti i gjithësisë dhe nuk ka zot tjetër përveç Atij. Sa i Plotfuqishëm dhe i Qëndrueshëm është Ai Zot që kemi gjetur! Sa shumë fuqi madhështore zotëron Ai që kemi parë! E vërteta është që asgjë nuk është e pamundur për Të, përveç asaj që bie ndesh me Librin dhe premtimin e Tij. Prandaj, kur të luteni, mos u lutni si të ashtuquajtur “natyralistë” të paditur, të cilët me mendimin e vet kanë përcaktuar ligjin e natyrës por që nuk e ka vulën e Librit të Zotit. Në fakt, ata vetë janë të refuzuar dhe atyre kurrësi nuk u pranohen lutjet. Ata janë të verbër, e jo që shohin; janë të vdekur, e jo të gjallë. Ata Zotit ia tregojnë ligjin e tyre të sajuar dhe u vënë kufi fuqive të panumërta të Tij dhe kështu, e pandehin të dobët. Sipas gjendjes së tyre ata do të gjykohen.

Prandaj, kur të ngrihesh për t’u lutur, të duhet të jesh i bindur plotësisht që Zoti yt është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Atëherë do të të pranohet lutja dhe ti do të shohësh çudirat e fuqisë së Zotit që kam parë edhe unë. Dëshmia ime është okulare e jo prej historive. Atij që nuk beson se Zoti ka çdo fuqi, si mund t’i pranohet lutja dhe si mundet që ai të ketë vullnet

për të bërë lutje gjatë vështirësive të mëdha, zgjidhja e të cilave sipas tij thyeka ligjin e natyrës?! Por, o njeri fatbardhë, ti mos vepro kështu! Zoti yt është Ai që mban të varur yjet e panumërta, pa i mbështetur ato me ndonjë shtyllë, Ai që krijoi tokën dhe qiellin nga asgjëja. Vallë, Atë e paragjykon ti se me demek nuk paska mundësi të të realizojë një dëshirë?!²⁰ Përkundrazi, paragjykimi yt ty do të të bëjë të mbetesh i privuar.

Zoti ynë bën mrekulli të panumërta, por i shohin vetëm ata që bëhen të Atij me vërtetësi dhe besnikëri. Ai nuk u shfaq mrekullitë e Tij të tjerëve që nuk besojnë me bindje në fuqitë e Tij dhe që nuk janë të vërtetë e

²⁰ Asnjë punë nuk është e pamundur për Zotin. Po, Libri i Zotit ka treguar një ligj për lutjet, që nga mëshira e madhe, Zoti e trajton njeriun e mirë si shok. Pra, herë e lë dëshirën e Vet dhe atij ia plotëson lutjen, siç e tha Ai Vetë:

ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ

“Mu lutni Mua, do t’ju pranoj”, (El-Mu’min 40:61), e herë vendos sipas dëshirës së Tij, siç e tha:

وَلَنَبْلُوَنَّكُمْ بِشَيْءٍ مِّنَ الْخَوْفِ وَالْجُوعِ

“Ne patjetër që do t’ju sprovovjmë, duke ju përballur me pak frikë, me pak uri”, (El-Bekare 2:156). Ai kështu vendosi, në mënyrë që herë ta trajtojë njeriun sipas lutjes së tij, duke e bërë të përparojë në njohjen ndaj Tij dhe herë të veprojë sipas dëshirës së Vet, duke i dhënë njeriut pëlqimin e Tij, duke e ngritur në grada dhe duke e bërë të përparojë në rrugët e udhëzimit, përmes dashurisë. (Autori)

besnikë ndaj Tij. Sa fatkeq është ai njeri që ende nuk di se ai ka një Zot, i cili ka fuqi mbi çdo gjë! Parajsa jonë është Zoti ynë. Kënaqësitë tona më të larta gjenden në Zotin tonë, sepse ne e pamë Atë dhe çdolloj bukuri gjetëm në Të. Kjo pasuri është me vlerë ta marrësh nëse e gjen duke dhënë edhe jetën. Dhe ky rubin është me vlerë ta blesh edhe sikur të kushtojë sa e gjithë qenia jote. **O të humbur, vraponi drejt këtij burimi se do t'ju shuajë etjen.** Ky është burimi i jetës që do t'ju shpëtojë. Ç'të bëj unë? Si mund ta gdhend në zemrat e njerëzve këtë lajm të gëzuar? Me çfarë **daulleje** t'i **njoftoj** njerëzit se Ky është Zoti i tyre? Dhe me çfarë ilaçi t'ua kuroj veshët që ata të fillojnë të dëgjojnë?

Nëse bëheni të Zotit, dijeni se Zoti është juaji. Ju do të jeni në gjumë, kurse Zoti i Madhërishëm për ju do të rrijë zgjuar. Ju do të jeni të shkujdesur nga armiku, kurse Zoti do ta vëzhgojë atë dhe do ta shpartallojë planin e tij. Ju ende nuk e dini se çfarë forcash ka Zoti juaj, sepse po ta dinit, nuk do t'ju vinte asnjë ditë e tillë që të brengoseshit kaq shumë për botën. Një njeri që zotëron një thesar, vallë, a mund të qajë dhe a mund të pikëllohet e të shkatërrohet kur humb vetëm një qindarkë. Po të ishit në dijeni të thesarit që Zoti juaj ju vjen në ndihmë për çdo nevojë, pse do të bëheshit kaq të vdekur për botën?! Zoti është një **thesar i bukur**, çmojeni Atë, sepse Ai është Ndihmësi në çdo hap tuajin. Pa Atë ju jeni asgjë dhe as planet dhe mjetet tuaja nuk mund të bëjnë ndonjë gjë.

Mos i ndiqni popujt e tjerë, që ranë përmbys vetëm mbi mjetet. Porsi gjarpri që lëpin dheun, edhe ata lëpinë “dheun” e mjeteve materiale.

Porsi hutat dhe qentë që hanë ngordhësirën, edhe ata kanë kafshuar ngordhësirën. Ata i janë larguar shumë Zotit, adhuruan njerëz, hëngrën derrin, pinë alkoolin si ujë dhe tej mase varën shpresat vetëm te mjetet, duke mos i kërkuar fuqi Zotit dhe kështu, ata kanë vdekur dhe shpirti qiellor u është larguar në atë mënyrë, sikur pëllumbi kur braktis folenë e vet. Ata kanë lebrozën e adhurimit të botës, e cila ua hëngri të gjitha organet e tyre të brendshme. Andaj, kini frikë nga kjo lebrozë.

Unë nuk ju ndaloj të përdorni mjetet deri në masën e nevojshme, por ju ndaloj të kërkonit vetëm mjetet, siç i kërkojnë popujt e tjerë, duke e harruar Zotin, pra pikërisht Atë që u mundëson mjetet. Po të keni sy, do ta shikoni se vetëm Zoti ekziston dhe gjithçka është asgjë. Ju as nuk mund të zgjasni dorën dhe as nuk mund ta mblidhni atë, përveçse me lejen e Tij. Një “i vdekur” tallet me Të, por për të do të ishte më mirë të vdiste sesa të tallej në këtë mënyrë.

Kujdes! Mos i lakmoni popujt e tjerë duke menduar se kanë përparuar shumë në planet e kësaj bote dhe se edhe ju duhet të kishit ndjekur hapat e tyre. Dëgjoni dhe kuptojeni, se ata janë tërësisht në padije dhe pavëmendje ndaj Atij Zoti që ju thërret ju drejt Vetes. Çfarë është Zoti i tyre? Vetëm një njeri i dobët! Prandaj, ata janë lënë të shkujdesur. Unë nuk ju ndaloj nga punët dhe tregtitë e kësaj bote, por ju ndaloj t’i ndiqni ata të cilët gjithçka kanë vetëm botën. Madje gjithmonë Zotit kërkojini forcën dhe mundësinë në çdo punë tuajën, qoftë ajo për botën apo për besimin, por jo me buzë të thata; duhet të besoni me të vërtetë se çdo bekim zbret prej qiellit. Ju do të bëheni të drejtë atëherë kur të keni

ndonjë punë, ose kur të përballeni me ndonjë vështirësi, përpara se të merreni me mjetet, ta mbyllni derën e të bini te Pragu i Zotit e t'i thoni: “Kemi këtë vështirësi, o Zot, Ti përmes bekimit Tënd na e largo”. Atëherë Shpirti i Shenjtë do t’ju ndihmojë, dhe juve do t’ju hapet një rrugë nga e padukshmja.

Mëshironi veten tuaj dhe mos ndiqni ata të cilët kanë shkëputur lidhjen e tyre me Zotin dhe që kanë rënë tërësisht mbi mjetet, aq saqë as nuk thonë *inshaAllah* me gojë, për t’i kërkuar forcë Zotit. Zoti ju haptë sytë që të shihni se Zoti është trari i të gjitha përpjekjeve tuaja! A mund të qëndrojnë çatia, nëse bie trari? Përkundrazi, edhe ajo do të rrëzohet përnjëherë dhe ka mundësi të shkaktojë edhe viktima të shumta. Në të njëjtën mënyrë, edhe përpjekjet tuaja pa ndihmën e Zotit, nuk mund të qëndrojnë. Nëse nuk do t’i kërkonin ndihmë Atij, dhe nëse nuk do ta bëni këtë si shprehi për t’i kërkuar ndihmë Atij, nuk do të gëzoni asnjë sukses. Përfundimisht do të vdisni me dëshpërim të madh.

Mos mendoni se përse atëherë popujt e tjerë kanë sukses, ndërkohë që ata as nuk e njohin Atë Zot, i cili është Zoti juaj i Përsosur dhe i Plotfuqishëm. Përgjigjja e kësaj është që për shkak se ata hoqën dorë nga Zoti, kanë rënë në sprovën e dynjasë. Atë që braktis Zotin e që dashurohet me qejfet dhe kënaqësitë e kësaj bote dhe dëshiron fort pasuritë e saj, Zoti nganjëherë e sprovon duke ia hapur dyert e botës, por duke e lënë tërësisht të varfër dhe lakuriq për nga besimi. Një i tillë, më në fund vdes vetëm në hallet e dynjasë dhe bie në xhehenemin e përjetshëm. Dhe nganjëherë Zoti sprovon dikë duke e lënë të dështuar

edhe në këtë botë. Por, kjo sprova e dytë nuk është më e rëndë sesa e para, sepse ai që gjendet në të parën, tregohet më shumë mburravec. Sidoqoftë, që të dy bien në kategorinë e atyre për të cilën thuhet “*magdûbi ‘alejhim*” [ata që tërhoqën zemërimin].

Burimi i lumturisë së vërtetë është Zoti. Këta përderisa janë në padijeni ndaj Atij Zoti, të Gjallë e të Qëndrueshëm, madje e shpërfillin duke i treguar shpinën, si mund të gëzojnë lumturinë e vërtetë. I bekuar qoftë ai njeri, që e kupton këtë sekret dhe është i shkatërruar ai që nuk e kuptoi.

Po kështu, juve ju duhet që të mos ndiqni filozofët e kësaj bote dhe mos t’i shihni ata me nderime. Ata kanë vetëm pamendësi. Filozofia e vërtetë është ajo që Zoti jua mësoi në Fjalën e Tij. U Shkatërruan ata që janë të dashuruar me filozofinë e dynjasë, dhe gëzuan sukses ata që kërkuan dijen dhe filozofinë e vërtetë në Librin e Zotit. Pse ndiqni rrugët e pamendësisë?! A do t’i mësoni Zotit ato që Ai nuk i di?! A do të vraponi pas të verbërve, që t’jua tregojnë rrugën ata?! O të pamend! Ai që vetë është i verbër, si mund t’jua tregojë rrugën?! Filozofia e vërtetë gjendet përmes Shpirtit të Shenjtë, i cili ju është premtuar juve. Përmes Shpirtit ju do të arrini deri te këto dije të pastra, që të tjerët nuk do t’i arrijnë dot. Po e kërkuat me sinqeritet e vërtetësi, ju do ta gjeni atë përfundimisht. Atëherë do të kuptoni se është pikërisht kjo dije që ju qetëson zemrën, që ju jep jetë dhe që ju çon në lartësinë e bindjes. Kurse ai që vetë konsumon ngordhësirën, nga mund t’ju sjellë ushqim të pastër?! Ai që vetë është i verbër, si mund t’ju dhurojë shikimin?! Çdo urtësi e pastër

zbret prej qiellit, prandaj, çfarë po u kërkoni njerëzve tokësorë?! Urtësinë e trashëgojnë vetëm ata, të cilëve u ngjitet shpirti drejt qiellit. Kurse ata që nuk e kanë gjetur qetësinë për veten e tyre, si mund t’jua gjejnë juve? Megjithatë, së pari ju duhet të pastroni zemrën, të përvetësoni vërtetësinë dhe dëlirësinë, e më pas do t’ju jepet e gjithë kjo.

Mos mendoni se shpallja e Zotit nuk vjen më dhe se ka mbetur vetëm në të kaluarën²¹ dhe se Shpirti i Shenjtë nuk zbret dhe se ka zbritur vetëm në kohërat e mëparshme. Singerisht ju them të vërtetën, çdo derë mbyllet, por dera nga e cila zbret Shpirti i Shenjtë kurrë nuk mbyllet. Hapni dyert e zemrave tuaja, që ai të hyjë në to. Ju largoheni vetë nga Ai Diell, në momentin kur mbyllni dritaren nga e cila mund të hyjë rrezja e Tij. O i pamend! Çohu dhe hape këtë dritare! Atëherë, Dielli vetvetiu do të hyjë brenda teje. Derisa Zoti nuk jua mbylli rrugët e bekimeve tokësore në këtë kohë, përkundrazi jua shtoi edhe më shumë, a mendoni që Ai ju paska mbyllur rrugët e bekimeve qiellore, të cilat ju duheshin shumë në këtë kohë? Kurrësi jo. Madje, ju është hapur me shumë qartësi.

Dhe tani që Zoti juaj hapi derën e të gjitha bekimeve të mëparshme, mu sipas Fjalës së Tij që Ai ju ka mësuar në suren El-Fatiha, ju vetë pse nuk pranoni t’i merrni ato? Jini të etur për këtë burim, që t’ju arrijë uji

²¹ Sheriati u mbyll me ardhjen e Kuranit Famëllartë, por jo shpallja, sepse ajo është shpirti i fesë së vërtetë. Feja që nuk ka shpallje të vazhdueshme, është e vdekur dhe Zoti nuk është me të. (Autori)

vetvetiu. Qani si foshnjë, që të dalë qumështi vetvetiu prej gjirit për ju. Bëhuni të denjë për t'u mëshiruar që të mëshiroheni. Shfaqni dhimbjen, që të gjeni karar. Lëshoni klithmat vazhdimisht, që një Dorë t'ju kapë për dore. Sa e vështirë është kjo rrugë, që është rruga e Zotit! Por ajo u bëhet e lehtë atyre që hidhen për “të vdekur” në këtë gropë të thellë, sepse ata e kanë vendosur me zemër se pranojnë zjarrin e digjen për të Dashurin e tyre. Por, si përfundim, zjarri ku ata hidhen qenka një parajsë! Kjo është ajo që tha Zoti:

وَإِنْ مِنْكُمْ إِلَّا وَارِدُهَا ۚ كَانَ عَلَىٰ رَبِّكَ حَتْمًا مَّقْضِيًّا ۖ

Pra, o të ligj dhe o të mirë! Askush nga ju nuk do të shpëtojë nga zjarri i xhehenemit!²² Por ata që për hir të Zotit hidhen në këtë zjarr, do të shpëtojnë. Kurse ai që për shpirtin *am-marah*²³ të tij ndjek rrugën e zjarrit, zjarri do ta gllabërojë atë. Të bekuar janë ata, të cilët luftojnë shpirtin e keq të tyre për hir të Zotit, dhe fatligë janë ata që luftojnë Zotin për hir të shpirtit të tyre të keq dhe nuk afrohen me Të. Ai që anashkalon urdhrin e Zotit për hir të shpirtit të tij, kurrsesi nuk do të pranohet në qiell. Prandaj, përpiquni të mos dëshmojë kundër jush qoftë një fjalë a një pikë e Kuranit Famëlartë, që të mos ndëshkoheni pikërisht për atë pikë. Sepse, edhe një ligësi e vogël është e ndëshkueshme. Pak kohë keni dhe jetës nuk i dihet. Nxitohuni, sepse po afrohet nata.

²² “Dhe çdokush nga ju, do të bjerë në të. Zoti yt këtë e ka marrë përsipër si vendim të prerë.” (Merjem 19:72)

²³ Shpirti a *nefsi* që nxit fort për të keqen. (Përkthyesi)

Kontrollojeni mirë atë që keni për t'ia paraqitur, në mos ju mbetet ndonjë gjë e mangët; në mos keni marrë diçka të dëmshme, ose gjithçka e juaja në mos është e pistë dhe e kotë, apo e padenjë për t'u paraqitur në oborrin Mbretëror.

Kam dëgjuar se disa prej jush nuk i besojnë fare *hadithet*. Gabojnë rëndë ata që bëjnë një gjë të tillë. Ky nuk është mësimi im. Besimi im është që Zoti ju ka dhënë tri gjëra për udhëzimin tuaj:

Më së pari është Kurani,²⁴ i cili flet për njëshmërinë, madhështinë e rëndësinë e Zotit, dhe vendos për mosmarrëveshjet mes hebrenjve e të krishterëve. Njëra syresh është edhe mosmarrëveshja dhe gabimi i tyre se gjoja Isai biri i Merjemes u vra përmes kryqëzimit, u cilësua i mallkuar dhe se nuk u ngrit sikur Profetët e tjerë.

Në të njëjtën mënyrë, në Kuran është bërë e ndaluar të adhurosh diçka tjetër përveç Zotit, qoftë njeri, qoftë kafshë, qoftë dielli, qoftë hëna, apo ndonjë yll, qofshin mjetet apo qoftë vetvetja. Andaj, jini vigjilentë dhe

²⁴ Mjeti i dytë i udhëzimit është *suneti*. Ai është modeli i pastër që Profeti Muhammed^{savs} tregoi me veprat dhe praktikën e tij. Për shembull, ai duke u falur tregoi se kështu duhet të falim namazin, duke agjëruar tregoi se kështu duhet të agjërojmë, etj.. Ky quhet *sunet*, pra angazhimet e Profetit, që Fjalën e Zotit e tregonin me vepra. Mjeti i tretë i udhëzimit është *hadithi*, që janë thëniet e Profetit^{savs}, të cilat u grumbulluan pas tij. Shkalla e hadithit është më e vogël sesa Kurani dhe suneti, sepse shumë hadithe bazohen mbi hamendje. Por, suneti i bën hadithet autentike nëse i shoqëron ato. (Autori)

mos hidhni asnjë hap kundër mësimi të Zotit dhe udhëzimit të Kuranit. Sinqerisht ju them të vërtetën, ai që shpërfill qoftë edhe një urdhër të vogël prej shtatëqind urdhërimeve të Kuranit, me dorën e tij mbyll derën e shpëtimit të vet. Rugët e shpëtimit të vërtetë e të përsosur i ka çelur Kurani, kurse gjithë të tjerët ishin hijet e tij. Prandaj, studioni Kuranin duke u thelluar në të dhe duajeni kaq shumë atë, siç nuk keni dashur askënd tjetër, sepse Zoti m'u drejtua mua dhe më tha:

الْخَيْرُ كُلُّهُ فِي الْقُرْآنِ-

E gjithë mirësia është në Kuran. Kjo pikërisht është e vërteta. Keqardhje për ata që i japin përparësi diçkaje tjetër mbi Kuranin. Burimi i gjithë shpëtimit dhe i suksesit tuaj është në Kuran. Nuk ka asnjë nevojë fetare tuajën që nuk gjendet në Kuran. Vërtetuesi ose përgënjeshtuesi i besimit tuaj ditën e gjykimit do të jetë Kurani. Përveç Kuranit nuk ka asnjë libër nën kupën e qiellit, që pa u lidhur me Kuranin, të mund t'ju udhëzojë. Zoti ju ka bërë mirësi të madhe që ju dhuroi një Libër si Kurani. Sinqerisht ju them të vërtetën, Libri që ju është lexuar juve, nëse do t'u lexohej të krishterëve, ata nuk do të shkatërroheshin dhe ky bekim e udhëzim që ju është dhënë juve, po t'u jepej hebrenjve në vend të Tevratit, disa sekte të tyre nuk do të bëheshin mohues të ahiretit. Prandaj, çmojeni bekimin që ju është siguruar juve. Kurani është një bekim shumë i bukur, një pasuri shumë e vyer. Po të mos vinte Kurani, e gjithë bota do të ishte si një copëz e pistë mishi.

Kurani është Libri para të cilit të gjitha udhëzimet e tjera janë asgjë. Shpirti i Shenjtë që solli Ungjillin kishte formën e një pëllumbi, që është

një kafshë e dobët, të cilën mund ta zërë edhe macja. Për këtë arsye të krishterët dita-ditës ranë në dobësinë shpirtërore, aq saqë nuk u mbetet më spiritualiteti. Kjo sepse i gjithë besimi i tyre bazohej mbi pëllumbin. Por Shpirti i Shenjtë që solli Kuranin, u shfaq në formën e një njeriu madhështor, i cili kishte mbushur me qenien e tij tërë qiellin dhe tokën. E ku matet ai pëllumb me këtë manifestim madhështor, të përmendur edhe në Kuranin Famëlartë!

Kurani mund të pastrojë njeriun brenda një jave, nëse ai e ndjek edhe me fjalë, edhe me kuptim. Kurani mund t'ju bëjë porsi Profetët, nëse ju vetë nuk i largoheni atij. Cili Libër përveç Kuranit u ka mësuar lexuesve të vet që në fillim të tij, një lutje të tillë si kjo, njëherësh duke u dhënë një shpresë si kjo:

إِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ﴿١﴾ صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ

*Ihdinas-sirātal-mustekīm. Sirātal-ledhīne en'amte 'alejhim.*²⁵

Na trego rrugën e atyre bekimeve që ua dhe edhe të parëve. Dhe këta të parët ishin profetë, të dërguar, të vërtetë, dëshmorë dhe të dëlirë. Prandaj, merrni guximin dhe mos e refuzoni ftesën e Kuranit, se ai dëshiron t'ju japë bekimet që u janë dhënë të parëve. Po, a nuk ju dha Ai tokën e Bijve të Izraelit dhe Bejtul-Mekdesin e tyre që deri më sot janë në zotërimin tuaj?! Prandaj, o të ngathët në besim dhe o të vakët në guxim! A mendoni se Zoti juaj ju ka bërë trashëgimtarë të të gjitha

²⁵ “Na udhëzo në rrugën e drejtë; në rrugën e atyre që i bekove.” (El-Fatiha 1:6-7)

pronave fizike të Bijve të Izraelit, dhe nuk ju ka bërë dot trashëgimtarë nga ana shpirtërore?! Përkundrazi, Zoti dëshiron t'ju bekojë edhe më shumë se ata. Zoti ju ka bërë trashëgimtarë të pasurisë së tyre shpirtërore e fizike, por dikush tjetër nuk do të jetë trashëgimtari juaj, deri së të vijë kiameti. Zoti kurrësi nuk do t'ju privojë ju nga bekimi i shpalljes (*vahji*), i diktimit (*ilham*), i diskursit dhe i komunikimit me Të. Ai do t'ju plotësojë të gjitha bekimet që ua kishte dhënë edhe të parëve.

Por ai që shkel dhe trillon gënjeshtër mbi Zotin dhe thotë “më erdhi shpallja e Zotit”, ndërkohë që nuk i ka ardhur, ose thotë “unë gëzova bekimin e komunikimit dhe të diskursit me Zotin”, ndërkohë që nuk e ka gëzuar, atëherë unë po ju them duke sjellë dëshmitar Zotin dhe engjëjt e Tij, ai do të shkatërrohet, sepse mashtroi dhe trilloi gënjeshtër mbi Krijuesin e tij dhe bëri shkelje të rëndë pa frikë. Andaj, ju kini frikë nga kjo. Të mallkuar janë ata që sajojnë ëndrra të rreme dhe pretendojnë rrejshëm për komunikimin Hyjnor. Në zemër ata mendojnë se nuk ka Zot, por ndëshkimi i Zotit do t'i zërë fort. Ata nuk mund ta largojnë dot ditën e tyre të zezë.

Prandaj, ju përparoni në vërtetësi, në sinqeritet, në drejtësi, në *takva* dhe në dashurinë personale me Zotin dhe këtë besojeni si detyrën tuaj, gjersa të keni jetë. Më pas, Zoti do ta bekojë edhe me komunikimin dhe diskursin Hyjnor, cilindo që Ai do të dëshirojë prej jush. Ju vetë nuk duhet ta ëndërroni një gjë të tillë, në mënyrë që për shkak të dëshirës vetjake, të mos fillojë ndonjë lidhje djallëzore, lidhje e cila ka shkatërruar shumë njerëz. Prandaj, jini të angazhuar në shërbim dhe në adhurim. E

gjithë përpjekja juaj duhet të jetë e përqendruar vetëm në zbatimin e të gjithë urdhrave të Zotit. Kërkoni përparimin në bindje për të gjetur shpëtimin, e jo për të shfaqur përpara botës komunikimin me Zotin.

Kurani Famëlartë ka lënë shumë porosi të pastra për ju. Njëra prej tyre është që ju të ruheni tërësisht nga *shirku*. Ai që bën *shirk* nuk e ka fatin të mbërrijë te burimi i shpëtimit. Mos gënjeni, sepse edhe gënjeshtër është një pjesë e *shirkut*.

Kurani nuk ju thotë ashtu siç thotë Ungjilli: lejohet të shihni gratë e huaja pa pasur mendime epshtdellëse, përkundrazi, Kurani nuk ju lejon t'i shihni as me shikim të keq, e as me të mirë, pasi në çdo rast ju rrezikoheni të rrëshqisni. Sytë tuaj duhet të ulen kur dilni përpara ndonjë *gruaje të huaj*.²⁶ Ju nuk duhet ta shihni formën fizike të saj, përveçse përmes një shikimi gjysmë të mbyllur, siç sheh ai që i ka sytë në fazën e parë të kataraktit.

Kurani nuk ju thotë ashtu siç thotë Ungjilli: mos pini alkool në një sasi që ju deh, por thotë: kurrësi mos e pini, se ndryshe nuk do ta gjeni rrugën e Zotit, dhe Zoti nuk do të komunikojë me ju dhe as nuk do t'ju

²⁶ Këtu togfjalëshi "*grua e huaj*" është përkthim i fjalës "*la mahram*", që për mashkullin i referohet çdo gruaje me të cilën ai mund të martohet. Po kështu, "*la mahram*" për femrën nënkupton çdo mashkull me të cilin ajo mund të martohet. (Përkthyesi)

pastrojë nga ligësitë. Dhe Ai thotë se pirja e alkoolit është pjellë e djallit, prandaj ruhuni prej saj.

Kurani nuk ju thotë ashtu siç thotë Ungjilli: mos u zemëroni kot mbi vëllain tuaj, por ai thotë se jo vetëm ta kontrolloni zemërimin tuaj, por edhe të zbatoni porosinë:

وَتَوَاصَوْا بِالْمَرْحَمَةِ

“Këshilloni njëri-tjetrin për mëshirë!”²⁷

Pra, Kurani ju këshillon të porositni edhe vëllezërit e tjerë për mëshirë.

Kurani nuk ju thotë ashtu siç thotë Ungjilli: Përveç tradhtisë bashkëshortore, duro çdo ligësi tjetër nga gruaja jote dhe mos e divorco, por thotë:

الطَّيِّبَاتُ لِلطَّيِّبِينَ

“Të pastërtat janë për të pastrit”²⁸

Pra, qëllimi i Kuranit është që një i papastër nuk mund të qëndrojë me të pastrin. Prandaj, nëse gruaja jote nuk bën tradhti të mirëfilltë bashkëshortore, por epshohet duke parë burra të tjerë, i përqafton, ua tregon lakuriqësinë e vet, është mohuese e ngatërrestare dhe qëndron larg nga Zoti i Pastër që beson ti, nëse ajo nuk tërhiqet, ti mund ta divorcosh atë. Kjo sepse ajo vetë është ndarë nga ti me veprat e saj dhe

²⁷ El-Balad 90:18.

²⁸ En-Nur 24:27.

nuk është më pjesë e trupit tënd. Prandaj, nuk të ka hije që të vijosh me turp bashkëjetesën me të. Në këtë gjendje, ajo tanimë nuk është më një gjymtyrë jotja, por një pjesë e infektuar deri në thellësi, e cila vetëm duhet prerë, në mos të ta infektojë gjithë trupin, duke të marrë edhe jetën përfundimisht.

Kurani nuk ju thotë ashtu siç thotë Ungjilli: Kurrë mos u beto, por ju ndalon nga betime të kota, sepse në disa raste betimi është një mjet për të gjykuar. Zoti nuk dëshiron të humbë diçka që mund të bëhet provë, sepse kjo është larg urtësisë së Tij. Është e natyrshme që kur asnjë njeri nuk bëhet dëshmitar i ndonjë çështjeje gjyqësore, nevojitet betimi në Zot për gjykim. Dhe betimi është njësoj sikur e sjell Zotin dëshmitar.

Kurani nuk ju thotë ashtu siç thotë Ungjilli: mos lufto keqbërësin në asnjë rast, por ai thotë:

جَزَّوْا سَيِّئَةَ سَيِّئَةٍ مِّثْلُهَا ۚ فَمَنْ عَفَا وَأَصْلَحَ فَأَجْرُهُ عَلَى اللَّهِ

Dëmshpërblimi i së keqes është aq sa është e keqja, por ai që e fal fajtorin dhe falja sjell përmirësim te fajtori dhe jo përkeqësim, Zoti është i kënaqur me të dhe do ta shpërblejë atë.²⁹

Pra, sipas Kuranit, jo në çdo rast hakmarrja është e lavdishme, sikundër jo në çdo rast falja është e lavdishme, dhe gjykimi duhet bërë duke parë

²⁹ “Dëmshpërblimi i së keqes është aq sa është e keqja, por kush e fal (fajtorin) dhe e përmirëson, shpërblimi i tij është mbi Allahun.” (Esh-Shura, 42:41)

rrethanat. Duhet që hakmarrja dhe falja të bazohen mbi situatën dhe urtësinë dhe jo mbi arbitraritet.

Kurani nuk ju thotë siç ju thotë Ungjilli: Duaji armiqtë e tu, por thotë se nuk duhet të kesh asnjë armik personal, se dashamirësia jote të jetë e përgjithshme dhe se armiku yt është vetëm ai që është armik i Zotit tënd, armik i Profetit tënd dhe armik i Librit të Allahut. Edhe këta nuk duhet t'i privosh nga thirrja dhe lutja jote. Pra, duhet të kesh armiqësi ndaj veprave të tyre dhe jo ndaj atyre si individë dhe se duhet të përpiqesh që ata të përmirësohen. Në lidhje me këtë thotë:

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَايَ ذِي الْقُرْبَىٰ

Pra, çfarë do Zoti nga ju? Vetëm që ju të veproni me drejtësi me gjithë njerëzimin. Pas kësaj, bëni mirësi edhe ndaj atyre që nuk ju kanë bërë mirësi. Duke përparuar edhe më tej, jini të dhembshur ndaj mbarë njerëzimit, sikur të jeni të afërmit e tyre të ngushtë, siç një nënë kujdeset për fëmijët e vet.³⁰ Kjo sepse mirësia e thjeshtë e ka të fshehtë një nuancë të vetëreklamimit dhe ai që bën mirësi, nganjëherë edhe e përmend atë, por ai që bën mirësi me një dashuri amnore, kurrsesi nuk mund të vetëreklamohet. Kështu që, shkalla e fundit e mirësive është ajo që bëhet në mënyrë të vetvetishme dhe që i përngjan dashurisë së nënës.

³⁰ “Sigurisht, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe dashamirësinë si ajo që u tregohet të afërmeve.” (En-Nahl 16:91).

Ky ajet përkthehet jo vetëm në raportin e njeriut me njeriun tjetër, por edhe në raportin e tij me Zotin. Drejtësia me Zotin është t'i bindesh Atij duke kujtuar bekimet e Tij. Mirësia (*ihsan*) me Zotin është të besosh me kaq shumë bindje në Qenien e Tij, sikur po e sheh Atë. Dhe dashamirësia si ajo që u tregohet të afërmve në raport me Zotin është që ta adhurosh Atë as duke lakmuar xhenetin, e as nga frika e xhehenemit. Madje, nëse supozojmë se nuk ka as xhenet e as xhehenem, prapëseprapë nuk duhet të ndryshojë aspak te ti pasioni për ta dashur Atë dhe për t'iu bindur Atij.

Ungjilli thotë: Kërkoni bekime për ata që ju mallkojnë. Por Kurani thotë: Mos bëni asgjë nga vetja juaj. Kërkojini gjykim zemrës suaj se çfarë duhet të bëni me një njeri të tillë, sepse zemra është vatër e manifestimeve të Zotit. Nëse Zoti ju inspiron në zemër se ky mallkues meriton mëshirë dhe se në qiell nuk ka mallkim për të, edhe ju mos e mallkoni atë, në mënyrë që të mos i kundërviheni Zotit. Por nëse ndërgjegjja juaj nuk e quan të denjë për t'u mëshiruar dhe jeni inspiruar në zemër se ai ka marrë mallkim edhe në qiell, atëherë mos kërkoni bekime për të. Ashtu siç asnjë Profet nuk kërkoi bekime për djallin dhe as nuk e liroi atë nga mallkimi. Por, mos u nxitoni të mallkoni dikë, pasi shumë nga paragjykimet janë gënjeshtër dhe shumë nga mallkimet bien mbi vetë ata që mallkojnë. Hidhni hapin me kujdes dhe analizoni mirë situatën para se të bëni diçka. Kërkojini ndihmë Zotit sepse jeni të verbër, e mund të cilësoni të drejtin si mizor e të vërtetin gënjeshtar. Po

bëtë kështu, do të bëni të pakënaqur Zotin tuaj dhe juve do t'ju zhvlerësohen të gjitha veprat.

Po kështu, Ungjilli thotë: Mos bëni veprat tuaja duke ua treguar njerëzve, por Kurani i Shenjtë thotë mos bëni të gjitha veprat tuaja në mënyrë të fshehtë. Kur mendoni se një vepër e caktuar është mirë ta bëni fshehtas, që të mos ju dëmtohet shpirti, bëjeni fshehtas. Dhe kështu, kur mendoni se një vepër tjetër e caktuar është mirë të përhapet te njerëzit e tjerë, bëjeni duke ua treguar, në mënyrë që ju të gëzoni dy shpërblime dhe që edhe njerëzit e dobët që nuk gjenin vullnetin për ta bërë atë vepër, ta kryejnë atë duke u frymëzuar nga ju. Prandaj tha Zoti në Librin e Tij:

سِرًّا وَعَلَانِيَةً

*“që shpenzojnë pasurinë ... fshehtas dhe haptas.”*³¹

Urtësinë e porosisë për t'u mësuar njerëzve jo vetëm me fjalë por edhe me vepra, Ai e ka treguar Vetë, pasi jo çdo herë fjala ndikon. Shpeshherë shembulli ndikon më shumë.

Po kështu, Ungjilli thotë: Kur dëshiron të lutesh, mbyllu në dhomëzën tënde. Por Kurani ju mëson që jo çdo herë të luteni fshehtas, por të luteni haptas edhe para njerëzve, mes vëllezërve tuaj, në mënyrë që nëse ndonjë lutje e tillë t'ju pranohet, ajo të nxisë edhe besimin e të tjerëve që edhe ata të fillojnë të luten.

³¹ El-Bekare 2:275.

Ngjashëm me këtë, Ungjilli thotë të luteni kështu:

“Ati ynë që je në qiej, u shenjtëroftë emri yt. Ardhtë mbretëria jote. U bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Bukën tonë të përditshme jepna neve sot. Dhe falna borxhet tona, sikurse edhe ne ua falim borxhlinjve tanë. Dhe mos na shtjer në ngasje, por çlirona nga ligësia, sepse jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia përjetë!”

Por Kurani thotë se Toka nuk është e zbrazët nga shenjtëria e Tij dhe se shenjtëria e Tij është edhe në tokë, edhe në qiell, siç thotë:

وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ
يُسَبِّحُ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ

Çdo grimcë e tokës dhe e qiellit dhe gjithçka që gjendet në to, e lavdëron Zotin dhe përmend shenjtërinë e Tij.³² Atë e përkujtojnë malet, e përkujtojnë lumenjtë, e përkujtojnë pemët, e përkujtojnë dhe shumë nga njerëzit e sinqertë. Kurse ai që nuk e përkujton Atë me gojë e me zemër dhe që nuk përulet para Tij, caktimi i Tij e gjunjzon përmes një sërë prangash e ndëshkimesh.

Kurani, Libri i Zotit ka shkruar për engjëjt se ata që të gjithë i binden skajshmërisht Atij. Dhe të njëjtën gjë thotë edhe për të gjitha gjethet a

³² “... nuk ka gjë që nuk e përkujton me lavdinë e Tij.” (Beni Israil 17:45) “Çdo gjë që gjendet në qiej e dhe çdo gjë që gjendet në tokë, lavdëron Allahun.” (El-Xhum’ua 62:2).

grimcat e tokës, që çdo gjë e saj po i bindet Atij. Nuk bie asnjë gjethe, përveçse me lejen e Tij dhe as ndonjë ilaç mund të jetë shërues e as ndonjë ushqim mund të bëhet i dobishëm pa urdhrin e Tij. Pra, çdo gjë mban kokën të ulur me përulësi e robëri të skajshme te pragu i Tij, për t'iu bindur tërësisht Atij. Thërrmijat e dheut dhe të maleve, pikat e lumenjve dhe të oqeanëve, gjethet e pemëve dhe të shkurreve dhe çdo grimcë e njeriut dhe e kafshëve e njohin Zotin, i nënshtrohen Atij dhe e lavdërojnë dhe e madhërojnë Atë. Këtë e thotë Allahu i Madhërishëm:

يُسَبِّحُ لِلَّهِ مَا فِي السَّمُوتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ

Ashtu siç çdo gjë në qiell po e lavdëron dhe e madhëron Zotin, në të njëjtën mënyrë çdo gjë në tokë po bën të njëjtën gjë.³³ Kështu që, a nuk po bëhet lavdërimi dhe madhërimi i Zotit edhe në tokë?! Një njohës i përsosur nuk mund të thotë një fjalë të tillë. Madje, ndër gjërat e tokës, disa prej tyre u binden urdhrave të Librit të Zotit, e disa të tjera urdhrave të ligjeve që vijnë nga caktimi i Zotit dhe ka edhe të tilla që u binden të dyjave. Qoftë reja, qoftë era, qoftë zjarri, qoftë dheu, të gjithë janë të angazhuar në bindje ndaj Zotit dhe në madhërimin e Tij. Nëse dikush tregohet rebel ndaj urdhrave të Librit të Zotit, ai sërish është i nënshtroar ndaj ligjeve të caktimit të Zotit. Askush nuk mund të dalë jashtë këtyre dy sundimeve. Çdokush është i detyruar t'i nënshtrohet të paktën njërit prej dy sundimeve qiellore. Po, herë pakujdesia, herë

³³ “Çdo gjë që gjendet në qiej e dhe çdo gjë që gjendet në tokë, lavdëron Allahun.”
(El-Xhum’ua 62:2)

përkujtimi i Zotit e zotërojnë tokën për të përkeqësuar ose për të përmirësuar zemrat e njerëzve. Por pa urtësinë dhe organizimin e Zotit, nuk bëhen këto ndryshime. Zoti deshi që Toka të bëhet kështu, dhe ajo u bë. Pra, kohërat e udhëzimit dhe të devijimit, njësoj si nata dhe dita, ndryshojnë në përputhje me ligjin dhe me lejen e Zotit dhe jo vetvetiu.

Pra, pavarësisht nga fakti se çdo gjë urdhrat të Zotit i bindet dhe Atë e madhëron, Ungjilli thotë se Toka është e zbrazët nga madhërimi i Tij. Arsyen e tregon tërthorazi vetë kjo lutje ungjillore në pjesën tjetër të fjalisë, duke nënkuptuar se mbretëria e Perëndisë ende nuk ka arritur në tokë. Pra, jo për diçka tjetër, por për shkak se nuk ka mbërritur ende sundimi i Tij, dhe nuk erdhi dot në fuqi vullneti i Perëndisë, siç ai është në fuqi në qiell. Por Kurani jep mësimin e kundërt. Ai qartazi thotë se çdo vjedhës, vrasës, kurvar, mohues, i pabindur, rebel, apo keqbërës, nuk mund të bëjë asnjë ligësi në tokë, derisa nuk i lëshohet leje në qiell. Prandaj, si mund të thuhet se Mbretëria e Zotit nuk qenka në tokë?! Vallë, a qëndron ndonjë forcë tjetër kundërshtare që nuk i lejuaka urdhrat e Zotit të zbatohen?! I Shenjtë është Allahu! Kurrsesi nuk është e mundur! Përkundrazi.

Zoti Vetë ka krijuar tjetër ligj në qiell për engjëjt dhe tjetër ligj në tokë për njerëzit. Në mbretërinë e Tij qiellore, Zoti nuk u ka dhënë engjëjve lirinë e zgjedhjes, madje që në gjenezën e tyre ka lënë vetëm bindjen. Ata nuk mund të kundërshtojnë. Ata nuk kanë aftësi për të harruar apo për të gabuar. Por në gjenezën e njeriut Ai ka lënë lirinë e zgjedhjes, të pranimit dhe të mospranimit. Tani, ngaqë kjo liri i ka ardhur njeriut nga

Lart, nuk mund të thuash se një njeri i lig i rrëmben mbretërinë Zotit. Përkundrazi, në çdo vend është mbretëria e Zotit, vetëm se ka dy ligje të ndryshme: njëri ligj u përket caktimeve për engjëjt qiellorë, që ata të mos kenë aftësi për të bërë ligësi, dhe ligji tjetër u përket caktimeve për njerëzit në tokë që të kenë leje prej qiellit për të zgjedhur të keqen. Por kur t'i kërkojnë fuqi Zotit, duke i kërkuar falje, atyre mund t'u largohet kjo dobësi nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë dhe mund të shpëtojnë nga të mëkatuarit, njësoj siç shpëtojnë Profetët dhe të Dërguarit e Zotit. Dhe nëse ka njerëz që tanimë janë bërë mëkatarë, lutja e tyre për t'i kërkuar falje u bën dobi në mënyrë që ata të shpëtojnë nga pasojat e mëkatit të tyre, sepse me ardhjen e dritës nuk qëndron dot errësira. Kurse keqbërësit që nuk i kërkojnë falje Zotit, pra që nuk i kërkojnë forcë Atij, pësojnë ndëshkimin e ligësive të tyre. Shikoni, këto ditë edhe murtaja ka rënë në tokë në formë ndëshkimi dhe rebelët ndaj Zotit po vijnë të shkatërrohen nga ajo. E si mund të themi atëherë që Mbretëria e Zotit nuk qenka në tokë?!

Mos mendoni se njerëzit bëjnë krime, sepse mbretëria e Zotit ende nuk ka zbritur në tokë. Jo, sepse edhe krimet ata i bëjnë duke qenë brenda ligjeve të caktimit të Zotit. Pra, ndonëse dalin nga ligji i Librit të Zotit duke bërë krime, nuk mund të dalin dot nga ligjet e natyrës, që janë caktimet e Zotit. Prandaj, nuk mund të pohojmë se kriminelët dalin nga nënshtrimi ndaj Mbretërisë së Zotit.

Sot në Indinë Britanike bëhen vjedhje e vrasje. Po kështu, ekzistojnë njerëz kurvarë, të pandershëm dhe dhunues të tjerë të çdolloji. Por

prapëseprapë nuk mund të themi se këtu nuk ekziston Mbretëria Britanike. Pra, ka qeverisje, por vetë qeveria nuk i lejoj ligjet e rrepta që do të llahtarishnin njerëzit duke ua bërë jetën të vështirë. Përndryshe po të donte shteti, edhe mund t'i fuste lehtësisht të gjithë kriminelët në një burg kaq sflitës, sa që ata të harronin të bënin ligësi. Ose mund të sanksiononte ligje jashtëzakonisht të ashpra, që t'i jepte fund kriminalitetit. Pra, mund të kuptoni nga fakti se sa shumë alkool konsumohet në këtë vend, sa shumë femra të pamoralshme jetojnë këtu dhe sa shumë vrasje bëhen. Të gjitha këto ekzistojnë jo sepse këtu Mbretëria Britanike nuk sundon, por sepse butësia në ligjet e saj i ka shtuar ligësitë. Tani, është në dorën e Mbretërisë nëse do, të shtrëngojë ligjin duke sanksionuar ndëshkime të rrepta, dhe t'i ndalojë njerëzit nga ligësitë. Ja pra, nëse kështu funksionon mbretëria njerëzore, e cila është asgjë përpara Mbretërisë së Zotit, sa shumë fuqi dhe pushtet mund të ketë Mbretëria e Tij?! Nëse ligji i Zotit do të ashpërsohej sot, dhe çdokush që bën kurvëri të fillojë të ndëshkohet vetëtimthi, çdokush që vjedh, menjëherë pas vjedhjes, t'i ngjitet ndonjë sëmundje që t'ia kalbë e t'ia sakatojë dorën dhe çdo rebel dhe mohues i fesë së Zotit të vdesë nga murtaja, atëherë brenda javës e gjithë bota do të mbulohej nga drejtësia dhe sinqeriteti.

Pra, edhe në tokë sundon Mbretëria e Zotit, por butësia e ligjit të Tij i ka lënë të lirë njerëzit dhe, për këtë arsye, kriminelët nuk kapen përnjëherë. Sidoqoftë, ka edhe dënime. Bien tërmete e rrufe, shpërthejnë vullkane, që shkaktojnë mijëra viktima; fundosen anije,

aksidentohen trena, bëhen përmytje, rrëzohen shtëpi, plot njerëz kafshohen nga gjarpërinjtë dhe kafshët e tjera të egra, shpërthejnë epidemi, dhe në një formë apo në ndonjë tjetër, madje në mijëra forma, dyert e vdekjes tragjike mbeten të hapura, të cilat ligji i natyrës së krijuar nga Zoti i ka caktuar edhe për kriminelët. Atëherë, si mund të thuash se **nuk ekzistua Mbretëria e Perëndisë në tokë.**

E vërteta është që Mbretëria e Tij ekziston edhe këtu. Çdo keqbërës ka pranga në duar, dhe zinxhirë nëpër këmbë, por urtësia Hyjnore e ka zbutur kaq shumë ligjin e Vet, sa që këto pranga e zinxhirë nuk japin efektin e tyre menjëherë dhe nëse njeriu nuk heq dorë, e përcjellin deri në xhehenemin e përjetshëm, në një ndëshkim ku keqbërësi as nuk rron, as nuk vdes dot.

Shkurt, ka **dy ligje: njëri** për engjëjt, që janë krijuar vetëm për të treguar bindje. E kanë bindjen në gjenezën e tyre dhe nuk mund të mëkatojnë, por as nuk mund të përparojnë.

Dhe **ligji i dytë** është për njerëzit, që në natyrën e tyre është lejuar të bëjnë mëkat, por që mund të përparojnë edhe në mirësi.

Të dyja këto ligje të natyrës janë të pandryshueshme. Ashtu siç engjëlli nuk mund të bëhet njeri, në të njëjtën mënyrë edhe njeriu nuk mund të bëhet engjëll. Të dyja ligjet e tyre përkatëse janë të përhershme dhe të pandryshueshme. Prandaj, ligji i qiellit nuk mund të vijë në tokë dhe as ligji i tokës nuk mund të aplikohet te engjëjt. Po, nëse njeriu i largon gabimet përmes **pendesës**, ai mund të bëhet shumë më i mirë se engjëjt, sepse engjëjt nuk kanë aftësi për të përparuar. Mëkatet e njeriut mund

të lahen nëpërmjet pendesës. Urtësia e Zotit deshi që disa njerëz të bëjnë mëkate, që pas mëkateve, të njihen me dobësinë e tyre dhe më pas të pendohen që ato t'u falen. Ky është ligji që është përcaktuar për njerëzit dhe pikërisht këtë e kërkon natyra njerëzore. Gabimi dhe harresa janë pjesë e natyrës së njeriut dhe jo e engjëjve. Prandaj, si mundet që ligji që është për engjëjt të mund të aplikohet për njerëzit?! Është gabim t'i atribuosh dobësi Zotit të Madhërishëm. Këto janë vetëm rezultate të ligjeve që janë në fuqi në tokë. *Me'adhaAllah*, Zoti a është kaq i dobët, saqë Mbretëria, Pushteti dhe Madhështia e Tij të kufizohen deri në qiell?! Apo toka ka ndonjë Zot tjetër që e ka zaptuar atë me rivalitet?!

Nuk është mirë për të krishterët që të theksojnë se Mbretëria e Zotit është **vetëm në qiell**, dhe se ende nuk ka ardhur në tokë, sepse ata vetë besojnë se qielli nuk është aspak i rëndësishëm. E përderisa qielli nuk ka ndonjë rëndësi ku Mbretëria e Zotit nuk mungon, dhe ajo u munguaka në tokë, do të thotë se Mbretëria e Zotit nuk është asgjëkund.

Përveç kësaj, ne e shohim me sy Mbretërinë tokësore të Zotit. Në përputhje me ligjin e Tij ne plakemi, ndryshojmë nga një gjendje në tjetrën, hasim gjithfarë gëzimesh e hidhërimesh, mijëra njerëz vdesin me urdhrin e Zotit dhe mijëra të tjerë lindin, pranohen lutjet, shfaqen shenjat, me urdhrin e Tij toka prodhon mijëra lloje bimesh, frutash dhe lulësh, të gjitha këto vallë, a ndodhin pa Mbretërinë e Zotit?! Përkundrazi. Trupat qiellorë lëvizin vetëm në një formë dhe në një orbitë dhe nuk shohim ndonjë ndryshim të madh te ta, kurse toka është epiqendër e mijëra e mijëra ndryshimesh, transformimesh dhe

alternimesh. Miliona njerëz largohen nga kjo botë përditë dhe miliona të tjerë lindin. Kështu që, në çdo aspekt vërejmë kontrollin e një Krijuesi të Plotfuqishëm. A mund të themi prapë se ende nuk paska ardhur Mbretëria e Perëndisë në tokë?!

Ungjilli nuk ka dhënë ndonjë argument se përse Mbretëria e Perëndisë nuk ka ardhur ende në tokë, megjithatë, Jezusi lutet gjatë gjithë natës në një kopsht [që quhej Gjetsemani] për të shpëtuar nga vdekja, lutje e cila edhe iu pranua, siç është e shkruar në librin, *Hebrenjve 5:7*, por Zoti nuk ishte fuqiplotë ta shpëtonte atë. Kjo mund t'u shërbejë të krishterëve si argument se në atë kohë Mbretëria e Zotit nuk ekzistonte në tokë. Por unë kam parë sprova edhe më të rënda se kaq dhe **kam shpëtuar prej tyre, e si mund ta mohoj Mbretërinë e Zotit?!**

Gjyqi që ngriti Martin Klarku në Gjykatën e Kapitenit Daglas [Douglas] kundër meje duke më akuzuar se kam bërë komplot vrasjeje, me synimin që më pas të dënohesha me vdekje, a ishte më pak i lehtë se gjyqi që u ngrit nga hebrenjtë në Gjykatën e Pilatit kundër Jezusit, vetëm për shkak të bindjes fetare dhe jo për ndonjë akuzë për vrasje?! Por ngaqë Zoti është Mbreti i tokës, siç është edhe i qiellit, Ai Vetë më kishte paralajmëruar prej kohe për këtë gjyq dhe se do të ishte një provë. Më pas, Vetë më njoftoi duke thënë:

“Unë do të të liroj ty!”

Qindra njerëz janë bërë me dije për këtë parashikim. Përfundimisht, u lirova. Pra, kjo ishte Mbretëria e Zotit që më shpëtoi nga kjo padi, e cila

ishte ngritur me përpjekje të përbashkëta nga muslimanët, hindutë dhe të krishterët.

Po në këtë mënyrë, jo një por dhjetëra herë kam parë Mbretërinë e Zotit në tokë dhe unë u detyrova të bindesha në këtë ajet të Zotit:

لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ

“I Atij është Sundimi edhe në qiej, edhe në tokë.”³⁴

dhe u binda edhe në ajetin:

إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَنْ يَقُولَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ ﴿٣٥﴾

I gjithë qielli dhe toka i nënshtrohen Atij. Kur Ai dëshiron diçka, për të thotë “Bëhu!” atëherë ajo menjëherë bëhet.³⁵ Më pas, Ai thotë:

وَاللَّهُ غَالِبٌ عَلَى أَمْرِهِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣٦﴾

Zoti triumfon në vendimin e Tij, por shumica e njerëzve janë në padijeni për fuqinë dhe pushtetin e Tij.³⁶

Deri këtu ishte për lutjen e Ungjillit, e cila i bën njerëzit të dëshpërohen nga mëshira e Zotit, i lejon të krishterët të kequdhëzohen nga cilësitë si përkujdesja, mirëbërësia, shpërblim-ndëshkimi i Zotit, dhe e quan Zotin

³⁴ EL-Hadid 57:3.

³⁵ “kur Ai dëshiron diçka, për të thotë “Bëhu!”, atëherë ajo bëhet.” (Jasin 36:83)

³⁶ “Allahu triumfon në vendimin e Tij, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Jusuf 12:22)

si të paaftë për të ndihmuar në tokë, për sa kohë që nuk zbret Mbretëria e Tij edhe në tokë. Për dallim nga kjo, lutja që Zoti ua mësoi muslimanëve në Kuran, tregon faktin se në tokë Zoti nuk është i papunë, sikur ata që u ikën pushteti nga dora, përkundrazi, cilësitë e Tij të krijimit, të mëshirës së pakufishme dhe të mëshirës së veçantë dhe të shpërblim-ndëshkimit janë në fuqi edhe në tokë dhe se Ai është i Plotfuqishëm të ndihmojë adhuruesit e Tij dhe të ndëshkojë keqbërësit përmes zemërimit të Tij. Ajo lutje është:

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١﴾ الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ ﴿٢﴾ مَلِكُ يَوْمِ الدِّينِ ﴿٣﴾ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ
كَسْتَعِينُ ﴿٤﴾ اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ﴿٥﴾ صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ ﴿٦﴾ غَيْرِ
الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ ﴿٧﴾

Vetëm Zotit i takon gjithë lavdia.³⁷ Që do të thotë se nuk ka asnjë mangësi në Mbretërinë e Tij. Asnjë nga përsosuritë e Tij nuk pret një gjendje të ardhshme, pra, të jetë e mangët sot, për t'u plotësuar nesër. Asgjë nga Mbretëria e Tij nuk është e kotë dhe Ai ushqen të gjitha botët. Ai mëshiron pa kërkuar ndonjë vepër në këmbim, si dhe mëshiron edhe duke kërkuar vepra në këmbim. Ai jep shpërblime dhe ndëshkime në kohën e caktuar. Ne vetëm Atë e adhurojmë dhe vetëm prej Tij

³⁷ "Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve; të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit; Sunduesit të ditës së gjykimit. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Na udhëzo në rrugën e drejtë. Në rrugën e atyre që i bekove, që nuk tërhoqën zemërim dhe që nuk devijuan." (El-Fatiha 1:2-7)

kërkojmë ndihmë dhe lutemi: Na trego rrugët e të gjitha bekimeve dhe na mbaj larg nga rrugët e zemërimit dhe të devijimit.

Kjo lutje që quhet sure **El-Fatiha** është e kundërta e lutjes që është në Ungjill, në të cilin është mohuar prania e Mbretërisë së Zotit në tokë. Pra, sipas Ungjillit nuk veprojnë aspak cilësitë e Zotit, siç janë cilësia e krijimit, e mëshirës së pakufishme dhe e mëshirës së veçantë, si dhe fuqia për të dhënë shpërblime dhe ndëshkime, për sa kohë që ende nuk ka ardhur Mbretëria e Zotit në tokë.

Kurse surja El-Fatiha na tregon se Mbretëria e Zotit ekziston në tokë dhe për këtë arsye ajo i rendit të gjitha cilësitë e Mbretërisë. Dihet që një mbretëri duhet të jetë e aftë për t'u kujdesur për njerëzit e vet. Fjalët **Rabbul-‘alemīn** (Zoti i botëve) e provojnë këtë cilësi.

Cilësia e dytë e mbretit është që ai t'i mundësojë popullit të vet gjithçka që është jetike për mbijetesën e tyre, dhe këtë ta bëjë nga mëshira mbretërore dhe jo duke u kërkuar ndonjë punë a shpërblim. Këtë cilësi e provon fjala **Err-Rrahmān** (i Gjithëmëshirshëm).

Cilësia e tretë që duhet të ketë një mbret është që ai duhet të ndihmojë në mënyrën e duhur popullin e tij për të arritur punët që ata të vetëm nuk i bëjnë dot. Fjala **Err- Rrahīm** (Mëshirëbërës) e provon këtë cilësi.

Cilësia e katërt e një mbreti është që ai duhet të ketë fuqinë për të shpërblyer dhe për të ndëshkuar, në mënyrë që rendi shoqëror dhe politik të mos çekuilibrohet. Fjalët **Mālīki jeumiddīn** [Sundues i ditës së gjykimit] e provojnë edhe këtë cilësi.

Shkurt, surja e lartpërmendur paraqet të gjitha cilësitë e mbretit që provojnë se ekzistojnë Mbretëria e Zotit dhe kontrolli i Tij edhe në tokë. Pra, ekziston edhe cilësia e Tij e të qenit Zot, edhe cilësia e të qenit i Gjithëmëshirshëm, edhe cilësia e të qenit Mëshirëbërës, edhe cilësitë e Tij e të qenit Shpërblyes dhe Ndëshkues. Gjithçka që i nevojitet një mbreti për të sunduar, Zoti të gjitha i ka në tokë dhe asnjë grimë e tokës nuk është jashtë urdhreve të Tij. Çdo gjë Ai e ka në dorë. Çdo mëshirë Ai e ka në dorë. Por Ungjilli mëson lutjen se Mbretëria e Perëndisë ende nuk ka ardhur mes jush, andaj lutjuni Zotit që ajo të mbërrijë. Pra, deri më tani Zoti i tyre nuk është bërë Sunduesi dhe Mbreti i tokës. E çfarë shprese mund të kesh prej një Zoti të tillë? Dëgjoni dhe kuptoni! Është njohuri e madhe të dini se çdo grimcë e tokës është nën pushtetin absolut të Zotit, njësoj siç çdo grimcë e qiellit është nën pushtetin e Mbretërisë së Tij, dhe, ashtu siç ka një manifestim madhështor të Tij në qiell, edhe në tokë ka një manifestim madhështor të Tij. Madje, manifestimi në qiell është vetëm një çështje besimi, pasi njerëzit e thjeshtë as nuk kanë shkuar atje dhe as nuk e kanë parë atë, por manifestimi i Mbretërisë së Zotit në tokë është i tillë që çdo njeri po e sheh me sy.³⁸

³⁸ Ajeti وَحَمَلَهَا الْإِنْسَانُ ("... por, këtë e mori përsipër njeriu." El-Ahzab 33:3) gjithashtu dëshmon se i nënshtroari i vërtetë i Zotit është pikërisht njeriu, i cili e çon bindjen e tij deri në shkallën e dashurisë, merr përsipër mijëra vështirësi për ta provuar Mbretërinë e Zotit në tokë. Pra, këtë bindje të shoqëruar me dhimbjen e zemrës që ka njeriu, si mund ta realizojnë dot engjëjt?! (**Autori**)

Çdo njeri, sado i pasur qoftë, pi kupën e vdekjes duke iu kundërvënë dëshirës së vet. Shikoni se me çfarë madhështie shfaqet manifestimi i urdhrit të këtij Mbreti të Vërtetë, që kur Ai lëshon urdhër, askush nuk mund ta ndalë vdekjen e vet as edhe për një sekondë. Asnjë mjek a doktor nuk mund të largojë dot ndonjë sëmundje të keqe e të pashërueshme, kur ajo përhapet me të gjitha përmasat e veta. Prandaj, meditoni pak se me çfarë madhështie shfaqet Mbretëria e Zotit në tokë, aq saqë urdhrat e Tij s'mund të refuzohen. E si mund të themi atëherë që Mbretëria e Zotit nuk ekziston në tokë dhe se ajo do të vijë në ndonjë kohë tjetër në të ardhmen?! Shikoni, me urdhrin Hyjnor në këtë kohë murtaja po e trondit tokën, në mënyrë që të bëhet shenjë për Mesihun e Tij të Premtuar. Atëherë kush është ai që mund ta largojë atë kundër Vullnetit të Tij?! Prandaj, si mund të themi se Mbretëria e Zotit ende nuk ka ardhur në tokë? Po, një i lig jeton si i burgosur në tokën e Zotit dhe dëshiron të mos vdesë kurrë. Por Mbretëria e vërtetë e Zotit e shkatërron atë dhe ai përfundimisht bie në kthetrat e engjëllit të vdekjes. E si mund të themi atëherë se ende nuk ka ardhur Mbretëria e Zotit në tokë?! Shikoni, se çdo ditë miliona njerëz vdesin në tokë në një çast me urdhrin e Zotit dhe miliona të tjerë lindin po me vullnetin e Tij. Dhe po me lejen e Tij, miliona të varfër bëhen të pasur dhe të pasurit bëhen të varfër. Si mund të themi atëherë se ende nuk ka mbërritur Mbretëria e Zotit në tokë?!

Në qiell jetojnë vetëm engjëjt, por në tokë jetojnë edhe njerëzit, edhe engjëjt që janë në shërbim të Zotit dhe të Mbretërisë së Tij dhe të cilët

janë si rojë për punët e ndryshme të njerëzve. Këta engjëj çdo çast tregojnë bindjen e tyre ndaj Zotit dhe Atij i dërgojnë raportet e tyre. Prandaj, si mund të themi se ende nuk ka mbërritur Mbretëria e Zotit në tokë?! Përkundrazi. Zoti më së shumti u njoh nga Mbretërimi i Tij të tokës, pasi çdo njeri mendon se sekretet e qiellit janë të fshehta dhe të padukshme. Madje, thuajse të gjithë të krishterët e sotëm dhe filozofët e tyre nuk besojnë fare në qeniet qiellore, mbi të cilat mbështeten Ungjijtë për ta provuar Mbretërinë e Zotit atje. Kurse toka realisht është një rruzull nën këmbët tona, ku shfaqen qindra mijëra çështje të caktimit të Zotit, dhe të gjitha ato tregojnë se i gjithë ky ndryshim dhe zhvillim, jeta dhe vdekja realizohen me urdhrin e një Mbreti të Veçantë. Si mund të themi atëherë se akoma nuk ka mbërritur Mbretëria e Zotit në tokë?! Ky mësim duket shumë i padenjë sidomos në këtë kohë, kur shumica e të krishterëve e mohojnë fortë ekzistencën qiellore. Sepse nga njëra anë kjo lutje e Ungjillit pranon se Mbretëria e Zotit akoma nuk ka ardhur në tokë dhe, nga ana tjetër, shkencëtarët e krishterë, me hulumtimet e tyre të reja, kanë pranuar me bindje se qielli është asgjë dhe aty nuk ka asnjë qenie Hyjnore. Përfundimisht, ata nuk gjetën Mbretërinë e Zotit as në tokë, e as në qiell. Mbretërisë qiellore i dhanë lamtumirë të krishterët, kurse Mbretërinë tokësore e mohoi Ungjilli i tyre. Pra, sipas tyre tanimë Zoti nuk ka në dorë asnjë Mbretëri, as në tokë, e as në qiell. Por Zoti ynë i Plotfuqishëm dhe i Madhërishëm, në suren El-Fatiha, nuk përmendi as tokën, e as qiellin, dhe na njoftoi për realitetin se Ai

është Zoti i botëve. Që do të thotë se kudo që ka qenie,³⁹ dhe kudo që ka krijesa të çdo lloji, qofshin trupa, qofshin shpirtra, Krijuesi dhe Mbajtësi i tyre është Zoti. Çdo çast Ai kujdeset për to dhe u siguron jetesën në bazë të nevojave të tyre. Në të gjitha botët po vijon pandërprerë efekti i attributeve të Tij, *Rrab* (Krijues dhe Rritës), *Rrahman* (i Gjithëmëshirshëm), *Rrahim* (Mëshirëbërës) dhe Shpërblyes e Ndëshkues.

Nuk duhet të harroni se fjalët “Māliki jeumiddīn” (Sunduesi i ditës së gjykimit) që thuhet në suren El-Fatiha, nuk i referohen vetëm Ditës së Gjykimit kur do të jepen shpërblime e ndëshkime, por Kurani Famëlartë vazhdimisht thotë shumë qartë se pavarësisht se Kiameti do të shkaktojë Gjykimin e Madh, edhe në këtë botë bëhen gjykime në forma të ndryshme. Këtë na e tregon ajeti:

يَجْعَلْ لَّكُمْ فُرْقَانًا

*“Ai do t’ju mundësojë një dallim.”*⁴⁰

Dëgjoni edhe këtë. Në lutjen e ungjillit kërkohet buka e përditshme, siç thuhet:

Bukën tonë të përditshme jepna neve sot.

³⁹ Shikoni sa i përsosur është togfjalëshi “**Rabbul-‘ālemīn**” (*Krijuesi dhe Mbajtësi i botëve*)! Nëse provohet në të ardhmen se edhe në trupa të tjerë qiellorë ka jetë dhe banime, edhe ato përfshihen në këto fjalë. (Autori)

⁴⁰ El-Enfal 8:30.

Por, është e çuditshme që Ai që nuk ka akoma Mbretërinë në tokë, si mund t'ua mundësojë bukën njerëzve, pasi drithërat dhe frutat u pjekkan vetë e jo me urdhrin Tij dhe, edhe shirat rënkuan vetë dhe jo me urdhrin e Tij. Atëherë, çfarë kontrolli ka Ai që t'i mundësojë bukën njeriut?! Po, kur të vijë Mbretëria e Tij në tokë, atëherë mund t'ia kërkonin edhe bukën. Tani për tani, Ai qenka i përjashtuar nga pronësia e gjërave tokësore. Kur do të fitojë pushtimin e plotë, atëherë mund t'i japë bukën dikujt. Pra, do të ishte e padenjë t'i kërkonit Zotit një gjë të tillë në këtë situatë!

Edhe fjalat tjetër që vijon:

falna borxhet tona, sikurse edhe ne ua falim borxhlinjtë tanë,

gjithashtu nuk është e denjë, sepse për sa kohë që Ai nuk e ka marrë ende Mbretërinë e tokës, të krishterët nuk paskan ngrënë asgjë nga dora e Tij, atëherë çfarë i kanë borxh Atij?! Nuk ka nevojë fare t'i kërkojnë faljen e borxheve një Zoti të tillë duarbosh dhe as të kenë frikë nga Ai, për sa kohë që ende nuk ka ardhur Mbretëria e Tij në tokë dhe Ai ende nuk ka kërbaç në dorë për të ndikuar fajtorët në Mbretërinë e Tij. Vallë, ku paska fuqi Ai të ndëshkojë ndonjë kriminel, apo të shkatërrojë të pabindurit me ndonjë tërmet, a me vetëtimë apo me ndonjë ndëshkim tjetër, siç shkatërroi një popull të pabindur në kohën e Musait, ose siç vërshoi me gurë popullin e Lutit?! Kjo, sepse ende nuk ka ardhur **Mbretëria e Zotit në tokë**. Zoti i të krishterëve është po kaq i dobët, sa ishte biri i Tij dhe, është po kaq i përjashtuar, sa ishte biri i Tij. Prandaj, është e kotë t'i bëjnë lutje të tilla Atij duke thënë: “**falna borxhet**”, etj..

Kur u kishte dhënë Ai borxh, që t'ua falë, pa ardhur ende **Mbretëria e Tij në tokë**. Në këtë rast, i gjithë lulëzimi i tokës nuk qenka me urdhrin e Tij dhe të gjitha gjërat e tokës nuk qenkan të Atij, por janë vetvetiu. Për sa kohë që urdhri i Tij nuk është në fuqi në tokë, dhe Ai nuk është Mbret në tokë dhe e gjithë kjo rehatia e tokës nuk është me urdhrin e Tij Mbretëror, Ai nuk ka as kontrollin e as të drejtën e ndëshkimit. Prandaj, është **budallallëk** të besosh në një Zot të tillë dhe të kesh shpresë prej një të tilli, i cili nuk e ka ende Mbretërinë në tokë.

Por lutja e sures El-Fatiha na mëson se në tokë çdo çast Zoti ka të njëjtin **pushtet**, siç e ka në botë të tjera dhe se në krye të kësaj sureje janë përmendur ato cilësi të plotfuqishmërisë, të cilat asnjë libër tjetër në botë nuk i renditi në mënyrë kaq të qartë. Siç thotë: Ai është **Rrahman** (I Gjithëmëshirshëm), është **Rrahim** (Mëshirëbërës), është **Māliki jeumiddīn** (Sunduesi i kohës së gjykimit). Pastaj vijon mësimi që t'i lutesh Zotit që i ka këto cilësi. Më pas lutja që është mësuar nuk është si ajo e Mesihut ku kërkohet vetëm buka e përditshme, por përbëhet nga kërkesa dhe etja e asaj që është gdhendur që nga zanafilla në natyrën e njeriut, që është:

إِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ۝ صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ

*Ihdinas-sirātal-mustekīm. Sirātal-ledhīne en'amte 'alejhim*⁴¹

⁴¹ "Na udhëzo në rrugën e drejtë; në rrugën e atyre që i bekove" (El-Fatiha 1:6-7).

O Zot i cilësive të përsosura dhe o Bujar kaq i madh aq sa çdo grimcë po rritet në saje të fuqisë Sate dhe përfiton nga Gjithmëshirshmëria, Mëshirëbërësia dhe Sundimi Yt për ndëshkim-shpërblim, na bëj të trashëgojmë njerëzit e drejtë të mëparshëm dhe çdo bekim që u ke dhënë atyre, jepna edhe neve. Gjithashtu, na shpëto të mos tërheqim zemërimin duke dalë mohues dhe na shpëto të mos devijojmë duke humbur ndihmën Tënde! **Amin!**

Pas gjithë këtij studimi është i qartë dallimi mes lutjes së Ungjillit dhe lutjes së Kuranit. Ungjilli premton ardhjen e Mbretërisë së Zotit, kurse Kurani tregon se Mbretëria e Zotit gjendet mes jush dhe jo vetëm që gjendet këtu, por ju po bekoheni në mënyrë të vazhdueshme përmes saj. Pra, Ungjilli ka vetëm një premtim, ndërsa Kurani tregon Mbretërinë e vendosur dhe bekimet e saj, e jo thjesht premtimin.

Këtu duket qartë edhe epërsia e Kuranit, i cili paraqet Zotin që është Shpëtimtari dhe Lumturuesi i njerëzve të drejtë që në jetën e kësaj bote dhe asnjë shpirt nuk është i privuar nga bekimi i Tij. Madje, çdo shpirt sipas caktut të tij bekohet nga cilësitë e Zotit të botëve, të Gjithmëshirshmit dhe Mëshirëbërësit, kurse Ungjilli paraqet Zotin që ende nuk e ka sjellë Mbretërinë e Tij në tokë. Tani, mendojeni vetë se cilin prej tyre logjika e pranon të denjë për të ndjekur. Hafiz Shiraziu ka thënë të vërtetën:

مرید پیر مغانم ز من مرغ اے شیخ
چرا کہ وعده تو کردی و ابھی آورو

*Mos u hidhëro prej meje o “dijetar”, se jam nxënës i të mençurit
Ti bën vetëm premtime, kurse ai edhe i plotëson.*

Po kështu, Ungjijtë i përshkruajnë me lëvdata të duruarit, të varfrit dhe të butët, gjithashtu, i lavdërojnë edhe ata që edhe pse persekutohen, tregohen pasivë. Por Kurani nuk thotë që ju gjithmonë të mbeteni të butë dhe të mos reagoni ndaj së keqes, por thotë se durimi, butësia, përulësia dhe heqja dorë nga përballja është e mirë, por jo kur është kundër logjikës dhe kohës. Shiu është vërtet i dobishëm dhe jetik, por kur është jashtë kohës, po ky shi sjell shkatërrim. Përvoja juaj tregon se kur konsumoni vazhdimisht vetëm një ushqim të lehtë ose vetëm një ushqim të rëndë, ai ju dëmton shëndetin. Pra, do të keni shëndet vetëm nëse kombinoni ushqime që ju përshtaten në bazë të kohës dhe të vendit. Prandaj, edhe butësia dhe ashpërsia, falja dhe hakmarrja, lutja dhe mallkimi, dhe virtyte të tjera me radhë, kërkojnë pikërisht këtë lloj ndërrimi që përshtatet me kohën dhe vendin e duhur.

Jini të durueshëm e të butë në shkallën më të lartë, por jo pa vend dhe jo në moment të papërshtatshëm. Bashkë me këtë mbani mend edhe faktin që moralet e vërteta që nuk kanë përzierje helmuese të qëllimeve vetjake, ju vijnë nga lart përmes Shpirtit të Shenjtë. Prandaj, ju vetëm me përpjekjet tuaja nuk mund t'i arrini dot moralet e larta, derisa Ai nuk do t'jua dhurojë ato nga lart. Dhe çdokush që nuk gëzon me bekimin qiellor ndonjë pjesë të moraleve përmes Shpirtit të Shenjtë, është gënjeshtar në pretendimin kur thotë se është i pajisur me morale. Poshtë ujit, ai ka shumë baltë dhe shumë bajgë, e cila shfaqet në kohën kur ai

nxitet për të treguar veten e tij. Prandaj, ju në çdo kohë Zotit kërkojini fuqinë, në mënyrë që të shpëtoni nga ajo baltë dhe nga ajo bajgë, dhe që Shpirti i Shenjtë të krijojë te ju pastërtinë dhe bukurinë e vërtetë. Mbani mend! Moralet e vërteta dhe të pastra janë një mrekulli e atyre që ndjekin rrugën e drejtë dhe dikush tjetër nuk mund t'i gëzojë ato, sepse ata që nuk përumben në Zot, nuk e gëzojnë fuqinë nga lart, andaj, nuk kanë mundësi t'i arrijnë moralet e pastra. Për këtë arsye, krijoni lidhje të pastër me Zotin tuaj. Talljen, përqeshjen, inatin, gjuhën e ndyrë, lakminë, gënjeshtrenë, imoralitetin, shikimin epshor, mendimet mëkatore, adhurimin e botës, mendjemadhësinë, arrogancën, vetëpëlqimin, keqbjërjen, grindjen, lërinë të gjitha. Atëherë do t'ju dhurohet gjithçka prej qiellit. Për sa kohë që nuk shoqërohet me ju ajo fuqi Hyjnore që ju çon lart dhe derisa nuk hyn te ju Shpirti i Shenjtë që dhuron jetë, do të jeni shumë të dobët dhe do të gjendeni në errësirë, madje jeni si një i vdekur që nuk ka jetë. Në këtë gjendje, ju as nuk mund të luftoni ndonjë vështirësi, dhe as nuk mund të shpëtoni nga mendjemadhësia dhe arroganca në kohë pozite e pasurie; jeni të pushtuar në çdo aspekt nga djalli dhe vetvetja. Pra, ilaçi juaj është vetëm një, që Shpirti i Shenjtë që zbret posaçërisht nga dora e Zotit, t'jua drejtojnë fytyrën drejt mirësisë dhe drejtësisë. Bëhuni bijtë e qiellit dhe jo bijtë e tokës. Jini trashëgimtarë të dritës dhe jo të dashuruar të errësirës, në mënyrë që të shpëtoni nga shtigjet e djallit, ngaqë djalli gjithmonë kërkon natë dhe kurrsesi ditë; sepse ai është vjedhës i vjetër që hedh hapin në errësirë.

Surja Fatiha nuk është thjesht një mësim, por ka edhe një profeci madhështore: Zoti përmendi të katërta cilësitë e Tij, pra, të qenët Zoti i botëve, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëbërësi dhe Sunduesi për të dhënë shpërblim e ndëshkim dhe paraqiti fuqinë e Tij të përgjithshme dhe, në ajetet vijuese na mësoi lutjen:

O Zot! Bëna t'i trashëgojmë Profetët dhe të Dërguarit të kaluar! Rruga e tyre të na hapet edhe neve! Bekimet e tyre të na jepen edhe neve! Na shpëto, o Zot, të mos bëhemi si ata, të cilët i zuri zemërimi Yt që në këtë botë, pra hebrejntë e kohës së Hazret Isa Mesihut, të cilët u shkatërruan nga murtaja! Gjithashtu, na shpëto, o Zot, të mos bëhemi nga ata që u privuan nga udhëzimi Yt, të cilët përfundimisht devijuan, pra të krishterët!

Kjo lutje e ka të nënkuptuar profecinë se disa muslimanë do të jenë të tillë, të cilët për shkak të vërtetësisë dhe pastërtisë së tyre, do t'i trashëgojnë Profetët e mëparshëm dhe do të gëzojnë bekimin e të qenit profetë dhe të dërguar; kurse disa të tjerë do të marrin cilësitë e hebrejve, duke tërhequr ndëshkimin që në këtë botë; dhe disa të tjerë do të veshin petkun e krishterimit. Sepse, është praktikë e vazhdueshme në Fjalën e Zotit, ku nëse një popull ndalohet nga një punë e caktuar, prej atij populli patjetër dalin disa të tillë, të cilët në dijen e Zotit do ta konsumojnë atë vepër, dhe dalin edhe disa të tillë, të cilët do të përvetësojnë mirësinë dhe fatbardhësinë. Kjo është praktikë e hershme e Zotit që gjendet në të gjithë Librat që Ai ka zbritur që nga fillimi i kësaj bote e deri në fund. Pra, kur Zoti ndalon një popull nga një punë

e caktuar, ose i nxit ata për të bërë një punë të caktuar, Ai e ka caktuar në dijen e Tij që disa prej tyre do ta bëjnë atë, e disa të tjerë nuk do ta bëjnë. Prandaj, kjo sure bën profeci se dikush nga ky umet do të shfaqet në mënyrë të përsosur në formën e Profetëve, që të përmbushet plotësisht profecia, e cila nënkuptohet nga fjalët: *“na udhëzo në rrugën e atyre që i bekove Ti”*. Gjithashtu, një grup prej tyre do të shfaqen në formën e atyre hebrenjve, të cilët i mallkoi Hazret Isai dhe që u ndëshkuan nga Zoti, që të përmbushet plotësisht profecia, e cila nënkuptohet nga fjalët: *“Mos na bëj të ndjekim rrugën e atyre që tërboqën zemërimin Tënd”*. Po kështu, një grup tjetër prej tyre do të marrë ngjyrën e të krishterëve ose do të bëhen të krishterë, të cilët për shkak të konsumimit të alkoolit, të shthurjes, të ligësisë dhe të imoralitetit të tyre, u privuan nga udhëzimi i Zotit, që të shfaqet plotësisht edhe profecia, e cila nënkuptohet nga fjalët *“as në rrugën e atyre që devijuan”*.

Është në besimin e muslimanëve që në kohën e fundit mijëra të ashtuquajtur muslimanë, do të marrin cilësitë e hebrenjve. Shumë ajete të Kuranit Famëlartë e përmendin këtë profeci. Po kështu, po ndiejmë dhe po dëshmojmë sesi qindra e qindra muslimanë po bëhen të krishterë ose po ndjekin jetën si të krishterët, pa fre dhe lirshëm. Madje, ka shumë njerëz që quhen muslimanë, por pëlqejnë mënyrën e jetesës së të krishterëve dhe, duke u quajtur muslimanë, i shohin me urrejtje të madhe porositë e *hallallit* dhe të *haramit*. Të dyja këto grupe, pra edhe ata që kanë cilësitë e hebrenjve, edhe ata që kanë cilësitë e të krishterëve, ne i shohim të përhapur edhe në këtë vend. Prandaj, ju vetë keni

dëshmuar se këto dy profeci tashmë janë përmbushur, dhe me sytë tuaj keni parë se sa shumë muslimanë sot cilësohen si hebrenj dhe se sa shumë si të krishterë. Atëherë është e denjë të pranohet edhe profecia e tretë. Pra, muslimanët duke u bërë hebrenj e të krishterë, siç morën pjesë nga ligësia e hebrenjve dhe e të krishterëve, në të njëjtën mënyrë ata kishin të drejtën e plotë që disa prej tyre të merrnin pjesë nga pozita dhe shkalla e lartë e njerëzve të shenjtë të tyre, të cilët ishin nga Bijtë e Izraelit. Është paragjykim ndaj Zotit të Madhërishëm kur besoni se Ai i quajti muslimanët pjesëtarë në ligësinë e hebrenjve e të krishterëve, duke i quajtur *jahud* (çifut), por pa u dhënë asnjë pjesë nga pozita e të Dërguarve dhe e Profetëve të tyre. E pse atëherë është quajtur ky umet si “*populli më i mirë*”?! Përkundrazi, duhet të quhej “populli më i lig”, pasi mori çdo shembull të keq, por nuk mori dot asnjë shembull të mirë! Vallë, a nuk duhej që edhe në këtë umet dikush të shfaqej në formën e Profetëve dhe të Dërguarve, i cili t’i trashëgonte të gjithë Profetët e Bijve të Izraelit dhe të ishte si hija e tyre?! Sepse është kundër mëshirës së Zotit të Madhërishëm që në këtë umet dhe në këtë kohë Ai të krijojë mijëra njerëz me cilësi të hebrenjve dhe mijëra të tjerë t’i çojë në fenë e krishterë, por të mos shfaqë as edhe një njeri të vetëm, i cili t’i trashëgonte Profetët e mëparshëm e t’i gëzonte bekimet e tyre, duke plotësuar profecinë që gjendet në ajetin: “*Na udhëzo në rrugën e drejtë; në*

rrugën e atyre që i bekove”,⁴² mu ashtu siç u plotësua profecia në lidhje me ngjashmërinë e muslimanëve me hebrenjtë dhe me të krishterët.

Këtij umeti i janë dhënë mijëra emra të tmerrshëm dhe është e qartë nga Kurani i Shenjtë dhe nga hadithet se ata gjithashtu do të ndiqnin rrugën e hebrenjve dhe do të merrnin edhe të këqijat e të krishterëve të mëparshëm. Në këtë situatë, ishte domosdoshmëri që bekimi i Zotit t’i bënte ata të trashëgonin edhe mirësitë. Prandaj Zoti i Madhërishtëm dha lajmin e mirë në suren El-Fatiha, në ajetin, *Na udhëzo në rrugën e drejtë (Ihđinas-sirātal-mustekīm)*, që disa njerëz të këtij umeti do të marrin edhe bekimin e Profetëve të kaluar, se përndryshe umeti do t’u përngjante hebrenjve e të krishterëve duke marrë vetëm të keqen dhe jo të mirën.

Po kështu, edhe në suren Et-Tahrim thuhet se disa njerëz të këtij umeti do t’i përngjajnë Merjemes së sinqertë, e cila përvetësoi dëlirësinë. Atëherë u vu fryma e Isait në barkun e saj dhe kështu lindi Isai.⁴³ Ky ajet tregon se në këtë umet do të ishte dikush, i cili, së pari do merrte pozitën e Merjemes, e më pas në të do të fryhej shpirti i Isait dhe atëherë po nga ky njeri, që ishte si Merjemja, do të dilte edhe Isai. Pra, nga cilësitë e Merjemes, ai do të kalonte në cilësitë e Isait. Me një fjalë, cilësia e të qenit Merjeme e lindi fëmijën Isa dhe kështu ai do të quhej *Biri i*

⁴² El-Fatiha 1:6-7.

⁴³ Et-Tahrim 66:13.

Merjemes. Siç në librin *Berahin-e-Ahmedia*, unë jam quajtur së pari Merjem, fakt të cilin e tregon shpallja e shkruar në faqen 241 të tij:

أَنْتِ لَكَ هَذَا.

O Merjeme! Nga të ka ardhur ky bekim?

Të njëjtën gjë e tregon edhe shpallja e shkruar në faqen 226:

هُرَّ إِلَيْكَ بِجِدِّ النَّخْلَةِ.

O Merjeme! Shkunde trungun e hurmës!

E më pas, edhe shpallja në faqen 496 të librit *Berahin-e-Ahmedia*:

يَا مَرْيَمُ اسْكُنِي أَنْتَ وَزَوْجُكَ الْجَنَّةَ فَتَخْتِي فِيكَ مِنْ لَدُنِّي رُوحَ الصِّدْقِ.

O Merjeme! Ti bashkë me shokët e tu hyr në parajsë. Unë kam fryrë prej Vetes në ty shpirtin e së vërtetës.

Zoti në këtë ajet⁴⁴ më ka thirrur me emrin *shpirti i së vërtetës*. Kjo i referohet ajetit të Kuranit ku thuhet:

فَنَفَخْنَا فِيهِ مِنْ رُوحِنَا

(“*Ne frymë në të Shpirtin prej Vetes*”)⁴⁵

Pra, si metaforë është thënë se në barkun e Merjemes u vu shpirti i Isait, i cili quhet Shpirti i së vërtetës. Në fund, në faqen 556 të *Berahin-e-*

⁴⁴ Këtu fjala “ajet” i referohet shpalljes, të cilën Hazret Mesihu i Premtuar^{as} e ka përmendur pak rreshta më parë. [Botuesi]

⁴⁵ Et-Tahrim 66:13.

Ahmedia, vjen edhe shpallja që tregon lindjen e Isait që gjendej në barkun e Merjemes:

يَا عِيسَى إِنِّي مُتَوَفِّيكَ وَ رَافِعُكَ إِلَى وَ جَاعِلُ الَّذِينَ اتَّبَعُوكَ فَوْقَ الَّذِينَ كَفَرُوا إِلَى يَوْمِ
الْقِيَامَةِ.

(O Isa, Unë sigurisht që do të të marr shpirtin, do të të ngre drejt Vetes, dhe ndjekësit e tu do t'i bëj eprorë, deri në ditën e kiametit, mbi ata që mohuan.)

Në këtë shpallje unë jam quajtur Isa dhe kjo shpallje tregoi se ai Isa ka lindur, ardhja e shpirtit të të cilit ishte përmendur në faqen 496. Në këtë formë unë jam quajtur Isai biri i Merjemes, sepse pozita ime si Isa ka lindur me frymën e Zotit nëpërmjet pozitës së Merjemes. Shikoni faqen 496 dhe 556 të librit *Berahin-e-Ahmedia*. Kjo që ndodhi përputhet me atë që përmendet qartazi si profeci në suren Et-Tahrim, që Isai biri i Merjemes do të lindë në këtë umet në atë mënyrë që njëri prej këtij umeti së pari do të cilësohet si Merjeme e më pas, në atë Merjeme, do të fryhet shpirti i Isait. Pra, së pari ai do të përgatitej në barkun merjem, e më pas do të lindte me spiritualitetin e Isait dhe kështu do të quhej Isai biri i Merjemes. Kjo profeci është për Birin e Merjemes Muhammedan, e cila në Kuranin e Shenjtë, konkretisht në suren Et-Tahrim, është thënë një mijë e treqind vjet më parë. Më pas, në librin *Berahin-e-Ahmedia*, Zoti i Lartësuar Vetë e tregoi domethënien e këtyre ajeteve të sures Et-Tahrim. E keni Kuranin e Shenjtë. Mbani në njërën anë Kuranin e Shenjtë dhe në anën tjetër librin *Berahin-e-Ahmedia*, pastaj krahasojini

me drejtësi, logjikë e *takva*⁴⁶ dhe mendoni se përmes shpalljeve të përmendura në *Berahin-e-Ahmedia*, si përkoi dhe me çfarë madhështie u plotësua profecia që është përmendur në suren Et-Tahrim, pra që edhe në këtë umet dikush do të cilësohej si Merjeme e më pas nga Merjemja, ai do të bëhej Isai, me një fjalë, do të lindë prej saj. Vallë, a mund të ishte kjo në fuqinë e njeriut? A mund të ishte kjo nën kontrollin tim dhe a isha unë i gjallë kur po zbritet Kurani i Shenjtë që t'i parashtroja kërkesën: të zbritet ndonjë ajet që mua të më bëjë Birin e Merjemes dhe të më lirojë nga akuza që thonë: “Si mund të quhesh ti Biri i Merjemes?”?! Si mundej të ishte ky plani im që njëzet a njëzet e dy vjet më parë, madje edhe më herët, të sajoja shpalljet nga vetja, ku së pari ta quaja veten Merjeme e më pas, po në bazë të shpalljeve, të pretendoja se edhe tek unë është fryrë shpirti i Isait, njësoj si te Merjemja e kaluar dhe më në fund në faqen 556 të librit *Berahin-e-Ahmedia*, të shkruaja: prej Merjemes tashmë jam bërë Isai?! O të dashur! Mendoni pak dhe kijeni frikë Zotin. Kjo kurrsesi nuk është punë e njeriut. Është përtej mendjes dhe imagjinatës së njeriut të sajohen urtësi kaq të holla. Tek po botoja librin *Berahin-e-Ahmedia* shumë kohë më parë, në qoftë se unë do ta kisha si plan [që të bëhesha më vonë Isai Biri i Merjemes], pse do të shkruaja në të njëjtin libër se Isai Mesihu Biri i Merjemes do të zbrësë sërish prej qiellit. Ngaqë Zoti e dinte se po të më jepej dija rreth kësaj

⁴⁶ Druajtje ndaj Zotit. (Përkthyesi)

pike⁴⁷ që atëherë, do të dobësohej argumenti i parashtruar më sipër. Prandaj, Zoti Vetë në pjesën e tretë të librit *Berahin-e-Ahmedia* më quajti Merjeme. Më pas, siç është e qartë nga *Berahin-e-Ahmedia*, për dy vjet kam jetuar me cilësinë Merjeme, që Ai të më përgatiste larg syrit të botës gjatë kësaj periudhe. Pasi kaluan dy vite, në faqen 496, në pjesën e katërt të librit *Berahin-e-Ahmedia* u shkrua se, njësoj si te Merjemja, edhe tek unë u fry shpirti i Isait dhe, në kuptimin metaforik, unë u quajta me barrë dhe, përfundimisht, pas shumë muajsh, por jo më shumë se dhjetë, përmes shpalljes, prej gjendjes sime të Merjemes, Zoti më cilësoi Isa, gjë që është shkruar në faqen 556, në pjesën e katërt të librit *Berahin-e-Ahmedia*. Në këtë mënyrë jam Biri i Merjemes. Gjatë kohës së librit *Berahin-e-Ahmedia*, Zoti i Madhërishëm nuk më njoftoi për këtë sekret, nuk më zbuloi as renditjen dhe as kuptimin e të gjithë gamës së shpalljeve, ndërkohë ato shpallje të Zotit rreth këtij sekreti po më zbriteshin dhe po shkruheshin në librin *Berahin-e-Ahmedia*. Kjo është arsyeja që është shkruar prej meje në *Berahin-e-Ahmedia* edhe besimi i zakonshëm i muslimanëve⁴⁸, në mënyrë që të mbetej si dëshmi për thjeshtësinë dhe sinqeritetin tim. Përmendja e këtij besimi ...⁴⁹ nuk ishte

⁴⁷ Dija rreth faktit se Isai Biri i Merjemes ka ndërruar jetë dhe se ai nuk do të zbrësë prej qiellit. [Botuesi]

⁴⁸ Besimi që Hazret Isai nuk ndërroi jetë, ai ende është i gjallë në qiell dhe do të zbrësë prej tij. [Botuesi]

⁴⁹ Në tekstin original në urdu, duket se një fjalë ose disa fjalë nuk janë shkruar, me shumë gjasë për shkak të një gabimi shtypi. [Botuesi]

e shpallur, por thjesht si doktrinë dhe kjo nuk mund të përbëjë bazë për kundërshtarët që të më akuzojnë mua, sepse nuk pretendoj të kem dijen e së padukshmes nga vetja ime. Unë nuk mund ta dija, derisa Vetë Zoti i Madhërishëm nuk do të ma mësonte. Prandaj, në atë kohë urtësia e Zotit kërkonte që unë të mos kuptoja disa nga sekretet e shpallura në *Berabin-e-Ahmedia*, por kur erdhi koha, Ai m'i mësoi ato sekrete. Atëherë e kuptova se deklarata ime për të qenë Mesihu i Premtuar nuk ishte diçka e re, por është pikërisht ajo që u shkrua vazhdimisht dhe qartazi në *Berabin-e-Ahmedia*.

Këtu dua të përmend edhe një shpallje tjetër, të cilën nuk e mbaj mend nëse e kam publikuar apo jo në ndonjë botim a publikim timin, por mbaj mend që qindra njerëzve ua kam thënë gojarisht. Pra, ajo është në kujtesën time të shpalljeve. Ajo i përket kohës kur Zoti në fillim më quajti Merjeme dhe më pas më shpalli që u vu fryma e shpirtit në mua dhe pas kësaj Ai më dërgoi këtë shpallje:

فَاجَاءَهَا الْمَخَاضُ إِلَى جِذْعِ النَّخْلَةِ - قَالَتْ مِتُّ قَبْلَ هَذَا وَكُنْتُ نَسِيًا مَنْسِيًا -

Kuptimi: *Dhimbjet e lindjes e çuan Merjemen (më referohet mua) drejt një trungu hurme. Domethënë unë u përballa me njerëzit, me turmën dhe me dijetarët e paditur, të cilët nuk e kishin frytin e besimit dhe të cilët më quajtën qafir, më fyen dhe ngritën një furtunë kundërshtimi. Atëherë Merjemja tha: Mjerë unë! Sikur të kisha vdekur përpara kësaj dhe të isha tërësisht e harruar! Kjo tregon zhurmën e madhe që krijuan që në fillim në mënyrë të përgjithshme hoxhallarët, të cilët nuk e duruan dot deklaratën [që unë jam Mesihu i Premtuar] dhe tentuan me çdo mënyrë*

për të më asgjësuar. Zoti i Madhërishëm në këtë shpallje tregoi figurativisht dhimbjet dhe përpëlitjet që më përshkonin në zemër duke parë zhurmën dhe bujën e të paditurve në atë kohë.

Kishte edhe shpallje të tjera në lidhje me këtë. Për shembull, këto:

لَقَدْ جِئْتُ شَيْئًا فَرِيًّا - مَا كَانَ أَبُوكَ امْرَأَ سَوْءٍ وَمَا كَانَتْ أُمُّكَ بَغِيًّا -

Pastaj edhe shpallja tjetër që erdhi pas kësaj dhe që përmendet në faqen 521 të *Berahin-e-Ahmedia*, që është:

أَلَيْسَ اللَّهُ بِكَافٍ عَبْدَهُ - وَلِنَجْعَلَهُ آيَةً لِلنَّاسِ وَرَحْمَةً مِنَّا وَكَانَ أَمْرًا مَّقْضِيًّا - قَوْلَ الْحَقِّ الَّذِي فِيهِ تَمَثُّوْنَ -

Shikoni librin *Berahin-e-Ahmedia*, faqen 516, rreshtat 12-13.

Përkthimi: *Njerëzit e tjerë thanë: “O Merjeme! Paske bërë një gjë të turpshme e të pandershme; babai y⁵⁰ dhe nëna jote nuk ishin të tillë”, por Zoti do ta lirojë robin e Tij nga këto akuza dhe Ne do ta bëjmë atë shenjë për njerëzimin. Kjo ishte e caktuar dhe kështu do të ndodhte. Ky është Isai Biri i Merjemes, të cilin njerëzit e dyshojnë. Kjo pikërisht është fjala e vërtetë.*

⁵⁰ Nga kjo shpallje m'u kujtua një *sejjid* i quajtur Fazal Shah ose Mehr Shah banues i Batalasë, i cili e donte shumë babain tim dhe kishte lidhje të ngushtë miqsore me të. Kur dikush i tregoi për deklaratën time që unë jam Mesihu i Premtuar, ai qau shumë dhe tha: *Babai i tij ishte njeri shumë i ndershëm*. Pra, ai habitej se si unë mund të isha biri i një babai të ndershëm, i cili nuk gënjente dhe jetonte si një musliman me zemër të singërtë e të pastër. Po kështu, shumë të tjerë më thanë: E paske njollosur fisin tënd me këtë që ke thënë! (Autori)

E gjithë kjo është cituar nga libri *Berahin-e-Ahmedia* dhe këto shpallje, në fakt, janë ajetet e Kuranit që flasin rreth Hazret Isait dhe nënës së tij. Në këto ajete për Isain, të cilin njerëzit e quajtën një fëmijë të jashtëligjshëm, Allahu i Madhërishëm thotë: Ne do ta bëjmë atë një shenjë Tonën dhe se pikërisht ky është Isai që ju e prisnit të vinte. Në fjalitë që më janë shpallur mua, edhe emri Merjeme, edhe Isai janë për mua. Për mua Zoti tha: Ne do ta bëjmë shenjë, dhe gjithashtu tha: Ky është pikërisht ai Isa Biri i Merjemes që do të vinte, të cilin njerëzit e dyshojnë; kjo pikërisht është e vërteta. Ky është ai që ishte destinuar të vinte, kurse njerëzit dyshojnë vetëm për shkak të padijenisë dhe mosperceptimit të sekreteve të Zotit, sepse ata adhurojnë formën dhe nuk shohin realitetin.

Ta dini se një ndër qëllimet madhore të sures El-Fatiha është lutja:

إِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ﴿٥﴾ صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ

(“Na udhëzo në rrugën e drejtë; në rrugën e atyre që i bekove”)⁵¹

Ashtu siç është kërkuar buka në lutjen e Ungjillit, po ashtu në këtë lutje i janë kërkuar Zotit të Madhërishëm të gjitha bekimet që u janë dhënë të Dërguarve dhe Profetëve të mëparshëm. Edhe krahasimi i këtyre dy lutjeve është një gjë spektakulare! Zoti ia pranoi lutjen Hazret Mesihut duke ua dhënë **të krishterëve me bollëk bukën e tyre të përditshme**. Në të njëjtën mënyrë, edhe lutja e Kuranit u pranua përmes Profetit

⁵¹ El-Fatiha 1:6-7.

Muhammed^{savs}, dhe muslimanët e singertë e të dëlirë, sidomos më të përsosurit prej tyre, u quajtën **trashëgimtarë** të Profetëve të Bijve të Izraelit. Realisht, edhe lindja e Mesihut të Premtuar prej këtij umeti gjithashtu është **rezultat** i pranimit të kësaj lutjeje. Sepse shumë nga muslimanët e singertë e të dëlirë pavarësisht se ngjasuan fshehtazi me Profetët e Bijve të Izraelit, me urdhrin dhe me lejen e Zotit, Mesihu i Premtuar i këtij umeti u ngrit haptas karshi Mesihut Izraelit, në mënyrë që të kuptohej ngjashmëria midis **umetit të Musait dhe umetit të Muhemmedit**. Për këtë arsye, ky Mesih është quajtur i ngjashëm në çdo aspekt me Birin e Merjemes, saqë këtij Mesihu edhe sprovat i erdhën njësoj siç i kishin ardhur Birit të Merjemes.

Së pari, ashtu siç Isai Biri i Merjemes lindi vetëm me frymën e Zotit, në të njëjtën mënyrë, sipas premtimit të sures Et-Tahrim, edhe ky Mesih erdhi në jetë vetëm me frymën e Zotit nga [gjendja] e Merjemes. Ashtu siç u bë zhurmë e madhe për lindjen e Isait Birit të Merjemes dhe kundërshtarët e verbër i thanë Merjemes:

لَقَدْ جِئْتَ شَيْئًا قَرِيبًا ﴿٧٨﴾

(“Paske bërë një gjë të turpshme!”)⁵²,

në të njëjtën mënyrë, edhe në rastin e këtij Mesihu, thanë të njëjtën gjë dhe bënë potere të madhe. Sërish, gjatë shtatzënisë së Merjemes

⁵² Merjeme 19:28.

Izraelite, Zoti u kishte dhënë këtë përgjigje kundërshtarëve në lidhje me Isain:

وَلِنَجْعَلَهُ آيَةً لِلنَّاسِ وَرَحْمَةً مِنَّا ۚ وَكَانَ أَمْرًا مَّقْضِيًّا ﴿١٧﴾

(“... që ta bëjmë atë shenjë për njerëzit dhe mëshirë prej Nesh. Kjo është një çështje e kryer.”)⁵³

Të njëjtën përgjigje Zoti i Madhërishëm ua dha kundërshtarëve në lidhje me mua në librin *Berahin-e-Ahmedia*, gjatë asaj shtatzënie shpirtërore, në formë metaforike, dhe u tha:

Ju nuk mund ta asgjësoni këtë me komplotet tuaja. Unë **do ta bëj këtë shenjë të mëshirës** për njerëzit dhe kjo ishte një çështje e vendosur që nga fillimi.

Më pas, dijetarët e hebrenjve dhanë *fetvanë* [verdiktin] për Hazret Isain që të ishte *qafir* (mohues). Një dijetar sherrxhi hebre e përgatiti këtë akt mosbesimi kundër Hazret Isait dhe dijetarë të tjerë dhanë *fetvanë* e tyre për këtë. Qindra dijetarë të diplomuar të Bejtul-Mekdesit, shumica prej të cilëve ndjekës të *haditheve* [thënieve], vulosën në aktin e mosbesimit ndaj Hazret Isait.⁵⁴ E njëjta gjë ndodhi edhe me mua. Pastaj, pasi e

⁵³ Merjeme 19:22.

⁵⁴ Në kohën e Hazret Isait, paqja qoftë mbi të, edhe pse kishte shumë sekte të hebrenjve, por ata që konsideroheshin si më të drejtë se të tjerët, ishin dy: sekti që i përmbahej Tevratit dhe po prej tij kërkonte gjykim në lidhje me çështjet e tyre

shpallën mosbesimin ndaj Hazret Isait, ashtu siç e torturuan, i drejtuan sharjet më të rënda, shkruan libra për ta nënçmuar e për ta tallur atë, po

fetare, sekti i dytë ishte i atyre që ishin *ndjekës të haditheve (Ehli-hadithët)*, të cilët hadithet [thëniet] i quanin vendimtare mbi Tevratin. Këta *Ehli-hadithë* ishin mjaft të përhapur në qytete të ndryshme Izraelite. Ata ndiqnin hadithe të tilla, shumica prej të cilave binin ndesh me Tevratin. Arsyetimi i tyre ishte që disa çështje juridiko-fetare, siç janë ritualet e adhurimit (*ibadeti*), marrëdhëniet civile, çështjet e ligjit penal etj., nuk gjendeshin në Tevrat, por u adresoheshin haditheve. Libri i tyre i haditheve quhej Talmud, në të cilin ishin mbledhur thëniet e Profetëve të çdo kohe. Për një kohë të gjatë, këto thënie erdhën përmes traditës gojore dhe shumë vonë u dokumentuan. Për këtë arsye, një pjesë e tyre ishte edhe e sajuar. Në atë kohë hebrenjë ishin ndarë në shtatëdhjetë e tri sekte dhe secili sekt u përmbahej haditheve të veta. Hadithologët nuk i kushtonin rëndësi Tevratit dhe shumica ndiqnin vetëm hadithet, duke e lënë Tevratin si të braktisur. Nëse Tevratit përputhej me hadithin, e pranonin, përndryshe e linin. Në këtë kohë lindi Hazret Isai, pagja qoftë mbi të, dhe në mënyrë të veçantë iu drejtua ndjekësve të haditheve, që nderonin më shumë hadithet sesa Tevratin. Librat e Profetëve e kishin dhënë profecinë kohë më parë që kur hebrenjtë do të ndaheshin në shumë sekte dhe do të ndiqnin hadithet duke e lënë Librin e Zotit, atyre do t'u vinte një vendimtar dhe gjyqtar që do të quhej Mesih, por ata nuk do ta pranonin atë dhe përfundimisht ata do t'i zinte ndëshkimi. Ky ishte ndëshkimi i murtajes. Kërkojmë mbrojtjen e Allahut! (Autori)

ashtu edhe unë u përballa me të njëjtën situatë. Si të thuash, pas tetëmbëdhjetë shekujsh i njëjti Isa ka lindur prapë, dhe të njëjtët hebrenj kanë lindur sërish. Eh, ky pikërisht ishte kuptimi i kësaj profecie:

gajril-magdūbi ‘alejhim

Jo në rrugën e atyre që tërhoqën zemërimin!,

të cilën Zoti i Madhërishëm e kishte dhënë kohë më parë. Por këta njerëz nuk duruan, derisa u bënë shënjestër të zemërimit, si hebrenjtë. Njëren tullë të kësaj ngjashmërie e vuri Zoti me Dorën e Vetë, duke më dërguar mua si **Mesihun e Islamit** në krye të shekullit të katërmëdhjetë, njësoj siç Mesihu Biri i Merjemes kishte ardhur në krye të shekullit të katërmëdhjetë, dhe duke shfaqur shenja aq të fuqishme për vërtetësinë time, saqë asnjë kundërshtar musliman, hebre, i krishterë etj., nën kupën e qiellit, nuk ka fuqi t’u bëjë ballë. E si mund të luftojë me Zotin njeriu i dobët dhe i poshtër?! Pra, kjo është ajo tullë themelore që u vu prej Zotit. Çdokush që do të provojë ta thyjë këtë tullë, nuk do të arrijë, përkundrazi, kjo tullë kur do t’i bjerë atij, do ta bëjë atë copë-copë, sepse edhe tulla është e Zotit dhe dora është e Zotit.

Tullën e dytë e kanë përgatitur kundërshtarët e mi dhe e kanë vënë përballë kësaj, duke vepruar kundër meje, siç kishin vepruar hebrenjtë e asaj kohe. Aq saqë ngritën edhe gjyq vrasjeje kundër meje për të më shkatërruar, për të cilin Zoti im më kishte njoftuar kohë më parë. Gjyqi i përgatitur kundër meje ishte më i rëndë se gjyqi kundër Hazret Isait. Gjyqi kundër Isait ishte ngritur vetëm mbi bazën e një kundërshtimi fetar, gjë e cila për gjyqtarin ishte një motiv i dobët, për të mos thënë

hiçgjë. Por gjyqi i ngritur kundër meje ishte me akuzë për atentat vrasjeje. Ashtu si në gjyqin kundër Jezusit kishin dëshmuar priftërinj hebre, po ashtu ishte e nevojshme që edhe këtu të dëshmonte ndonjë nga hoxhallarët. E për këtë punë Zoti e zgjodhi Maulvi Muhammed Husejn Batalvin. Ai erdhi si kryehoxhë i veshur me një xhybe të gjatë për të dëshmuar, njësoj siç kishte ardhur në gjyq kryepriifti hebre për ta çuar Mesihun deri në kryqëzim. Dallimi i vetëm midis të dyve ishte se në gjykatën e Pilatit, Kryepriiftit iu ofrua karrige për t'u ulur, sepse njerëzit e nderuar të hebrenjve gëzonin karrige në shtetin romak dhe se disa prej tyre ishin edhe gjyqtarë nderi. Për këtë arsye, në bazë të ligjeve të gjykatës, Kryepriifti hebre gëzoi karrige, ndërsa Mesihun Birin e Merjemes e mbajtën në këmbë përpara gjyqtarit si një fajtor. Ndërsa gjatë gjyqit kundër meje ndodhi e kundërta. Pra, në kundërshtim me shpresat e kundërshtarëve të mi, Kapiteni Douglas, i cili këtu ishte në karrigen e gjyqtarit, sikur Pilati atje, më dha karrige për t'u ulur. Ky Pilat doli më i sjellshëm sesa Pilati i Mesihut të Birit të Merjemes, sepse në seancën gjyqësore mbajti gjyqin me guxim dhe qëndrueshmëri, duke mos përfillur fare ndërhyrjet nga lart. Gjithashtu, as simpatia ndaj kombit dhe fesë nuk e lëkundi atë dhe e zhvilloi seancën me një drejtësi kaq të lartë. Ai është i denjë për të qenë shembull për kombin dhe për autoritetet e tjera. Gjykimi është punë e vështirë. Njeriu nuk e bën dot këtë detyrë siç duhet, derisa nuk ndahet nga të gjitha lidhjet personale, para se të ulet në karrigen e gjyqtarit. Unë jap dëshminë time se ky Pilat e kreu këtë detyrë plotësisht. Por, Pilati i parë që ishte romak nuk e kreu dot siç duhet detyrën e vet. Burracakëria e tij e futi Mesihun në vështirësi

shumë të mëdha. Ky dallim është i denjë të përmendet përgjithmonë në Xhematin tonë. Derisa do të vijojë të qëndrojë bota, dhe ky Xhemat do të rritet me qindra mijëra e miliona, do të mbahet mend me të mira ky gjyqtar i singertë. Është fatmirësia e tij që Zoti zgjodhi vetëm atë për këtë punë. Sa e vështirë është për një gjyqtar të gjykojë dy palë ku nga njëra anë është misionari i fesë së tij e nga ana tjetër kundërshtari i fesë së tij, i cili akuzohet si kundërshtar i përbetuar i fesë së tij! Por ky Pilat guximtar e duroi këtë sprovë me qëndresë të madhe. Para tij kemi shpalosur të gjitha referencat e librave, për të cilat pala tjetër, nga mungesa e logjikës, na akuzonte se ishin fyese për fenë e krishterë, thjesht për të më kundërshtuar mua. Por gjyqtari në fjalë nuk pësoi asnjë rrudhë në fytyrë, sepse me anë të logjikës së tij të ndritur, kishte arritur te realiteti i ngjarjes. Ngaqë ai e kërkoi të vërtetën e gjyqit me zemër të singertë, Zoti e ndihmoi atë dhe i frymëzoi në zemër të vërtetën, derisa iu qartësua çdo gjë. Ai u gëzua shumë se gjeti rrugën e drejtësisë. Nisur vetëm nga drejtësia, ai më dha karrige për t'u ulur karshi akuzuesit. E kur Maulvi Muhammed Husejni, që kishte ardhur për të dëshmuar si Kryepriifti, më pa të ulur në karrige, nuk iu realizua dëshira për të më parë të poshtëruar. Atëherë duke kërkuar të siguronte të paktën barazinë, i kërkoi karrige këtij Pilati edhe për vete. Por ky Pilat e qortoi dhe me zë të lartë i tha: **As ti e as babai yt** kurrë nuk gëzuan karrige dhe ne nuk kemi asnjë udhëzim për karrigen tënde. Kjo kërkon reflektim. Nga frika prej hebrenjve, Pilati i parë u siguroi karrige disa njerëzve të tyre të lartë, kurse Hazret Mesihun, që ishte paraqitur si i akuzuar, e mbajti në këmbë. Ai me zemër të singertë ishte dashamirës i Mesihut,

madje ishte si ndjekës i tij dhe e shoqja që njihej si zonjë e përshpirtshme, ishte një ndër ndjekëset e veçanta të tij. Por frika e shtyu që Mesihun e pafajshëm t'ua dorëzonte hebrenjve, edhe pse duke mos qenë i akuzuar për vrasje, siç isha unë, por thjesht për një kundërshtim fetar. Pilati romak nuk e kishte të fortë zemrën. Ai u tremb kur i thanë se do të ankohen te Cezari për të.

Një tjetër ngjashmëri midis Pilatit të parë dhe Pilatit të dytë me vlerë për ta kujtuar është që në kohën kur Mesihu Biri i Merjemes u paraqit në gjykatë, Pilati i parë u kishte thënë hebrenjve – Nuk shoh asnjë mëkat te ky njeri. Në të njëjtën mënyrë, kur Mesihu i fundit u paraqit te Pilati i fundit, kur ky Mesih i tha atij – Duhet të më jepni pak ditë kohë që të përgatit përgjigjen time, pasi akuzohem për vrasje –, atëherë ky Pilat i tha – Unë nuk ju akuzoj për asnjë gjë. Të dyja fjalitë e të dy Pilatëve janë të ngjashme. I vetmi dallim është që Pilati i parë nuk e mbajti fjalën. Sepse kur i thanë – Do të ankohemi te Çezari për ty –, ai u tremb dhe me dashje ua dorëzoi Hazret Mesihun hebrenjve vrastarë, ndonëse ishin të brengosur nga ky dorëzim, ai dhe gruaja e tij. Kjo sepse të dy e respektonin shumë Mesihun. Por duke parë zhurmën dhe bujën e madhe të hebrenjve, atë e pushtoi frika. Po, fshehtas ai bëri shumë përpjekje që ta shpëtonte atë nga kryqëzimi dhe pati edhe sukses në përpjekjet e tij, por tashmë Mesihu ishte ngritur në kryq dhe duke duruar sfilatjet dhe dhimbjet e mëdha, kishte humbur ndjenja, aq sa u pandeh i vdekur. Sidoqoftë, falë përpjekjeve të Pilatit romak iu shpëtua jeta Mesihut Birit të Merjemes. Realisht, ishte lutja e vetë Mesihut për

shpëtimin e jetës, lutje të cilën Zoti ia kishte pranuar përpara kësaj ngjarjeje. Shikoni “Hebrenjve” kap. 5, vargu 7.⁵⁵ Pas kësaj, Mesihu u arratis fshehurazi nga ai vend dhe shkoi në Kashmir dhe aty ka ndërruar jetë. Ju tashmë e keni dëgjuar se në lagjen Khanjar të qytetit Sirinagar gjendet varri i tij. E gjithë kjo ishte rezultati i përpjekjeve të Pilatit, megjithatë, veprimtaria e tij nuk ishte e pastër nga burracakëria. Ai nuk e kishte të vështirë ta mbante fjalën e vet kur tha: – nuk shoh asnjë mëkat te ky njeri –, dhe ta lironte Mesihun. Ai kishte fuqi të plotë për ta liruar atë. Por u tremb sapo ia përmendën Cezarin. Por Pilati i fundit nuk u tremb nga grumbulli i priftërinjve, ndërkohë edhe këtu mbretëronte një Cezare, por se kjo Cezare ishte shumë më e mirë se ai Cezar. Prandaj, askush nuk kishte mundësi të ndikonte gjyqtarin që ai ta linte drejtësinë, duke ushtruar ndaj tij trysinë e frikës së Cezares.

Sidoqoftë, në dallim nga Mesihu i parë, u bë zhurmë dhe u stisën plane të mëdha ndaj Mesihut të dytë, pra, ndaj meje, dhe u grumbulluan

⁵⁵ Mesihu këtë e tha edhe si profeci: Përveç shenjës së Jonës, nuk do t’ju tregohet asnjë shenjë tjetër. Kështu, Mesihu ua tregoi me këto fjalë që ashtu siç Jona hyri i gjallë në barkun e peshkut dhe i gjallë doli prej tij, në të njëjtën mënyrë, edhe ai do të hynte i gjallë në varr dhe i gjallë do të dilte prej tij. Andaj, kjo shenjë nuk mund të plotësohej ndryshe përveçse që Mesihun ta zbrisnin të gjallë prej kryqit dhe ta fusnin të gjallë në varr. Dhe në këto që tha Hazret Mesihu: “asnjë shenjë tjetër nuk do t’ju tregohet”, me fjalë të tjera Mesihu hodhi poshtë pretendimin e atyre që thonë se Mesihu ka treguar edhe një shenjë tjetër duke u ngjitur në qiell. **(Autori)**

kundërshtarët e mi, duke përfshirë edhe krerët e feve të ndryshme. Por ky Pilat i fundit deshi të vërtetën dhe arriti ta mbante fjalën që më pati dhënë: unë nuk ju akuzoj për vrasje. Kështu që, ai më shpalli të pafajshëm me shumë çiltërsi e burrëri. Ndërsa Pilatit të parë iu desh të përdorte shumë hile për ta shpëtuar Mesihun, ky Pilat përmbushi detyrimet e tij të gjykuarit pa më të voglën frikë.

Ditën kur unë u shpalla i pafajshëm, në këtë gjykatë u paraqit një vjedhës i Ushtrisë Shpëtimtare. Kjo ndodhi sepse edhe Mesihu i parë u shoqërua me një vjedhës. Megjithatë, vjedhësi i kapur së bashku me Mesihun e parë u kryqëzua dhe iu thyen kockat, por vjedhësit të kapur së bashku me Mesihun e dytë nuk i ndodhi kjo gjëmë. Atë e dënuan vetëm me tre muaj burg.

Tani do t'i rikthehem temës kryesore që kaq shumë të vërteta dhe kuptime të thella ka në suren El-Fatiha, saqë nuk mund t'i mblidhnim ato të gjitha në një libër të vetëm. Shikoni vetëm lutjen plot urtësi të kësaj sureje, pra *Ihdinas-sirātal-mustekīm* (Na udhëzo në rrugën e drejtë). Kjo lutje e përsosur mban çelësin e suksesit për të gjitha synimet, qoftë për çështjet e besimit, ashtu edhe për çështjet e botës. Ne nuk mund ta dimë vlerën e vërtetë të diçkaje dhe as nuk mund të përfitojmë nga dobitë e saj, derisa nuk ndjekim një rrugë (metodë) të drejtë për ta arritur atë. Për të gjitha çështjet e ndërlikuara të botës, që lidhen me sundimin dhe qeverisjen, apo me ushtrinë dhe taktikat luftarake, me sekretet e mistershme të fizikës e të astronomisë, me metodat e diagnostikimit dhe të trajtimeve mjekësore, me tregtinë, bujqësinë dhe me çdo çështje tjetër,

suksesi është i vështirë dhe i paarritshëm, nëse nuk ndjek rrugën e drejtë e të duhur. Çdo i mençur në kohë vështirësie natë e ditë mendon dhe bluan se si të gjejë rrugëdaljen. Çdo projekt, çdo shpikje, çdo punë e ndërlikuar kërkon të ndjekësh rrugën e duhur për t'ia dalë. Prandaj, lutja e vërtetë për të arritur qëllimet e botës dhe të besimit, duhet të ishte pikërisht për të gjetur rrugën e duhur të tyre. Pasi e gjen rrugën e drejtë për një punë të caktuar, me bekimin e Zotit, arrin ta kryesh atë. Vetë Krijimtaria dhe Urtësia e Zotit ka caktuar një rrugë të duhur për të arritur synimin e kërkuar. Për shembull, një i sëmur nuk mund të mjekohet siç duhet, derisa nuk gjendet rruga e duhur e diagnostikimit dhe e mjekimit të sëmundjes së tij, për të cilën zemra të pohojë: Kjo është e duhura! Madje, nuk mund të vihet në punë asnjë sistem në botë, derisa nuk gjendet rruga e duhur për krijimin e tij. Kështu që, ai që përpiket për një objektiv, ka për detyrë ta kërkojë rrugën drejt tij. Dhe ashtu siç kjo është e nevojshme për suksesin në çështjet e kësaj bote, në të njëjtën mënyrë që nga lashtësia, u ndie nevoja për një udhë që të bën mik dhe të dashur të Zotit dhe që të sjell bekimin e Tij. Pikërisht për këtë arsye, në krye të sures së dytë që është surja El-Bekare dhe që vjen menjëherë pas kësaj sureje, thuhet: “udhëzim për të druajturit (ndaj Zotit)”, që me fjalë të tjera Zoti thotë se është pikërisht kjo udha që po tregojmë Ne dhe që ju sjell bekimin.⁵⁶

⁵⁶ Kështu, surja El-Fatiha përmend lutjen për të gjetur rrugën e drejtë, kurse surja vijuese tregoi përmbushjen e asaj lutjeje, duke treguar rrugën e drejtë. (Autori)

Shkurt, kjo lutje, pra *Ihdinas-sirātal-mustekīm* (Na udhëzo në rrugën e drejtë), është një lutje e përsosur, e cila i tërheq vëmendjen nejtut që gjatë vështirësive të besimit apo të botës, më së pari ai e ka për detyrë të kërkojë rrugën e drejtë për zgjidhjen e tyre. Pra të kërkojë një metodë të tillë të qartë dhe të drejtë, e cila e bën të mundur të arrijë qëllimin, ia mbush zemrën me besim, e shpëton nga dyshimet. Por një që do të kërkojë bukë, duke zbatuar udhëzimin e Ungjillit, nuk do të kërkojë rrugën e Zotit. Qëllimi i tij është buka. Kur e gjen atë, çfarë i duhet më Zoti. Kjo është arsyeja se pse të krishterët u larguan nga rruga e drejtë dhe varën në qafë një besim krejt të padenjë, pra të bërit njeriun Zot. Nuk e kuptoj se çfarë kishte Mesihu Biri i Merjemes më shumë nga të tjerët, gjë që i çoi ndjekësit të mendojnë për të qenët Zot të tij. Shumë Profetë të mëparshëm treguan mrekulli më shumë sesa ai, si për shembull, Musai, El-Jesë', Profeti Iljas. Dhe unë betohem në Atë Zot, në dorën e të cilit është jeta ime, nëse Mesihu Biri i Merjemes do të ishte në kohën time, kurrë nuk do të mund të bënte ato punë, që mund t'i bëj unë dhe kurrë nuk do të mund të tregonte shenjat, që shfaqen përmes meje⁵⁷ dhe do të shikonte bekimin e Zotit më shumë mbi mua sesa mbi

⁵⁷ Së shpejti do të vijë në dritë libri "*Nuzulul-Mesib*", që do ta vërtetojë këtë fakt, libër i cili është në proces botimi. Deri më tani janë botuar dhjetë pjesë të tij, kurse i gjithi do të botohet shumë shpejt. Ky libër u shkrua si kundërpërgjigje ndaj botimit "*Tanbur-e-Çishtijai*", të shkruar nga Pir Mehr Ali Golar'hvi, dhe sjell prova

veten e tij. E derisa jam i tillë, imagjinoni se çfarë grade të lartë ka ai i Dërguar i Shenjtë^{savs}, të cilit unë i jam shërbëtor.

ذَلِكَ فَضْلُ اللَّهِ يُؤْتِيهِ مَنْ يَشَاءُ

(“Ky është bekimi i Allahut, të cilin Ai ia jep kujt të dojë.”)⁵⁸

Në çështje të tilla si këto nuk ka vend për zili a lakmi. Zoti bën atë që do. Ai që kundërshton vullnetin e Zotit, jo vetëm që dështon në përpjekjet e tij, por pas vdekjes, merr rrugën e xhehenemit. U shkatërruan ata që morën për Zot krijesa të dobëta. U shkatërruan ata që nuk pranuan një të dërguar të nderuar. I bekuar është ai që më njohu. Jam rruga e fundit ndër rrugët e Zotit dhe jam drita e fundit ndër të

që z. Pir ka bërë plagjiaturë duke vjedhur temat e Muhammed Husejnit të ndjerë dhe duke bërë gabime aq të turpshme, të cilat pasi të ekspozohen, do t’ia hidhërojnë jetën. Për sa i përket fatkeqit Muhammed Husejn, ai vdiq në përputhje me profecinë time të shkruar në librin “*Ejazul-Mesih*”, kurse ky fatkeq i dytë, duke bërë më kot një plagjiaturë, u bë shënjestër e profecisë tjetër ku Zoti më tha:

إِنِّي مُهَيِّنٌ مَنْ أَرَادَ إِهَانَتَكَ-

“Unë do të poshtëroj atë që deshi poshtërimin tënd!”

فَاعْتَبِرُوا يَا أُولِيَ الْأَبْصَارِ-

Andaj, merrni mësim, o të mençur! [Kurani i Shenjtë 59:3] (Autori)

⁵⁸ El-Xhumu’a 62:5.

gjitha dritat e Tij. Fatkeq është ai që më largohet, sepse pa mua, ai do të mbetet vetëm në errësirë.

Mjeti i dytë për të gjetur udhëzimin është **suneti**, pra, praktika e Profetit Muhammed^{savs}, të cilën ai e ka bërë për të shpjeguar porositë e Kuranit të Shenjtë. Për shembull, në Kuranin e Shenjtë nuk shohim numrin e *rekateve* të namazeve të pesë vakteve, pra që sa *rekate* ka namazi i sabahut dhe namazet e tjera me radhë. Por suneti ka qartësuar çdo gjë. Nuk duhet ngatërruar suneti me hadithet, pasi nuk janë të njëjta. Hadithet janë mbledhur njëqind a njëqind e pesëdhjetë vjet më vonë, ndërsa suneti ka ekzistuar bashkë me Kuranin e Shenjtë. Pas Kuranit të Shenjtë, mirësia më e madhe që kanë muslimanët, është ajo e sunetit. Përgjegjësitë e Zotit dhe e të Dërguarit të Tij ishin vetëm dy: duke zbritur Kuranin, Zoti e njoftoi njerëzimin për Fjalën e Tij, detyrë kjo që i përket ligjit të Zotit, kurse përgjegjësia e të Dërguarit të Allahut^{savs} ishte që t'ua mësonte mirë Fjalën e Zotit njerëzve, duke e praktikuar me shembullin personal. Kështu që, i Dërguari i Allahut^{savs} *ffjalët* i ktheu në *vepra* dhe përmes sunetit ose praktikës së tij, zgjidhi ndërlikimet dhe vështirësitë. Nuk është e drejtë të thuash se kjo zgjidhje do të varej nga hadithet, kjo sepse Islami ishte ngritur në tokë që para se të vinin hadithet.⁵⁹ Vallë, përpara se të grumbulloheshin hadithet, njerëzit nuk

⁵⁹ Sekti *Ehli-hadith* quajnë hadith edhe praktikën, edhe fjalën e Profetit. Çfarëdo që të jetë terminologjia e tyre, mbetet fakti se suneti është diçka tjetër, për të cilën

falnin namaz, nuk jepnin zekat, nuk bënë haxh ose nuk dinin çka është *hallall* dhe çka është *haram*?!

Po, mjeti i tretë i udhëzimit është **hadithi**, sepse hadithet sqarojnë shumë nga çështjet e historisë, të moralit dhe të *fikbut* të Islamit. Një dobi e madhe e hadithit është që ai është në shërbim të Kuranit dhe të sunetit. Atyre që nuk iu dhurua respekti ndaj Kuranit, hadithin e quajnë si gjykatës të Kuranit, siç e thanë hebrenjtë për hadithet e tyre. Por ne e quajmë hadithin shërbyes të Kuranit dhe shërbyes të sunetit. Dihet që Padronit i shtohet madhështia nga prania e shërbëtorëve. Kurani është Fjala e Zotit. Suneti është praktika e të Dërguarit të Allahut. Dhe hadithi është një dëshmitar shtesë i sunetit. Është gabim të thuash se hadithi është gjykatës mbi Kuranin. *Kërkojmë mbrojtjen e Allahut!*

Nëse Kurani ka ndonjë gjykatës mbi të, ai është vetë Kurani. Kurse hadithi ka një shkallë dyshimi dhe si i tillë, kurrsesi nuk mund të jetë gjykatës mbi Kuranin, por thjesht dëshmi mbështetëse. Realisht, punën kryesore e kanë kryer Kurani dhe suneti, kurse hadithi vjen si dëshmi ndihmëse. Si mund të bëhet gjykatës hadithi mbi Kuranin, kur Kurani dhe suneti ishin udhëzues në atë kohë, kur ky gjykatës i krijuar nuk kishte as nam e as nishan?! Prandaj, mos thoni se hadithi është gjykatës mbi Kuranin, por thoni se hadithi është dëshmi mbështetëse për Kuranin dhe sunetin. Po, suneti është diçka që tregon qëllimin e

vetë i Dërguari i Allahut^{savs} u angazhua ta përhapte, kurse hadithi është gjë tjetër, që u mbledh më vonë. (Autori)

Kuranit. Ai është rruga në të cilën i Dërguari i Allahut^{savs} pruri sahabët. Sunet nuk janë fjalët që u shkruan njëqind a njëqind e pesëdhjetë vjet më vonë, pasi këto quhen hadithe. Suneti është ai shembull praktik, të cilin muslimanët e sinqertë e kanë ndjekur që nga fillimi, praktikë të cilën e ndiqnin mijëra e mijëra muslimanë. Kurse hadithi, ndonëse pjesa më e madhe e tij është në shkallën e hamendjes, vlen ta praktikosh me kushtin që nuk bie ndesh me Kuranin dhe sunetin. Në këtë aspekt, ai është ndihmës i Kuranit dhe i sunetit dhe përbën një thesar të çështjeve islame. **Prandaj, mosvlerësimi i hadithit** është gjymtim i një pjese të Islamit. Po, nuk është i denjë të pranohet ai hadith që është kundër Kuranit dhe sunetit, ose që është kundër një hadithi tjetër që përputhet me Kuranin, ose që është kundër një hadithi të Sahihut të Buhariut. Sepse ta pranosh një hadith të tillë, do të thotë të hedhësh poshtë Kuranin dhe të gjitha hadithet që përputhen me Kuranin. Unë e di që asnjë besimtar i sinqertë nuk do të guxojë të besojë në një hadith të tillë që bie ndesh me Kuranin, me sunetin dhe me hadithet që përputhen me Kuranin.

Sidoqoftë, çmojini hadithet dhe përfitoni prej tyre sepse ato i referohen të Dërguarit të Allahut^{savs}. Për sa kohë që Kurani dhe suneti nuk i rrëzojnë ato, as ju mos i rrëzoni, përkundrazi, përmbahuni atyre në atë mënyrë që çdo lëvizje e çdo qëndrim, çdo veprim e çdo mosveprim ta bëni sipas një hadithi të caktuar.

Por nëse ka ndonjë hadith që është qartësisht në kundërshtim me ngjarjet që sjell Kurani, reflektoni për të gjetur pajtimin mes tyre, se

ndoshta kundërshtimi ka ardhur nga gabimi juaj. Dhe nëse mospërputhja qëndron ende, atëherë hidheni poshtë një hadith të tillë sepse ai nuk është prej të Dërguarit të Allahut^{savs}.

Nëse ka një hadith të dobët, por që përputhet me Kuranin, pranojeni atë sepse Kurani është vërtetuesi i tij.

Po kështu, nëse ka një hadith me ndonjë profeci, por që është i dobët te hadithologët, dhe profecia e përmendur në të u përmbush në kohën tuaj ose në një kohë të mëparshme, besojeni atë hadith si të vërtetë, kurse hadithologët dhe tregues të tillë si të gabuar e gënjeshtarë. Hadithe të tilla ka me mijëra që kanë profeci dhe shumica prej tyre, për hadithologët, janë të kritikueshme, të sajara ose të dobëta. Tani, nëse ndonjë hadith prej tyre plotësohet dhe ju do ta anashkaloni atë duke thënë – nuk e besojmë sepse është i dobët, ose se njëri nga rrëfimtaret nuk ka qenë zbatues i rregullt i fesë – në këtë rast vërtetohet mosbesimi (mungesa e *imanit*) juaj që e refuzoni një hadith të tillë, të cilin e ka vërtetuar Vetë Zoti duke e përmbushur atë. Imagjinoni sikur të ketë një mijë hadithe të tilla, të cilat sipas hadithologëve të jenë të dobëta, dhe një mijë profeci të këtyre haditheve të dalin të vërteta, a do t'i prishni, vallë, një mijë dëshmi të vërtetësisë së Islamit, duke i quajtur ato si hadithe të dobëta?! Pra, në këtë rast do të jeni armik i Islamit. Kurse Allahu i Madhërisëm thotë:

فَلَا يُظْهِرُ عَلَى غَيْبِهِ أَحَدًا ﴿٧٢﴾ إِلَّا مَنِ ارْتَضَىٰ مِنْ رَسُولٍ

(“Prandaj, Ai nuk i jep pushtet mbi të padukshmen e Tij askujt, përveç të dërguarve të Tij të pëlqyer.”)⁶⁰

Prandaj, kujt mund t'i përkasë profecia e vërtetë përveç të Dërguarit të vërtetë?! Në këtë situatë, cila është më e denjë dhe më afër besimit të thoni: – ka gabuar hadithologu duke cilësuar të dobët një hadith të vërtetë, apo – ka gabuar Zoti duke vërtetuar hadithin e rremë?!

Zbatoni hadithin edhe sikur të jetë i dobët, me kushtin që të mos jetë kundër Kuranit, sunetit ose haditheve të tjera që përputhen me Kuranin.

Megjithatë, duhet të keni shumë kujdes kur zbatoni hadithet, sepse ka shumë hadithe të sajura, të cilat futën ngatërresë në Islam. Çdo sekt u përmbahet haditheve sipas besimit të vet. Madje, kundërshtia e haditheve e bën edhe namazin që të ketë kaq shumë forma, pra namazi që është diçka kaq bindëse dhe që u praktikua në mënyrë të pandërprerë. Dikush thotë “Amin!” me zë të lartë, e dikush me zemër. Dikush thotë El-Fatihane mbrapa imamit, e dikush tjetër këtë e quan diçka që e prish namazin. Dikush i lidh duart mbi gjoks, e dikush tjetër mbi kërthizë. Arsyeja e vërtetë e këtij mospajtimi janë pikërisht hadithet.

⁶⁰ El-Xhin 72:27-28.

كُلُّ حِزْبٍ بِمَا لَدَيْهِمْ فَرِحُونَ ﴿٥٦﴾

(“Çdo grup filloi të mburrej me atë që kishte.”)⁶¹

Përndryshe, suneti kishte treguar një metodë të vetme. Më pas, ndërhyrja e rrëfimeve e lëkundën këtë metodë. Po kështu, keqkuptimi i haditheve shkatërroi shumë njerëz. Edhe shiitët u shkatërruan pikërisht për shkak të tyre. Po të kishin bërë gjykatësin e vet Kuranin, vetëm surja Nur do të ishte e mjaftueshme për t’u dhënë dritë atyre. Por hadithet i shkatërruan.

Në të njëjtën mënyrë, në kohën e Hazret Mesihut u shkatërruan ata hebrenj⁶² që quheshin *Ebli-hadithë*. Prej kohësh ata e kishin braktisur Tevratin, siç veprojnë deri në ditët e sotme, dhe besonin se hadithi është gjykatës mbi Tevratin. Në to kishin plot hadithe që thoshin – derisa nuk zbret Elija prej qiellit me trupin e tij fizik, nuk do t’u vijë Mesihu i tyre i Premtuar. Hadithe si këto i çuan hebrenjtë në devijim të thellë. Duke iu mbështetur pikërisht këtyre haditheve, ata nuk arritën ta pranonin shpjegimin e Hazret Isait që tha: Me Elijan nënkuptohet Gjoni, pra

⁶¹ El-Mu’minun 23:54.

⁶² Ungjilli i kundërshton rreptësisht mendimet që shfaqen në hadithet dhe rrëfimet e Talmudit. Këto hadithe hebrenjtë i përcillnin gojë më gojë deri te Hazret Musai dhe thonin se ishin shpalljet e tij. Përfunduan në situatën që gjatë gjithë kohës studionin hadithet, duke e braktisur Tevratin. Në disa çështje Talmudi binte në kundërshtim me Tevratin, e në këto raste, hebrenjtë pranonin Talmudin. “Talmudi”, redaktor Joseph Barclay, London, 1878. (Autori)

Profeti Jahja, i cili erdhi me natyrën dhe karakteristikën e Eljasë (Iljasit), pra si një pasqyrim shpirtëror i tij. Kështu që, i gjithë gabimi i tyre erdhi për shkak të haditheve, gabim i cili u shkaktoi mohimin. Mundet që ata edhe të gabonin në interpretimin e atyre haditheve ose në to të kishin hyrë edhe fjalë njeriu. Sidoqoftë, ndoshta muslimanët nuk e dinë faktin se prej hebrenjve, mohuesit e Hazret Mesihut ishin pikërisht *Ehli-hadithët*. Ata bënë zhurmë kundër tij, shkruan *fetvanë* e mosbesimit dhe e quajtën *qafir* dhe thanë – Ky nuk i beson librat e Zotit, në të cilët Zoti ka dhënë profeci se Elija do të vijë përsëri; madje, keqinterpreton profecitë dhe, duke aplikuar një interpretim të largët pa asnjë provë të qartë, këto profeci i aplikon diku tjetër.⁶³ Ata e quajtën Hazret Mesihun

⁶³ Në kohën kur u shkrua *fetvaja* se Hazret Isai, paqja qoftë mbi të, të ishte *qafir*, në grupin e mendimtarëve ishte i përfshirë edhe Pali, i cili më vonë do ta shquante veten me titullin 'i dërguari i Jezusit'. Gjatë jetës së Hazret Mesihut, ai ishte armik i tij. Ungjijtë që janë shkruar në emër të Hazret Mesihut, në asnjërin prej tyre nuk përmendet si profeci se pas Mesihut, Pali do të pendohej dhe do të bëhej i dërguar i tij. Nuk kam nevojë të shkruaj të kaluarën dhe karakterin e tij, sepse të krishterët e dinë shumë mirë. Me keqardhje, ky qe pikërisht ai që e shqetësoi Hazret Mesihun, derisa Hazret Mesihu qëndroi në atë vend. Më pas, kur ai shpëtoi nga kryqëzimi dhe mërgoi drejt Kashmirit, Pali, me anë të një ëndrrë të rreme, e futi veten ndër dishepujt, sajoi Trinitetin, ua lejoi të krishterëve mishin e derrit që, sipas Tevratit, u ishte i ndaluar përgjithmonë, përhapte mase pirjen e alkoolit, futi si doktrinë Trinitetin në doktrinat ungjillore, në mënyrë që nga këto risi, të kënaqte idhujtarët grekë. (Autori)

jo vetëm *qafir*, por edhe mohues të Zotit dhe thanë – nëse ky është i vërtetë, feja e Musait bëhet një gënjeshtër. Kjo ishte epoka e errët e tyre. Ata u mashtruan nga hadithet e rreme.

Prandaj, gjatë leximit të haditheve duhet të keni parasysh se një popull përpara jush, duke i konsideruar hadithet vendimtare mbi Tevratin, arriti në derexhenë që një Profet të vërtetë ta quante *qafir* e *dexhall* dhe ta mohonte atë. Megjithatë, për muslimanët Sahihu i Buhariut është një libër shumë i bekuar dhe i dobishëm. Ky është ai libër, në të cilin është shkruar qartazi se Hazret Isai, paqja qoftë mbi të, ndërroi jetë. Po kështu, edhe Muslimi dhe libra të tjerë të haditheve janë thesare të urtësive dhe të çështjeve të shumta, dhe keni obligim t'i zbatoni, duke pasur kujdesin e duhur, që ndonjë temë e tyre të mos jetë kundër Kuranit, sunetit dhe haditheve që përputhen me Kuranin.

O robër kërkimtarë të Zotit! Hapni veshët dhe më dëgjoni! Asgjë nuk ngjason me bindjen. Është pikërisht bindja që ju largon nga mëkati. Bindja është ajo që ju jep forcën për të bërë mirësi. Bindja është ajo që ju bën të dashur dhe të sinqertë ndaj Zotit. A mund të hiqni dorë nga mëkati, pa pasur bindjen? A mund të ndaleni nga tundimet e *nefsit*, pa përjetuar një manifestim bindës? A mund të gjeni qetësi, pa pasur bindjen? A mund të krijoni ndonjë ndryshim të sinqertë, pa pasur bindjen? A mund të arrini lumturinë e vërtetë, pa pasur bindjen? A ka ndonjë shlyerje a shpagim nën kupën e qiellit, që mund t'ju largojë nga mëkati? Isai Biri i Merjemes a është i tillë që gjaku artificial i tij të mund t'ju largojë nga mëkati?

O të krishterë! Mos thoni një gënjeshtër të tillë që mund ta çajë tokën. Vetë Jezusi ishte nevojtar i bindjes për shpëtimin e vet. Ai pati bindjen dhe gjeti shpëtimin. Keqardhje për ata të krishterë që mashtrojnë të tjerët duke thënë se kanë gjetur shpëtimin nga mëkati me anë të gjakut të Mesihut, ndërkohë janë të zhytur kokë e këmbë në mëkate. Ata nuk e dinë se cili është Zoti i tyre. Bëjnë jetë të shkujdesur dhe kanë mendje të dehur, dhe ata nuk kanë as haberin për atë dehje të pastër që zbret prej qiellit. Ata janë të privuar nga jeta që është me Zotin dhe nga rezultatet e asaj jete të pastër. Prandaj, ju mbajeni mend! Pa bindjen nuk mund të dilni dot nga errësira e jetës dhe as nuk mund të gjeni dot Shpirtin e Shenjtë. Të bekuar janë ata që kanë bindjen, sepse vetëm ata do ta shohin Zotin. Të bekuar janë ata që janë liruar nga dyshimet, sepse vetëm ata do të gjejnë shpëtimin nga mëkati. Të bekuar jeni ju kur ju jepet pasuria e bindjes, sepse pas kësaj, mëkateve tuaja do t'u vijë fundi. Mëkati dhe bindja nuk mund të bashkohen. A do ta fusnit dorën në vrimën e një gjarpri tejet helmues? A mund të qëndroni pranë një vullkani që shpërthen, ku mund t'ju prekë lava e tij? A qëndroni dot nën vetëtima, përpara një luani të egër, apo diku ku murtaja ka shpërthyer e ka shkaktuar zhdukjen e brezave të tërë?! Atëherë, nëse keni të njëjtën shkallë bindjeje te Zoti, siç e patët përpara gjarprit, vetëtimave, luanit ose murtajës, nuk mundet që ju të ndiqni rrugën e ndëshkimit, duke shkelur porosinë e Tij dhe nuk mundet që ju të shkëpusni lidhjen tuaj të singertë dhe besnik me Të.

O njerëz që jeni thirrur për mirësi dhe për rrugën e drejtë! Besoni me bindje se tërheqja e Zotit do të lindë brenda jush dhe ju do të pastroheni nga njolla e neveritshme e mëkatit vetëm atëherë kur zemrën do ta keni të plotë me bindje. Ndoshta do të thoni – e kemi bindjen. Dijeni se vetëm po mashtroheni. Ju nuk e keni bindjen, sepse nuk i keni as rezultatet e saj. Arsyeja është se nuk hiqni dorë nga mëkati dhe nuk hidhni hapin që duhet hedhur; nuk druheni ashtu siç duhet të druheni.

Mendojeni vetë, ai që është i bindur se në atë vrimë ka gjarpër, a mund ta fusë dorën në të? Ose ai që është i bindur se në ushqimin e tij ka helm, a mund ta hajë atë? Ose ai që sheh me bindje se në këtë pyll ka një mijë luanë të egër, a mund ta çojnë këmbët e tij me harresë a pakujdesi drejt pyllit? Atëherë, duart dhe këmbët tuaja, veshët dhe sytë tuaj a mund të guxojnë të bëjnë mëkat, nëse besoni me bindje në Zot dhe në shpërblim-ndëshkimin e Tij. Mëkati nuk mund ta mbizotërojë bindjen. Pra, ndërkohë që shihni një zjarr gllabërues, si mund të hidheni në të? Muret e bindjes janë deri në qiell, andaj, djalli nuk mund t'i kapërcejë ato. Çdokush që u pastrua, u pastrua përmes bindjes. Bindja ju jep forcë për të përballuar dhimbjen, aq saqë edhe një mbret e bën ta lërë fronin për të veshur petkun e fukarait. Bindja lehtëson çdo brengë. Bindja ju tregon Zotin. Çdo shlyerje dhe çdo shpërblese tjetër është e rremë. Çdo pastërti vjen përmes rrugës së bindjes. Ajo që ju largon nga mëkati, ajo që ju çon te Zoti dhe ju bën të përparoni në sinqeritet dhe qëndrueshmëri më shumë se engjëjt, është pikërisht bindja. Çdo fe që nuk ju jep mjetet e bindjes është e gënjeshtërt. Çdo fe që nuk ju tregon dot Zotin nëpërmjet

mjeteve bindëse, është e gënjeshtërt. Çdo fe që nuk ka asgjë përveç tregimeve të vjetra, është e gënjeshtërt. Zoti siç ekzistonte më parë, ekziston edhe sot. Fuqitë e Tij siç ishin më parë, janë edhe sot. Ai siç e kishte fuqinë për të treguar shenjat në të kaluarën, e ka edhe sot. Pse atëherë kënaqeni vetëm me tregime. Është e shkatërruar ajo fe, e cila si mrekulli ka vetëm histori dhe si profeci ka vetëm tregime. I shkatërruar është ai xhemat, të cilit nuk i zbret Zoti dhe që nuk pastrohet me anë të bindjes me dorën e Zotit. Duke parë kënaqësitë e nefsit, njeriu shkon pas tyre, në të njëjtën mënyrë, kur gjen kënaqësitë shpirtërore me anë të bindjes, ai shkon pas Zotit. Bukuria e Zotit i jep kënaqësi kaq të madhe, saqë çdo gjë tjetër i duket e pavlerë. Njeriu shpëton nga mëkati vetëm atëherë, kur njoftohet bindshëm për Zotin, për madhështinë e Tij dhe për shpërblim-ndëshkimin prej Tij. Rrënja e çdo shkeljeje është padija. Ai që merr një pjesë nga njohja bindëse e Zotit, nuk mund të mbetet dot shkelës. Nëse i zoti i shtëpisë di që një përmytje e madhe po vjen drejt strehës së tij, ose që ka rënë zjarr rreth e përqark dhe që rrezikohet shtëpia e tij, ai nuk mund të qëndrojë në të. Atëherë, duke pretenduar bindje në shpërblim-ndëshkim prej Zotit, pse po qëndroni në gjendjet tuaja të rrezikshme? Prandaj, hapni sytë dhe shikoni ligjin e Zotit që gjendet kudo në botë. Mos u bëni minj që futen në gropë, por zogj që fluturojnë në lartësinë e qiellit. Pasi bëni *Bej'atin* e pendesës, mos qëndroni prapë mbi mëkatin, pra, mos u bëni si gjarpër, i cili edhe pse e ndërron lëkurën, sërish gjarpër mbetet. Kujtojeni vdekjen, sepse ajo po ju afrohet, edhe pse jeni të pavëmendshëm ndaj saj. Përpiquni të bëheni të pastër, sepse njeriu e gjen të Pastrin, kur pastrohet edhe vetë. Por si

mund ta gjeni këtë bekim? Përgjigjen jua ka dhënë Zoti në Kuran, ku thotë:

وَاسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ

*“Kërkojini Zotit ndihmë me anë të durimit dhe namazit.”*⁶⁴

Çfarë është namazi? Ai është lutje që parashtrohet me përgjërime, duke lartësuar, lavdëruar dhe madhëruar Zotin, duke i kërkuar falje Atij (*istigfari*) dhe duke i dërguar *salavate* të Dërguarit të Tij. Andaj, kur të falni namazin, mos u mjaftoni vetëm me fjalët arabe, si njerëzit e pavëmendshëm, sepse namazi dhe *istigfari* i tyre të gjitha janë thjesht zakone, që nuk kanë asnjë lidhje me realitetin. Prandaj, kur ju të falni namazin, përveç pjesës së Kuranit, sepse ajo është fjala e Zotit dhe përveç pjesës së lutjeve të Profetit, sepse ajo është fjala e Profetit, të gjitha lutjet e tjera bëjini me përgjërime në gjuhën tuaj, në mënyrë që kjo përlësi e ky sineritet të kenë ndikim në zemrat tuaja.

Çfarë janë namazet e pesë vakteve? Ato janë imazhi i gjendjeve tuaja të ndryshme. Jeta juaj në rast rreziku kalon përmes pesë ndryshimeve që janë të domosdoshme për natyrën tuaj.

1. Së pari, kur njoftoheni për një rrezik që ju kanoset, si për shembull, një urdhër arresti nga gjykata. Kjo është situata e parë që ju shqetësoi dhe jua mori rehatinë. Kësaj situatë i shëmbëllen koha e rënies së diellit, sepse ajo ka sjellë rënie në qetësinë tuaj.

⁶⁴ El-Bekare 2:46.

- Është namazi i drekës që i përgjigjet kësaj situate dhe që falet pasi të fillojë rënia e diellit nga zeniti.
2. Ndryshimi tjetër ndodh kur ju afrohet shumë rreziku. Për shembull, pas fletarrestimit, detyroheni të paraqiteni pranë gjykatësit, në këtë kohë kur ju ngrin gjaku dhe ju zbehet fytyra, gati për t'u shuar. Kësaj situate i përngjan koha kur diellit i zbehet drita për shkak të rënies, aq saqë të tjerët mund ta shohin me sy dhe binden se tashmë ai do të perëndojë. Kësaj situate shpirtërore i përgjigjet namazi i ikindisë.
 3. Ndryshimi i tretë ju ndodh atëherë kur humbni çdo shpresë për të shpëtuar nga gjëma që ju ka ardhur. Për shembull, kur shkruhet vendimi kundër jush, duke ju cilësuar si fajtor, pasi dëshmitë janë kundër jush. Kjo është koha kur ju gati humbni ndjenjat, duke përfytyruar veten në burg. Kësaj situate i përngjan koha kur dielli sapo ka perënduar, duke marrë me vete gjithë dritën që ishte shpresë për vazhdimësinë e ditës. Kësaj situate shpirtërore i përgjigjet namazi i akshamit.
 4. Ndryshimi i katërt ju vjen atëherë kur ju ndodheni në gjëmën që ju ka rënë, aq saqë veten e gjeni në terrnajën e saj. Për shembull, pasi të jetë lëshuar verdikti kundër jush dhe organi i drejtësisë ju dorëzon pranë policisë. Kjo situatë i përngjan kur nata bie me gjithë errësirën e saj dhe kësaj situate i përgjigjet namazi i jacisë.
 5. Më pas kur të kaloni një kohë të gjatë në këtë errësirë, përfundimisht Zoti ju mëshiron, duke ju liruar nga errësira, ashtu siç agon sabahu pas natës. Po nga agimi i sabahut fillon të

ndriçohet dita. Kësaj situate shpirtërore i përgjigjet namazi i sabahut.

Kështu që, duke dalluar pesë situata të ndryshme në gjendjen tuaj shpirtërore, Zoti i Madhërishëm ju ka lënë pesë namaze. Kjo tregon që namazet janë vetëm për dobinë tuaj. Andaj, nëse doni të shpëtoni nga këto gjëma, mos hiqni dorë nga namazet e pesë vakteve, sepse ato për ju janë si hije e ndryshimeve tuaja shpirtërore. Namazi ju sjell zgjidhje për fatkeqësitë e ardhshme. Ju nuk e dini se çfarë fati do t'ju sjellë e nesërmja. Andaj, përpara se t'ju vijë dita e re, përgjërohuni pranë Mikut tuaj, që juve t'ju vijë e mbarë dhe e bekuar.

O pasanikë! O mbretër! O të pasur! Ka shumë pak njerëz mes jush që i druhen Zotit dhe që janë të drejtë në të gjitha rrugët e Tij. Shumica prej jush të dashuruar me territoret dhe pasuritë e botës dhe për t'i arritur ato kalojnë gjithë jetën, duke harruar vdekjen. Çdo i pasur që nuk fal namazin dhe shpërfill Zotin, ka në qafë mëkatin e të gjithë shërbëtorëve dhe të punëtorëve të tij. Çdo i pasur që pi alkool, ka në qafë mëkatin e të gjithë atyre që pinë në shërbim të tij.

O ju që pretendoni zgjuarsinë! Merrni veten, se kjo botë nuk është një vend i përhershëm. Lëreni çdo teprim dhe hiqni dorë nga çdo lëndë dehëse. Nuk është vetëm alkooli që ia shkatërron jetën njeriut, por edhe

opiumi, kanabisi, hashashi, *bhang*,⁶⁵ *tarhi*,⁶⁶ dhe çdo lëndë tjetër dehëse ndaj së cilës njeriu krijon varësi. Këto ia prishin mendjen dhe përfundimisht e çojnë drejt shkatërrimit. Prandaj, ruhuni prej tyre. Nuk mund të kuptojmë se përse vazhdoni të konsumoni këto lëndë, prej të cilave mijëra njerëz të varur si ju, largohen nga kjo botë.⁶⁷ Ndëshkimi i botës tjetër do të jetë shtesë për ta.

Bëhuni të druajtur ndaj Zotit në mënyrë që t'ju zgjatet jeta dhe ju të bekoheni prej Tij. Jeta në luks të tepruar është e mallkuar. Jeta me dashakeqësi dhe mungesë mëshire të tepruar është e mallkuar. Jeta me shpërfillje të tepruar ndaj Zotit dhe ndaj dhembshurisë me njerëzit, është e mallkuar. Çdo të pasuri do t'i kërkohet llogari për detyrimet që

⁶⁵ *Bhang*, në gjuhën indiane, është një përgatitje ushqimore e kanabisit me origjinë nga nënkontinenti Indian. Ai është përdorur në ushqim dhe pije qysh në mijëvjeçarin e parë para erës sonë në Indinë e lashtë. (Përkthyesi)

⁶⁶ *Tarhi* ose *nirah* [*neerab*] është një pije dehëse që rrjedh në kushte të caktuara nga kakao, nga lëngu i arrës së kokosit, ose nga ndonjë lëng palme. (Përkthyesi)

⁶⁷ Pirja e alkoolit në Evropë u shkaktoi shumë dëme njerëzve dhe shkak për këtë qe edhe Isai, paqja qoftë mbi të, i cili e pinte alkoolin, ndoshta për kurimin e ndonjë sëmundjeje ose duke ndjekur ndonjë zakon të vjetër. Por ju o muslimanë! Profeti juaj, paqja qoftë mbi të, ishte i pastër nga çdolloj lënde dehëse dhe ishte i pafajshëm ashtu siç ai me të vërtetë është i pafajshëm. Atëherë ju që quheni muslimanë, cilin po ndiqni? Kurani nuk e lejon pirjen e alkoolit sikur Ungjilli. Atëherë ju mbi ç'dokument e shpallni të lejuar? Pse jeni kaq të pakujdesshëm nga vdekja? (Autori)

ka ndaj Zotit dhe ndaj njerëzve në të njëjtën mënyrë, siç do t'i kërkohej një të varfri, madje edhe më shumë se atij.

Prandaj, sa fatkeq është ai që, duke u mbështetur tërësisht në këtë jetë të shkurtër, i kthen shpinën Zotit; konsumon të ndaluarat e Zotit me kaq guxim, sikur t'i jenë të lejuara; në zemërim e sipër bëhet gati, si një i marrë, për të sharë dikë, për të lënduar dikë ose për të vrarë dikë; gjatë tundimit epshor, kalon çdo kufi të paturpësisë. Ai nuk do ta arrijë lumturinë e vërtetë, derisa të vdesë.

O të dashur! Ju keni ardhur për pak ditë në këtë botë, dhe edhe ajo e ka konsumuar kohën më të madhe të saj. Prandaj, mos e bëni të pakënaqur Zotin tuaj. Një shtet që është më i fuqishëm se ju, mund t'ju shkatërrojë nëse mbetet i pakënaqur nga ju. Andaj, llogaritni vetë se si mund të shpëtoni nga pakënaqësia e Zotit të Madhërishëm. Nëse do të dilni të druajtur në sy të Zotit, askush nuk mund t'ju shkatërrojë. Zoti Vetë do t'ju mbrojë dhe armiku që është gati t'ju marrë jetën, nuk mund t'ju zërë. Përveç kësaj rruge, askush nuk është mbrojtës i jetës suaj. Nga frika e armikut dhe nga prekja e fatkeqësive, ju do të jetoni jetë sflitëse dhe ditët e fundit të jetës suaj do t'i kaloni në brengë e në zemërim të madh. Zoti bëhet Streha e atyre që qëndrojnë me Të. Prandaj, ejani te Zoti dhe hiqni dorë nga çdo kundërshtim me Të. Mos u tregoni të ngathët në kryerjen e obligimeve ndaj Tij, dhe mos u bëni keq robërve të Tij as me

gjuhë e as me dorë.⁶⁸ Jini të frikësuar nga llahtaria dhe zemërimi qiellor, sepse **kjo pikërisht është rruga e shpëtimit.**

O dijetarë të Islamit! Mos u nxitoni në mohimin tim, sepse ka shumë sekrete të tilla që njeriu nuk i kupton dot përnjëherë. Mos u tregoni të gatshëm ta refuzoni mesazhin sapo ta dëgjoni, se kjo nuk është rrugë e *takvasë*. Po të mos kishit disa gabime, po të mos kishit keqkuptuar disa hadithe, do të ishte e kotë të vinte Mesihu i Premtuar me cilësinë e *Hakam-it* (gjykatës). Keni një mësim nga e kaluara. Atë që kërkon ju

⁶⁸ Ai që ndjell zemërimin te njerëzit e tjerë, Zoti e shkatërron atë po përmes zemërimit. Prandaj, në suren El-Fatiha, hebrenjtë janë quajtur “ata që tërhoqën zemërim”. Kjo nënkupton që në Ditën e Gjykimit çdo mëkatar do të “shijojë” zemërimin e Zotit, por ata që zemërohen pa të drejtë në këtë botë, që në këtë botë e shijojnë zemërimin e Tij. Zemërimi nuk i zuri të krishterët në këtë botë, aq sa i zuri hebrenjtë, për këtë arsye, në suren El-Fatiha, të krishterët janë quajtur *dāl-lin* “të devijuar”. Fjala *dāl-lin* ka dy kuptime: 1) të devijuar nga rruga dhe 2) të përhumbur në dikë a diçka. Sipas meje, këtu të krishterët kanë lajmin e mirë se dikur në të ardhmen, do të shpëtojnë nga feja e gabuar, për t’u përhumbur më pas në Islam. Ata do të lënë gradualisht besimet që kanë *shirk*, zakonet e dobëta e të turpshme dhe do të bëhen adhurues të një Zoti të Vetëm, sikur muslimanët [të nënshtruar ndaj Zotit]. Kështu që, *dāl-lin* që vjen në fund të sures El-Fatiha, sipas kuptimit të dytë të saj, pra përhumbla e diçkaje në diçka tjetër, ka një profeci për gjendjen fetare të ardhshme të të krishterëve. (Autori)

me këmbëngulje dhe rrugën që ndiqni ju, të njëjtën rrugë kishin ndjekur edhe hebrenjtë. Që do të thotë, ashtu siç ju jeni në pritje të ardhjes së dytë të Hazret Isait, paqja qoftë mbi të, edhe ata ishin në pritje të ardhjes së dytë të Profetit Iljas (Elijah).

Thoshin se së pari do të vijë edhe një herë në botë Profeti Iljas, të cilin Zoti e ka ngritur në qiell, pastaj do të vijë Mesihu; dhe se gënjeshtar është ai që do të deklarojë të jetë Mesih, përpara se të vijë Iljasi. Për këtë besim ata bazoheshin jo vetëm në *hadithe*,⁶⁹ por edhe në Librin e Zotit, konkretisht në librin e Profetit Malakia. Por kur Hazret Isai, paqja qoftë mbi të, deklaroi të ishte Mesihu i Premtuar i hebrenjve, pa zbritur Iljasi prej qiellit, i cili ishte parakushti i deklaratës së Mesihut, të gjitha besimet e hebrenjve në lidhje me çështjen në fjalë dolën të gabuara. Mendimit të hebrenjve se Profeti Elijah (Iljasi) do të zbriste i gjallë prej qiellit, më në fund iu zbardh kuptimi se një person tjetër do të vinte me natyrën dhe karakteristikat e Iljasit. Këtë zbrëthim e bëri vetë Hazret Isai, të cilin, ju [o dijetarë muslimanë], doni ta zbrisni përsëri prej qiellit. Prandaj, pse gaboni pikërisht aty ku hebrenjtë gabuan para jush? Vetë në shtetin tuaj ka mijëra hebrenj. Pyetini pakëz ata, nëse kanë të njëjtin besim që keni ju sot. Prandaj, Ai Zot që për Isain nuk e zbriti Elijanë prej qiellit dhe Isai u detyrua të bënte interpretime përpara hebrenjve, pse për ju do ta zbresë Isain prej qiellit?! Ju po mohoni pikërisht

⁶⁹ Këtu fjala *hadithe* u referohet të ashtuquajtura thënieve të Hazret Musait që gjenden në Talmud e në libra të tjerë. [Përkthyesi]

vendimin e atij, të cilin tentoni ta zbrisni përsëri prej qiellit. Nëse keni dyshime, miliona të krishterë jetojnë në këtë vend dhe ekziston edhe Ungjilli i tyre, pyetini ata se a nuk është e vërtetë që vetë Hazret Isai e kishte thënë – Gjoni, dmth. Jahja është Elijah që do të vinte përsëri. Vetëm me këtë deklaratë të shkurtër, ai ua hodhi poshtë të gjitha shpresat hebrenjve.

Tani, nëse është domosdoshmëri që pikërisht Profeti Isa të zbresë prej qiellit, atëherë Hazret Isai nuk do të mbetet më një Profet i vërtetë. Sepse në qoftë se rikthimi i dikujt prej qiellit është një ndër praktikatat e Allahut, pse nuk erdhi Profeti Iljas dhe, duke bërë interpretime, pse Jahja u cilësua në vend të Iljasit? Për të zgjuarit kjo është pikë reflektimi!

Përveç kësaj, sipas besimeve tuaja, misioni për të cilin do të vijë Mesihu është që t'i bashkohet Mehdiut dhe të bëjë luftë për t'i kthyer me dhunë njerëzit e tjerë në muslimanë. Ky besim i tillë e njollos Islamin. Ku është e shkruar në Kuranin e Shenjtë që lejohet dhuna për fenë?! Përkundrazi, Allahu i Madhërishëm, në Kuranin e Shenjtë, thotë:

لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ

“Nuk ka imponim në fe.”⁷⁰

⁷⁰ El-Bekare 2:257

Atëherë Mesihu Biri i Merjemes si do të marrë të drejtën për të përdorur dhunë, aq saqë nuk do t'u lërë asnjë alternativë tjetër, as *xhizjen*,⁷¹ përveç dy zgjedhjeve, Islamin ose vdekjen? Në cilin *ajet*, në cilin *xhuz*?⁷² dhe në cilën *sure* të Kuranit të Shenjtë përmendet ky mësim?⁷³ I gjithë Kurani në mënyrë të përsëritur po thotë – nuk ka imponim në fe – dhe qartazi tregon se luftërat që Profeti Muhammed^{savs} bëri kundër disave, nuk ishin për ta përhapur me imponim fenë, përkundrazi, ishin për disa arsye të tjera:

⁷¹ Taksën. (Përkthyesi)

⁷² Pjesë. (Përkthyesi)

⁷³ Nëse thoni se edhe arabët e kishin urdhrin që t'i konvertonin të tjerët me dhunë në muslimanë, unë them se ky mendim kurrsesi nuk provohet nga Kurani i Shenjtë. Përkundrazi, provohet që, ngaqë e gjithë Arabia ndërmori persekutim të ashpër kundër Profetit Muhammed^{savs} dhe vrau shumë nga sahabët, burra e gra, dhe të tjerët që kishin mundësi të luftonin, i dëboi nga vendi, prandaj të gjithë që konsumuan veprën penale të vrasjes ose të barbartë me të, në sy të Zotit të Madhërishëm u gjykuan që edhe atyre t'u derdhej gjak, në këmbim të gjakut që ata kishin derdhur. Sipas ligjit të hakmarrjes, dënimi i tyre i vërtetë ishte vrasja. Por Zoti që është më i Mëshirshmi nga të gjithë mëshiruesit u dha një mundësi: nëse dikush prej tyre bëhej musliman, do t'i falej krimi i tij, për të cilin ai ishte i destinuar të merrte dënimin me vdekje. Andaj, ku matet kjo mundësi e mëshirës me dhunën që thonë ata?! (**Autori**)

së pari, ishin për të ndëshkuar ata që masivisht kishin vrarë muslimanë dhe kishin dëbuar me mizori të madhe nga vatrat e tyre disa të tjerë. Siç e thotë Allahu i Madhërishëm:

أُذِنَ لِلَّذِينَ يُقْتَلُونَ بِأَنَّهُمْ ظَلَمُوا ۖ وَإِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ نَصْرِهِمْ لَقَدِيرٌ ﴿٢٥﴾

*U lejohet përballja atyre muslimanëve, kundër të cilëve po luftojnë mohuesit, për shkak se u është bërë padrejtësi. Dhe Zoti është i Plotfuqishëm t'i ndihmojë ata.*⁷⁴

Së dyti, ato luftëra ishin për vetëmbrojtje ndaj atyre që kishin si mision asgjësimin e Islamit ose që e luftonin me dhunë përhapjen e tij në vendin e tyre. Muslimanët kishin të drejtën për t'u vetëmbrojtur.

Arsyeja tjetër ishte se luftërat e muslimanëve ishin për të vendosur lirinë në vend.

Përveç këtyre tri arsyeve, Profeti Muhammed^{savs} dhe Kalifët e tij të shenjtë nuk luftuan për asnjë motiv tjetër. Madje, Islami e duroi kaq shumë dhunën e popujve të tjerë, aq sa nuk mund t'ia gjeni shembullin në popujt e tjerë. Tani, çfarë do të jenë Isa Mesihu dhe zotëri Mehdiu, të cilët, me të mbërritur në tokë, do të fillojnë vrasjen e njerëzve, dhe as ithtarëve të Librit nuk do t'u pranojnë *xhizjen*, duke e shfuqizuar kështu ajetin:

⁷⁴ El-Haxh 22:40.

حَتَّى يُعْطُوا الْجِزْيَةَ عَنْ يَدٍ وَهُمْ صَاغِرُونَ ﴿٩٢﴾

(“... derisa të japin me dorë xhizjen, duke u mundur.”).⁷⁵

Çfarë mbështetësish qenkan këta për fenë Islame, që sapo të vijnë, do t'i shfuqizojnë edhe ato ajete të Kuranit, të cilat nuk u shfuqizuan as në kohën e Profetit Muhammed^{savs}?! Dhe pas gjithë këtij “revolucionit” që do të bëhet, si nuk u dëmtuaka aspak *Khatemun-Nebijin* (Vula e Profetëve)?! Në këtë kohë, kur kanë kaluar trembëdhjetë shekuj nga koha e Profetit^{savs}, dhe vetë Islami u përça nga brenda në shtatëdhjetë e tri sekte, Mesihu i vërtetë duhet të ketë si mision të fitojë zemrat e njerëzve përmes argumenteve e jo përmes shpatës. Gjithashtu, të thyejë doktrinën e kryqit përmes dëshmime të fuqishme e të vërteta, e jo të thyejë kryqet prej argjendi, a hekuri, a bakri apo druri, duke bredhur nëpër botë. Nëse do të përdorni imponimin, imponimi juaj do të jetë një argument i mjaftueshëm që nuk keni asnjë argument për vërtetësinë tuaj.⁷⁶ Çdo mendjelehtë që ka edhe karakter të dhunshëm, kur mundet

⁷⁵ Et-Teube 9:29.

⁷⁶ Disa mendjelehtë më akuzojnë, siç bëri edhe kryeradaktori i El-Minar-it, duke thënë – Ky njeri e ndalon xhihadin ngaqë jeton në një shtet britanik. Janë kaq injorantë sa nuk mendojnë se po të doja ta kënaqja këtë qeveri me gënjeshtër, nuk do të thosha vazhdimisht se Isai Biri i Merjemes shpëtoi nga kryqëzimi dhe pati vdekje të natyrshme në Sirinagar dhe se ai nuk ishte as Zoti, e as biri i Zotit. Vallë, fetarët anglezë a nuk janë të mërzhitur me mua për shkak të kësaj deklarate timen?!

përpara argumentit, merr shpatën ose pushkën në dorë. Por, një fe që përhapet vetëm me anë të shpatës dhe jo nëpërmjet mjeteve të tjera, kurrën e kurrës nuk mund të jetë prej Zotit. Nëse ju nuk tërhiqeni nga një xhihad i tillë, dhe duke u zemëruar nga kjo thirrje, i quani *dexhall*

Prandaj, dëgjoni, o naivë! Nuk jam aspak lajkatar i kësaj qeverie. E vërteta është që sipas Kuranit të Shenjtë është e ndaluar të bëjmë luftë fetare kundër një qeverie, e cila nuk na ndalon aspak nga feja Islame dhe nga të praktikuarit e ritualeve të Islamit dhe as nuk na sulmon për ta përhapur fenë e vet, sepse edhe ajo nuk po bën një xhihad fetar kundër nesh. Dhe kemi për detyrë t'i jemi mirënjohës, sepse ne nuk mund ta bënim punën tonë as në Mekë e as në Medinë, por mund ta bëjmë në shtetin e saj. Kjo është urtësia e Zotit që më bëri të lindja në një shtet të tillë. Atëherë, si mund ta nënçmoj unë urtësinë e Zotit?! Dhe siç thotë Kurani i Shenjtë në ajetin:

وَأَوَيْنَهُمَا إِلَىٰ رُبُوعٍ ذَاتِ قُرَارٍ وَٰمَعِينٍ ﴿٥١﴾

“...dhe të dytë i strehuam në një rrafshnaltë të qetë dhe plot me burime.” (El-Mu’minun 23:51) Allahu i Madhërishëm na shpjegon duke thënë: Unë lirova Isa Mesihun nga gjëma e kryqëzimit, dhe atë dhe nënën e tij i strehova në një rrafshnaltë të qetë dhe plot me burime. Pra, kjo i referohet Sirinagarit të Kashmirit. Në të njëjtën mënyrë, edhe Zoti më strehoi në “rrafshnaltën” e kësaj qeverie, ku keqbërësit nuk mund t’i qasen. Kështu edhe ky është vend i qetë dhe edhe këtu ka burime të dijeve të vërteta dhe ka mbrojtje nga sulmet e keqbërësve. Atëherë, a nuk e kisha për detyrë ta falënderoja këtë qeveri për mirësitë që ka?! (Autori)

dhe të pafë edhe njerëzit e drejtë, unë po e mbyll këtë argumentin me këto dy fjali:

قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ ۖ لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ ۖ

(*“Thuaj: O ju mohues! Unë nuk adhuroj atë që adhuronit ju.”*)⁷⁷

Në kohën e përçarjeve dhe të trazirave të brendshme, mbi kë do të ngrenë shpatën Mesihu juaj dhe Mehdiu juaj i sajuar? A nuk mendojnë sunitët që është e denjë të luftojnë me shpatë kundër shiitëve?! Po kështu, A nuk mendojnë shiitët për sunitët që të gjithë këta duhen shfarosur me shpatë?! E përderisa vetë sektet tuaja të brendshme, sipas besimit tuaj, janë të ndëshkueshme, ju kundër kujt do të bëni xhihad?! Por, mbajeni mend! Zoti nuk është nevojtar i shpatës. Ai do ta përhapë fenë e Tij me anë të shenjave qiellore dhe askush nuk do të mund ta ndalë atë.

Mbajeni mend! Isai kurrë nuk ka për të zbritur prej qiellit, sepse, sipas ajetit “فَلَمَّا تَوَفَّيْتَنِي ... dhe kur Ti ma more shpirtin ...”⁷⁸ pohimi që ai do të bëjë Ditën e Gjykimit, qartazi tregon se nuk do të kthehet sërish në këtë botë. Justifikimi i tij në Ditën e Gjykimit është që ai nuk ka dijeni për devijimin e të krishterëve. Tani, nëse ai do të kthehet në botë përpara kiametit, a mund t’i japë përgjigjen Zotit – Nuk di aspak për devijimin e të krishterëve?! Kështu që, në këtë ajet, ai qartazi ka pranuar se nuk ka

⁷⁷ El-Kafirun 109:2-3.

⁷⁸ El-Maide 5:118.

për të ardhur sërish në këtë botë. E po të kishte për të ardhur edhe një herë në botë përpara kiametit, për të jetuar plot dyzet vjet, do të dalë gënjeshtar para Zotit kur do të thotë – Nuk di aspak për gjendjen e të krishterëve. Atij do t'i duhej të thoshte – **Gjatë vizitës sime të dytë në botë**, gjeta rreth katërqind milionë të krishterë dhe i kam parë të gjithë dhe e di shumë mirë që ata kanë devijuar, madje unë meritoj një çmim sepse të gjithë të krishterët i konvertova në muslimanë dhe ua theva edhe kryqet. Çfarë gënjeshtre e madhe do të jetë që Isai të thotë – Nuk kam dijeni! Shkurt, ky ajet qartazi tregon pohimin e Mesihut se ai nuk do të kthehet sërish në këtë botë dhe është e vërtetë që Mesihu ka ndërruar jetë dhe e ka varrin në lagjen Khanjar të Sirinagarit.⁷⁹ Tani, Zoti Vetë do të zbresë dhe Vetë do të luftojë kundër atyre që luftojnë kundër së vërtetës. Zoti lufton me anë të shenjave dhe këtu nuk ka asgjë për të kritikuar. Por nëse lufton njeriu, ai do të kritikohet, sepse përdor dhunë.

⁷⁹ Një hebre gjithashtu ka vërtetuar se varri i ndodhur në Sirinagar është ndërtuar në formën e varreve të Profetëve izraelitë. Shikoni fusnotën në faqen vijuese me shënimin përkatës. (Autori)

Fusnota e faqes paraardhëse

Gazeta më e njohur e Italisë së jugut, Corriere Della Sera, së fundmi publikoi këtë lajm të çuditshëm:

Më 13 korrik 1879, një murg i moshuar me emrin Kore vdiq në Jeruzalem. Gjatë jetës së tij, ai u shqua si njeri i shenjtë. Ai la pas një trashëgimi. Guvernatori kërkoi të afërmit e tij dhe u dorëzoi atyre një shumë prej dyqind mijë franga (118,750 rupi), që ishin në formën e monedhave nga vende të ndryshme. Ato u gjetën në shpellën në të cilën murgu kishte jetuar për shumë kohë. Bashkë me paratë, të afërmit e tij iu dorëzuan edhe disa dokumente, të cilat ata nuk ishin në gjendje t'i lexonin. Disa studiues të gjuhës hebraike i panë dokumentet dhe u çuditën kur zbuluan se këto dokumente ishin në hebraishten e lashtë. Pas zbërthimit, në to u gjet mbishkrimi i mëposhtëm:

“Unë, Pjetri peshkatar, shërbëtor i Jezusit, birit të Marisë, u drejtohem njerëzve në emër të Zotit të Plotfuqishëm dhe në përputhje me vullnetin e Tij.”

Letra mbaroi me këto fjalë:

“Unë, Pjetri peshkatar, në emër të Jezusit dhe në moshën time nëntëdhjetëvjeçare, vendosa të shkruaja këto fjalë të dashurisë, në Boler, afër shtëpisë së shenjtë të Zotit, pas tre pashkëve (tre vjet) pas vdekjes së Padronit dhe Mjeshtrit tim, Jezus Mesia, bir i Marisë.”

Studiuesit nxorën përfundimin se mbishkrimi i përket kohës së Pjetrit. I njëjtë është mendimi i Shoqatës Biblike të Londrës, e cila, pas

shqyrtimit të dokumenteve, dëshiroi t'ua marrë pronarëve për 400,000 lira (237,500 rupi).

Lutja e Krishtit, bir i Marisë, paqja qoftë mbi të dy. Ai tha:

O Zoti im! Nuk jam në gjendje ta kapërcej atë që konsideroj të gabuar. As nuk kam arritur virtytin që dëshiroja të arrija. Të tjerët e mbajnë në dorë shpërblimin e tyre, por unë jo. Madhështia ime qëndron në punën time. Askush nuk është në gjendje më të keqe se unë. O Zoti im, Ti që je më i larti, më fal mëkatet e mia! O Zot, mos lejo që armiqtë e mi të jenë në gjendje të gjejnë fajin tek unë dhe as mos më bëj të poshtërohem në sytë e miqve të mi! Mos ndodhtë që devotshmëria ime të më vërë në provë! Këtë botë mos e bëj për mua lumturinë më të madhe, e as qëllimin më të lartë! Mos vendos mbi mua ndonjë autoritar që nuk më mëshiron! O Zot i Gjithmëshirshëm, kështu bëje në saje të mëshirës Sate! Ti i mëshiron të gjithë ata që janë nevojtarë të mëshirës Sate!

Shtojca A

[Ky është përkthimi në shqip i faksimiles origjinale të dhënë në faqen pasuese, e cili paraqitet në librin origjinal “Kashti-e-Nuh” (Arka e Nuhut) “Ruhani Khazain”, në vëllimin 19, botuesi “Islam International Publications”, 2009, f. 78.]

شهد شاهد من بنى اسرائيل

‘Një dëshmitar prej Bijve të Izraelit dëshmoi’⁸⁰

(Dëshmia e një izraeliti, studiues i Tevratit,

për sa i përket varrit të Mesihut)

“Dëshmoj se kam parë hartën, e cila është në zotërim të Mirza Ghulam Ahmedit nga Kadijani, dhe me të vërtetë, harta është një përshkrim i saktë i varreve të bijve të Izraelit, dhe të personaliteteve të tyre të shquara. Unë pashë këtë hartë në të njëjtën ditë që shkruaj këtë dëshmi, më 12 qershor 1899.”

Nënshkruar: Selman Jusuf Jes’hak, tregtar

“Hebreu Selman shkroi këtë dëshmi në praninë time.”

Dëshmitari: Myftiu Muhamed Sadik B’hervi,

Nëpunësi — Zyra e Kontabilistit të Përgjithshëm, Lahor.

“Unë dëshmoj në emër të Allahut që ky dokument është shkruar nga Selman ibn Jusufi, një personalitet i shquar nga izraelitët.”

Nënshkruar: Sejjid Abdullah i Bagdadit

⁸⁰ El-Ahkaf 46:11.

Keqardhje për **këta hoxhallarë!** Po të ishin të singertë, do të bënë gjithë hulumtimin duke ndjekur rrugën e *takvasë*.⁸¹ Zoti u dha qetësi shpirtave të singerta, por ata që kanë brumin e Ebu Xhehlit, ndjekin pikërisht atë rrugë që kishte ndjekur Ebu Xhehli. Një hoxhë i nderuar prej qytetit **Mirat'h**, më njoftoi përmes një letre rekomande:

Në Amritser do të zhvillohet tubimi i *Nedvetul-Ulema*. Duhet të merrni pjesë për të debatuar.

Por, dua të bëj të qartë se këta kundërshtarë po të kishin qëllime të singerta dhe nuk do të kishin synimin e fitores apo të mundjes, nuk do t'u nevojitej të organizonin tubime pranë Nedvesë etj.. Unë nuk bëj dallimin mes *ulemarve* (dijetarëve) të Nedvesë dhe atyre të Amritserit. Të dy një besim kanë, një gjak e një soj. Çdokush është i lirë të vijë këtu në **Kadijan**, jo për debat, por për të më dëgjuar vetëm për kërkimin e së vërtetës. Po pati dyshime, të bëjë pyetje me përlësi dhe respekt. Ai do të jetë **miku** ynë derisa të qëndrojë në Kadijan. Nuk kam nevojë të shkoj në Nedve apo diku tjetër dhe as që më duhet ndihma e tyre. Këta janë armiq të së vërtetës, por e vërteta po përhapet në botë. A nuk është kjo një mrekulli madhështore e Zotit të Lartësuar që njëzet vjet më parë Ai më kishte njoftuar me shpalljen e Tij që është shkruar në “Berahin-e-Ahmedia” – Njerëzit do të përpiqen shumë dhe nuk do të lënë gur pa lëvizur që ti të dështosh, por në fund, Unë do të bëj një Xhemat të madh për ty. Kjo shpallje Hyjnore i përket kohës kur unë nuk kisha askënd me

⁸¹ *Takva*: druajtje ndaj Zotit. (Përkthyesi)

vete. Pasi u publikua deklarata ime, kundërshtarët me të vërtetë u orvatën në maksimum, saqë nuk lanë gur pa lëvizur, por sipas profecisë së lartpërmendur, ky Xhemat u përhap. Dhe deri më sot, në Indinë Britanike, Xhemati im ka më shumë se njëqind mijë persona. ‘Ulematë e Nedvasë nëse kanë parasysh vdekjen, të kontrollojnë librin “Berahin-e-Ahmedia” dhe dokumentet përkatëse të shtetit e të më thonë nëse kjo ishte apo jo një mrekulli. E tani që u kam paraqitur edhe Kuranin, edhe mrekullinë, për çfarë qëllimi do të bëhet debati?

Po kështu, kujdestarët e faltoreve dhe pasardhësit e shenjtërve që janë në këtë vend, janë sa të larguar nga feja, po aq të zhytur natë e ditë në *risitë* (*bidatet*) e tyre, si rrjedhojë, janë tërësisht në padijeni për vështirësitë dhe fatkeqësitë që po prekin Islamin. Po të shkoni në takimet e tyre, në vend që të dëgjoni Kuranin e Shenjtë ose librat e haditheve, do të shihni llojlloj tamburesh, violinash, daullesh, këngëtarësh etj.. E megjithatë, pretendojnë të jenë udhëheqës të muslimanëve dhe ndjekës të Profetit^{sav}. Disa prej tyre, madje, janë të veshur si femra, me duar të lyera me këna e të zbukuruara me byzylykë. Parapëlqejnë të recitojnë poezitë, në vend të Kuranit të Shenjtë. Këto zakone janë ngulitur kaq thellë, saqë janë ndryshkur, e vështirë të hiqen. Megjithatë, Zoti i Madhërishëm do të tregojë fuqitë e Tij dhe do ta ndihmojë Islamin.

Disa këshilla për gratë

Në këtë kohë që jetojmë, **disa gra** gjithashtu kanë rënë në disa *bidate* të veçanta. Ato e shohin me urrejtje të madhe mësimin e Islamit për **martesa me më shumë se një grua**, sikur nuk besojnë që kjo porosi të jetë prej Zotit. Gratë e tilla nuk dinë se Libri i Zotit përmban çdolloj ilaçi. Prandaj, në Islam po të mos ishte lejimi i martesave me më shumë se një grua, ai nuk do të kishte asnjë zgjidhje për burrat që detyrohen të martohen me një grua të dytë. Për shembull, nëse gruaja çmendet, ose lebroset, ose sëmuret rëndë saqë paralizohet tërësisht, ose përfundon në një situatë që gruaja të ketë nevojë për mbështetje, por të jetë e paaftë, dhe po ashtu edhe burri të ketë nevojë për mbështetje, por të mos e durojë jetën e beqarisë; në situata të tilla, do të ishte padrejtësi ndaj aftësive të burrit, nëse nuk do t'i lejohej një martesë e dytë. Realisht, duke marrë parasysh pikërisht situata të tilla, Libri i Zotit e ka lënë hapur këtë shteg. Po kështu, në rrethana të vështira edhe për gratë ka lënë hapur një shteg. Pra, kur burri bëhet i paaftë, gruaja mund t'i kërkojë gjyqtarit që t'i lëshojë *kbul'a*, që është divorc për të. Ligji Hyjnor i Zotit është si një farmaci që shet ilaçet. Nëse farmacia nuk ka ilaçe për çdo sëmundje, ajo nuk mund të ecë. Prandaj, mendoni vetë, a nuk është e vërtetë që disa burra nganjëherë mund të përballen me vështirësi të tilla, në të cilat, ata detyrohen për një martesë të dytë? Çfarë dobie ka ai Ligj Hyjnor i Zotit që nuk ka zgjidhje për çdo problem?!

Shikoni, Ungjilli e kishte lejuar **divorcin** vetëm në rastin e tradhtisë bashkëshortore dhe nuk kishte përmendur fare qindra arsyeje të tjera, të

cilat i bëjnë bashkëshortët, nganjëherë, edhe vrastar të njëri-tjetrit. Për këtë arsye, populli i krishterë nuk e përballoi dot këtë mungesë dhe rrjedhimisht në Amerikë u detyrua të miratohej ligji i divorcit. Tani, mendoni vetë, ç'vlerë ka Ungjilli pas hyrjes në fuqi të këtij ligji? O gra! Mos u shqetësoni, sepse Libri që ju është dhënë juve, nuk është nevojtar i ndërhyrjeve të njeriut, sikur Ungjilli. Kurani i Shenjtë, siç i ruajti të drejtat e burrave, i ruajti edhe të drejtat e grave. Nëse gruaja është e pakënaqur për shkak të një martese të dytë të burrit të saj, ajo lejohet t'i drejtohet gjykatësit për të marrë *khul'a* (divorc). Zoti e kishte për detyrë të përmendte në Librin e Tij të gjitha rrethanat, me të cilat mund të përballeshin muslimanët, në mënyrë që Ligji i Tij Hyjnor të mos mbetej i mangët. Prandaj o gra! Kur burrat tuaj vendosin të bëjnë një martesë të dytë, mos u ankoni për Zotin e Madhërishëm, përkundrazi, Atij lutuni që Ai t'ju mbrojë nga vështirësia dhe sprova. Pa dyshim, është shumë i padrejtë dhe i ndëshkueshëm ai burrë që mban **dy gra** dhe nuk bën drejtësi mes tyre, por ju vetë mos e kërkonti zemërimin e Zotit duke refuzuar porositë e Tij. Çdokush do të pyetet për punën e vet. Nëse ju do të jeni të mira në sy të Zotit të Madhërishëm, edhe burri juaj do të përmirësohet prej Zotit. Libri i Zotit, ndonëse për shkak të rrethanave të ndryshme, ka lënë të lejuar martesën me shumë gra, ju ka lënë të hapur edhe juve ligjin e caktimit. Nëse nuk mund ta duroni dot Ligjin e përmendur në Librin e Zotit, përfitoni nga ligji i caktimeve të Tij duke bërë lutje pranë Tij. Sepse ligji i caktimeve mbizotëron edhe Ligjin e përmendur në Librin e Zotit.

Përvetësoni *takvanë* dhe mos bini në dashuri me botën dhe zbukurimet e saj. Mos kini mburrje etnore. Mos përqeshni gra të tjera. Mos u kërkoni burrave diçka që është përtej mundësisë së tyre. Përpikuni që kur t'ju fusin në varr, të jeni të pafajshme e të moralshme. Mos u tregoni të ngathëta ndaj obligimeve të Zotit, siç janë namazi, zekati etj.. Binduni burrave tuaj me gjithë zemër e shpirt. Një pjesë e madhe e nderit të tyre është në dorën tuaj. Prandaj, përmbushni përgjegjësitë tuaja me kaq përpikëri, sa që të shënoheni si *salihat* (të pastrat) dhe *kanitat* (të dëlirat) të Zotit. Mos u bëni ekstravagante dhe mos shpenzoni kot pasurinë e burrave tuaj. Mos tradhтони. Mos vidhni. Mos u ankoni. Një grua nuk duhet të shpifë ndaj gruas a burrit tjetër.

Mbyllja

Të gjitha këto këshilla që kam shkruar më sipër, janë me qëllim që anëtarët e Xhematit tim të përparojnë në druajtje ndaj Zotit të Madhërishëm dhe të bëhen aq të denjë, sa që zemërimi i Zotit që po flakëron në tokë, të mos i zërë ata dhe që gjatë këtyre ditëve të murtajës, ata të shpëtojnë në mënyrë të veçantë. *Takvaja*⁸² e vërtetë (**eh, sa pak që ka në botë *takva* të vërtetë!**) e sjell pëlqimin e Zotit. Zoti e shpëton njeriun me *takva* të përsosur, jo në mënyrë të zakonshme, por si shenjë Hyjnore. Çdo mashtrues ose i paditur pretendon të ketë *takva*. Por, *takvanë* e ka ai që provohet si i tillë me anë të shenjës së Zotit. Çdokush

⁸² *Takva*: druajtje ndaj Zotit të Madhërishëm. (Përkthyesi)

mund të pretendojë se e do Zotin. Por, Zotin e do ai, dashuria e të cilit provohet me anë të dëshmisë qiellore. Çdokush thotë se feja e tij është e vërtetë, por feja e vërtetë është vetëm e atij, të cilit i jepet **dritë** që në këtë botë. Çdokush thotë se **do ta gjejë shpëtimin**, por këtë e tha të vërtetë vetëm ai që sheh dritën e shpëtimit që në këtë botë. Prandaj, ju përpiquni të bëheni të dashur të Zotit, në mënyrë që të mbroheni nga çdo fatkeqësi. Njeriu që ka *takva* të përsosur do të mbrohet nga murtaja, sepse ai është nën mbrojtjen e Zotit. Prandaj, kini *takvanë* e përsosur. Atë që Zoti tha për murtajën, e keni dëgjuar. Ajo është një zjarr i zemërimit. Prandaj, ruajeni veten nga ky zjarr. Ai që më ndjek mua me sinqeritet të plotë dhe që nuk ka asnjë pandersshmëri në veten e tij, që nuk ka as dembeli dhe as shkujdesje, që nuk e bashkon ligësinë me mirësinë, do të mbrohet. Por ai që ecën me ngathtësi në këtë rrugë dhe nuk e hedh hapin e plotë në rrugët e *takvasë*, ose që ka rënë përmbys mbi botën, e fut veten në sprovë.

Binduni Zotit në çdo aspekt dhe çdokush që e llogarit veten ndër ata që bënë *Bej'atin* (besëlidhjen), tani e ka kohën që t'i shërbejë këtij Xhemati edhe me paratë e tij. Ai që ka mundësi të japë një qindarkë, le të japë një qindarkë çdo muaj për shpenzimet e Xhematit. Dhe ai që ka mundësi të japë një rupi në muaj, le të paguajë një rupi çdo muaj. Sepse përveç shpenzimeve të mikpritjes, projektet e tjera fetare gjithashtu kërkojnë mjaft shpenzime. Qindra mysafirë vijnë dhe, deri më tani, për shkak të pamundësisë, nuk kemi një shtëpi të rehatshme për ta. Nuk kemi krevate. Na nevojitet të zgjerojmë edhe xhaminë. Puna e botimeve dhe

e publikimeve, në krahasim me atë që bëjnë kundërshtarët, është shumë e dobët. Të krishterët nxjerrin pesëdhjetë mijë revista e fletushka fetare, kurse ne nuk kemi mundësi të nxjerrim rregullisht as një mijë në muaj. Këto janë çështje, për të cilat çdo *bej*^{at}-bërës duhet të ndihmojë sipas mundësisë së tij, në mënyrë që edhe Zoti ta ndihmojë atë. Vlen më shumë çdo ndihmë, sado e vogël qoftë por që dërgohet nga anëtarët çdo muaj pa bërë mungesa, sesa ata që kujtohet pas një harrese të gjatë dhe japin aq sa u vjen në mend. Singëriteti i gjithsecilit njihet nga shërbimi i tij. O të dashur! Kjo është koha për t'i shërbyer fesë dhe qëllimeve të fesë. **Çmojeni këtë kohë, sepse nuk do ta gjeni prapë.** Ai që ka për të dhënë zekat, i duhet ta dërgojë këtu zekatin. Çdokush duhet të ruhet nga shpenzimet e tepërta, dhe kursimin që bën ta sjellë në këtë rrugë, dhe me çdo kusht, të tregojë singëritetin, në mënyrë që të shpërblehet me bekimin dhe Shpirtin e Shenjtë. Sepse **ky shpërblim** është përgatitur për ata që kanë hyrë në këtë Xhemat. Shpirti i Shenjtë që iu manifestua **Profetit tonë, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të**, është më i madh se çdo manifestim tjetër. Shpirti i Shenjtë një profeti iu shfaq në formën e pëllumbit, e një profeti a *avatari*⁸³ tjetër në formën e **lopës**, dhe dikujt tjetër iu shfaq si një **breshkë a peshk**. Por nuk ishte koha e shfaqjes së tij në formë njeriu, **derisa nuk erdhi njeriu i përsosur**, pra Profeti ynë, **paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të**. Kur erdhi Profeti Muhammed^{sav}, për shkak se ai ishte njeri i përsosur, edhe Shpirti i

⁸³ *Avatar* në fenë hindu është mësues me një manifestim Hyjnor. (Përkthyesi)

Shenjtë iu shfaq në formën e njeriut të përsosur. Dhe ngaqë manifestimi i Shpirtit të Shenjtë ishte aq i fuqishëm saqë e kishte mbushur **tërë hapësirën** nga toka në qiell, mësimi i Kuranit mbeti i mbrojtur prej *shirkut*.⁸⁴ Por, ngaqë **Udhëheqësit** të fesë së krishterë Shpirti i Shenjtë iu shfaq në një formë shumë **të dobët**, pra atë të **pëllumbit**, përfundimisht shpirti i lig, pra djalli, **arriti fitoren** mbi këtë fe. Djalli tregoi madhështinë dhe forcën e tij në mënyrë aq të tmerrshme, saqë si një **gjarpër i madh** e sulmoi. Kjo është arsyeja që Kurani i Shenjtë renditi devijimin e të krishterëve në vendin e parë ndër të gjitha devijimet dhe tha – Toka dhe qielli gati të pëlcasin dhe të copëtohen nga mëkati i madh që ata kanë bërë në tokë, **duke bërë njeriun Zot dhe bir të Zotit**. Kurani edhe në fillim përmend të krishterët dhe e hedh poshtë besimin e tyre, siç nënkuptohet nga fjalët *Ijja ke na'budu* (“Vetëm Ty të adhurojmë”) dhe *ve led-dāl-līn* (“që nuk devijuan”); dhe e hedh poshtë edhe në fund të tij (të Kuranit), siç kuptohet nga surja:

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ۝ اللَّهُ الصَّمَدُ ۝ لَمْ يَلِدْ ۝ وَلَمْ يُولَدْ ۝

(“Thuaj: Ai, Allahu është i Vetëm. Allahu është i Pavaruri. Ai nuk ka lindur (askënd) dhe as nuk është i lindur.”)⁸⁵

⁸⁴ *Shirk*: besimi në shumë zota; adhurimi i dikujt a diçkaje tjetër përveç Zotit të Vetëm. (Përkthyesi)

⁸⁵ El-Ihlas 112:2-4.

Gjithashtu, Kurani edhe në mesin e tij përmend të keqen e fesë së krishterë, siç kuptohet nga ajeti:

تَكَادُ السَّمَوَاتُ يَتَّقَطِرْنَ مِنْهُ

(“Qiejt gati të pëlcastin nga ajo ...”)⁸⁶

Sipas Kuranit, që kur është krijuar bota, nuk u është dhënë kaq shumë theks adhurimit të njeriut dhe rrugëve të gënjeshtërtë. Për këtë arsye, pikërisht të krishterët u thirrën për *mubahila*⁸⁷, dhe jo ndonjë idhujtar tjetër. Pra, nuk është e vështirë të kuptojë për atë që dëshiron ta kuptojë se çfarë do të thotë shfaqja e Shpirtit të Shenjtë në formë shpendësh a kafshësh të tjera më përpara. Unë do të them vetëm se natyra njerëzore e Profetit tonë^{savs} ishte aq e fuqishme, saqë edhe Shpirtin e Shenjtë e tërhoqi drejt njerëzisë. Prandaj, **pse duhet të dëshpëroheni duke qenë ndjekës të një Profeti kaq të mrekullueshëm?! Tregoni shembuj të tillë që edhe engjëjt të befasohen nga vërtetësia dhe pastërtia juaj dhe t’ju dërgojnë *salavate*. Përvetësoni një vdekje, që t’ju dhurohet jeta. Largoni nga vetja nxitjet e nefsit, në mënyrë që Zoti të zbresë në të. Shkëputuni tërësisht nga njëra anë dhe krijoni një lidhje të përsosur në anën tjetër. **Zoti ju ndihmoftë!****

⁸⁶ Merjeme 19:91.

⁸⁷ *Mubahila*: lutje duele, ku secila palë i lutet Zotit të Madhërishëm që Ai të shkatërrojë palën gënjeshtare. (Përkthyesi)

Këtu po e përfundoj dhe lutem që ky mësim imi u bëftë i dobishëm për ju! Ardhtë një ndryshim i tillë në ju, që ju të bëheni yjet e tokës dhe toka të ndriçohet nga ajo dritë, e cila ju dhurohet nga Zoti juaj! *Amin! Amin!*

يَا عِبَادَ اللَّهِ أَذَكِّرْكُمْ أَيَّامَ اللَّهِ وَ أَذَكِّرْكُمْ تَقْوَى الْقُلُوبِ - إِنَّهُ مَنْ يَأْتِ رَبَّهُ مُجْرِمًا فَإِنَّ لَهُ جَهَنَّمَ لَا يَمُوتُ فِيهَا وَلَا يَحْيَى - فَلَا تُخْلِدُوا إِلَى زِينَةِ الدُّنْيَا وَزُورَهَا وَ اتَّقُوا اللَّهَ - وَاسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَ الصَّلَاةِ - إِنَّ اللَّهَ وَ مَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَ سَلِّمُوا تَسْلِيمًا - اَللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَ عَلَى آلِ مُحَمَّدٍ وَ بَارِكْ وَسَلِّمْ -

O robër të Allahut! Ju kujtoj ditët e Allahut dhe ju këshilloj të keni *takvanë* e zemrës. *Njëmend, ai që arrin te Zoti i tij si fajtor, për të është xhehenemi, në të cilin ai as nuk do të vdesë dhe as nuk do të jetojë.*⁸⁸ Prandaj, mos bini në grackën e bukurisë dhe të mashtrimit të dynjasë dhe kini *takvanë* e Allahut. *Kërkojini ndihmë Atij përmes durimit dhe namazit.*⁸⁹ *Sigurisht, Allahu dhe engjëjt e Tij i dërgojnë salavate Profetit. O ju që besuat! Edhe ju dërgojini salavatet dhe shumë selam.*⁹⁰ O Allah! Lartësoje Muhammedin dhe popullin e tij, bekoje dhe dërgoji selam atij!

⁸⁸ TaHa 20:75.

⁸⁹ El-Bekare 2:46.

⁹⁰ El-Ahzab 33:57

Profeci në vargje rreth murtajes

(në persisht)

نشان اگر چه نہ در اختیار کس بود دست
مگر نشان بد ہم از نشان زد ادا دارم
کہ آن سعید ز طاعون نجات خواہد یافت
کہ جست و جست پناہ ہے بچار دیوارم
مراقبم بخداوند خویش و عظمت او
کہ ہست این ہمہ از وحی پاک گفتارم
چہ حاجت است بہ بحث و گر ہمیں کافیت
برائے آنکہ سیہ شد دلش ز انکارم
اگر دروغ براید ہر آنچہ وعدہ من
رواست گر ہمہ خیر نہ بہر پیکارم

Ndonëse nuk është në dorën e dikujt të tregojë Shenjë

Unë prapë do t'ju tregoj një shenjë prej Zotit

Ai fatmir do të shpëtojë nga murtaja

Që druhet dhe kërkon strehë brenda katër mureve të mia

Betohem në Atë Zot dhe betohem në Madhësitinë e Tij

I gjithë ligjërimi im po rrjedh përmes **Shpalljes së Shenjtë**

Përse atëherë të diskutohet nëse kjo duhet të na mjaftojë

Për dikë që iu nxi **zemra** për shkak se më mohoi

Nëse del gënjeshtër **premtimi që unë kam bërë**

Çdokush ka të drejtë të ngrihet e të më luftojë

Kërkesë për donacione për zgjerimin e shtëpisë

Në pritje të përhapjes së mundshme të murtajës në të gjithë vendin, shtëpia ime është bërë shumë e ngushtë, në të cilën në disa pjesë qëndrojnë mysafirë burra dhe në disa pjesë të tjera gra. Ju e keni dëgjuar që Allahu i Madhërishëm ka premtuar mbrojtjen e veçantë për ata që do të qëndrojnë brenda mureve të kësaj shtëpie. Dhe, edhe për shtëpinë e të ndjerit Ghulam Hajdar, në të cilën ne kemi një pjesë, pala tjetër është dakortësuar që pjesën tonë të na japë, dhe pjesën e mbetur ta lëshojë në këmbim të vlerës monetare. Mendoj se kjo shtëpi, e cila mund të zgjerohet ngjitur me shtëpinë time, mund të rregullohet me një kosto prej dy mijë [rupi]. Duke qenë se rreziku i murtajës po afrohet dhe kjo shtëpi, bazuar në lajmin e mirë të dhënë në shpalljen e Zotit, do të jetë si një arkë gjatë valës së murtajës, nuk dihet se sa shumë veta do të përfitojnë nga premtimi i Tij. Prandaj, kjo punë kërkon shpejtim. Duhet të përpiqemi duke u mbështetur tek Zoti, që është Krijuesi dhe Furnizuesi dhe që sheh veprat e mira. Edhe unë kam parë që shtëpia jonë është si një arkë, por në të ardhmen në këtë varkë nuk do të ketë vend as për ndonjë burrë e as për ndonjë grua. Prandaj zgjerimi është i nevojshëm.

Paqja qoftë mbi atë që ndjek udhëzimin!

Njoftuesi

Mirza Ghulam Ahmed Kadijani



Hazret Mirza Ghulam Ahmed^{as}
Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi

Rreth autorit

Hazret Mirza Ghulam Ahmedi^{as} lindi në vitin 1835 në Kadijan të Indisë. Ai ishte shumë i përkushtuar në studimin e Kuranit të Shenjtë dhe tërë kohën e tij e kalonte në adhurimin e Zotit dhe në përkushtimin ndaj Tij.

Gjatë periudhës në të cilën jetoi, Islami ishte nën shënjestër të sulmeve armiqësore nga të gjitha anët dhe muslimanët në përgjithësi ishin në rënie të skajshme shpirtërore, me një besim të dyshimtë dhe krejtësisht sipërfaqësor. Ai ndërmoi një fushatë të jashtëzakonshme për t'i treguar botës fytyrën e bukur e të vërtetë të fesë Islame. Ndër përpjekjet e tij të çmuara e madhore, mund të përmendim: mbi nëntëdhjetë libra (duke përfshirë veprën e tij fenomenale *“Berahin-e-Ahmedia”* që ndryshoi krejtësisht rendin e botës fetare), qindra ligjërata me njohuri të thella të mistikës e debate të shumta fetare, të cilat argumentonin më së miri se feja Islame është një fe e gjallë, nëpërmjet së cilës njeriu mund të lidhë kontakt me Krijuesin e tij dhe mund të komunikojë me Të.

Shumica prej nëntëdhjetë e dy veprave të tij janë shkruar në gjuhën urdu, disa janë në gjuhën arabe e disa të tjera edhe në gjuhën perse. Ai gjithashtu provoi se mësimet e Kuranit Famëlartë dhe Sheriati i fesë Islame janë të destinuara të ngrenë e të përsosin nivelin moral, intelektual dhe shpirtëror të njeriut. Ai deklaroi se Zoti i Madhërishëm e caktoi atë si Mesih dhe Imam Mehdi, pra shërbëtor të vërtetë të

Profetit Muhammed^{savs}, siç ishte përmendur në profecitë e Biblës, të Kuranit Famëlartë dhe të *haditheve* të *Hazret* Profetit Muhammed^{savs}.

Ai themeloi Xhematin Musliman Ahmedia dhe në vitin 1889 filloi të pranonte aderime në të. Ndërroi jetë më 26 maj të vitit 1908. Sipas profecive të bëra prej tij, të mbështetura nga Kurani Famëlartë dhe nga thëniet e *Hazret* Profetit Muhammed^{savs}, Xhemati Musliman Ahmedia vijoi misionin e tij nën udhëheqjen e *Kalifatit*. Aktualisht *Hazret* Mirza Masrur Ahmedi, Allahu e ndihmoftë fuqimisht, është udhëheqësi botëror i Xhematit Musliman Ahmedia dhe *Kalifi* i Pestë i Mesihut të Premtuar. Ky Xhemat sot është përhapur në 210 vende të botës dhe përbëhet nga miliona anëtarë.

Shkurtesat

- saṿs* *Selallahu alejhi'veselam* (Paqja e bekimi i Allahut qofshin mbi të!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i Hazret Profetit Muhammed^{saṿs}.
- as* *Alejhiselam* (Paqja qoftë mbi të!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë profeti të Allahut.
- ra* *RadijAllahu anhu/anha/anhum* (Allahu qoftë i kënaqur me të/ta!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë sahabi a sahabeje të ndonjë profeti.

Kontakte

Shqipëri:

Xhemati Musliman Ahmedia
Rr. "Pavarësia", KM 1, Mëzez,
Kutia Postare 8176,
Tiranë, Shqipëri (Albania)
Kontakt +355 67 216 8054
www.alislam.al

Kosovë:

Xhemati Musliman Ahmedia
Rr. "Holger Pedersen",
Lagjja e Spitalit, Prishtinë, Kosovë
+381 3855 8436, +377 4481 7813
Fax: +381 3851 2408
www.alislam.al

Gjermani:

Ahmadiyya Muslim Jamaat
Baitus-Sabuh
Genfer Str. 11
60437 Frankfurt am Main, Germany
+49 6950688600
www.ahmadiyya.de

Britani e Madhe:

The Baitul Futuh Mosque
181 London Rd,
Morden SM4 5PT, UK
www.alislam.org

Zvicër:

Ahmadiyya Muslim Jamaat
Mahmud Moschee
Forchstrasse 323
8008 Zürich
T +41443815570, F +41443822181
www.ahmadiyya.ch

Holandë:

Ahmadiyya Moslim Gemeenschap
Mobarak Moskee, Oostduinlaan 79,
2596 JJ Den Haag
T: 070-3245902, F: 070-3242881
www.islamnu.nl

Spanjë:

Mezquita Basharat
14630 Pedro Abad
Córdoba, Spain
T +34 957 186203
F +34 957 186300
www.alislam.es
www.ahmadiyya-islam.org/es/

Bosnjë:

Ahmadija muslimanski džemat
Tuzlanska 1b, 71000 Sarajevo,
Bosna i Hercegovina
Tel/Fax.: 00387-33-612612
www.ahmadija.ba

www.alislam.al

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Ahmad, Ghulām

Arka e Nuhut / Mirzā Ghulām Ahmad;

përkth. Samad Ahmed Ghorî; red. Ina Komino.

– Tiranë : Fondacioni "Xhemati Musliman Ahmedia e Shqipërisë",
2020

158 f. ; 14.8 x 21 cm.

Tit. origj. në gjuhën urdu "Kashti-e-Nuh"

ISBN 978-9928-4491-3-9

1.Feja islame 2.Doktrina fetare

28 -12

ARKA E NUHUT

THIRRJE DREJT BESIMIT

Albanian translation of *Kashti-e-Nuh* (Noah's Ark)

Në vitet 1896 – 1914 murtaja shkatërroi Indinë Britanike, dhe më veçanërisht provincën e Panxhabit. Gjatë kësaj periudhe të rrezikshme, në të cilën qytete dhe fshatra të tëra po asgjësoheshin për shkak të vdekjeve masive nga murtaja, qeveria britanike bëri përpjekje për të shpëtuar njerëzit nga kjo epidemi përmes vaksinës. Ishte ky sfondi kur *Hazret Mirza Ghulam Ahmedi*^{as} i Kadijanit shkroi librin “Arka e Nuhut”, në vitin 1902. Në të autori parashtrroi mësimet e tij dhe tha se Zoti i Madhërishëm e njoftoi se ata që ndjekin me sinqeritet të plotë mësimet e tij, do të shpëtojnë mrekullisht nga sulmi i kësaj murtajeje, madje edhe pa marrë vaksinën. Historia dëshmoi përmbushjen e plotë të kësaj profecie të jashtëzakonshme.

Libri “Arka e Nuhut” ishte një fener shprese jo vetëm për të kaluarën, por vijon të jetë i tillë edhe tani dhe do të vazhdojë t’i japë shpëtimin botës edhe në të ardhmen. “Arka e Nuhut”, pa dyshim, është një nga librat më me ndikim të *Hazret Mesihut të Premtuar, Imam Mehdiut*^{as}, i cili vijon ta ndryshojë jetën e shumë njerëzve edhe sot.



Çmimi:

300 Lekë